

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË – PRISHTINË
FAKULTETI HISTORI-FILOLOGJI – TIRANË

SEMINARI XXXVI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

THE XXXVI INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN
LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE

PRISHTINË, 14 – 25.08.2017

Universiteti i Prishtinës
Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Filologjisë – Prishtinë
Fakulteti Histori-Filologji – Tiranë

SEMINARI XXXVI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

PRISHTINË, 14 – 25.08.2017

THE XXXV INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN
LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE

Këshilli Drejtues i Seminarit në Prishtinë:

prof. asoc. dr. Bardh Rugova, prof. ass. dr. Nysret Krasniqi, prof.
asoc. dr. Rahman Paçarizi, prof. asoc. dr. Qibrije Demiri - Frangu,
prof. asoc. dr. Lindita Tahiri, prof. ass. dr. Albulena Blakaj, prof. ass.
dr. Abdulla Rexhepi.

Këshilli Drejtues i Seminarit në Tiranë:

prof. dr. Shezai Rrokaj, prof. dr. Aljula Jubani, prof. dr. Dhimitri
Bello, prof. dr. Mimoza Kore, prof. asoc. dr. Lili Sula, prof. asoc. dr.
Anila Mullahi, prof. asoc. dr. Vjollca Osja, dr. Erenestina Halili.

Drejtor: prof. asoc. dr. Rahman Paçarizi

Bashkëdrejtor: prof. dr. Aljula Jubani

Sekretar: prof. asoc. dr. Qibrije Demiri - Frangu

Bashkësekretar: prof. asoc. dr. Viola Isufaj

Sekretarë profesionalë: ma. Kadire Binaj, ma. Alban Zeneli

Drejtor nderi: akademik Idriz Ajeti

Përgjegjëse për kurset e gjuhës: prof. ass. dr. Sala Ahmetaj

Shënim 1: Koha e paraparë për kumtesat në seancat e referimeve, në tryezë dhe në seancën e aspirantëve është 10 minuta, ndërsa diskutimet mund të zgjasin 5 minuta.

Në sesionet shkencore koha e paraparë për leximin e kumtesave është 15 minuta. Diskutimet pas çdo kumtese mund të zgjasin 5 minuta.

Shënim 2: Teksti i plotë duhet të dërgohet për botim në adresën seminari.filologjik@uni-pr.edu deri më 1 tetor 2017.

Shënim 3: Botohen vetëm kumtesat që janë prezentuar dhe janë vlerësuar të botueshme nga recensentët.

PROGRAMI I PUNËS I SEMINARIT XXXVI

E HËNË, 14 GUSHT 2017

Ora 11:00 **Hapja solemne e Seminarit XXXVI**

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

E MARTË, 15 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Ligjëratë**

Rahman **Paçarizi**: Konversioni dhe koncepti i temës
fjalëformuese

Drejtues: Bardh Rugova

Ora 12:30 Pritje te dekanja e Fakultetit të Filologjisë

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Referime**

Drejtues: A. Novik, S. Baraliu

1. Bekim **Xhemili**: Muzeu i Kosovës – kontributi dhe sfidat në fushë të kulturës
2. Aleksandër **Novik**: Dasma “arnaute” (“greko-shqiptare”) në rajonin e Detit Azov (materialet e studimeve shkencore në terren të viteve 2015-2016)
3. Natalia **Badiyan-Siekierzycka**: Edith Durham and Albania
4. Sedat **Baraliu**, Premtim **Alaj**: Vendbanimet dardane të Periudhës së Hekurit në Kosovë

E MËRKURË, 16 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Ligjëratë**

Kujtim **Rrahmani**: Në dorë të mitit: Fiksioni e polisi
Drejtues: Nysret Krasniqi

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Referime**

Drejtues: G. Belluscio, M. Ibrahim

1. Giovanni **Belluscio**: Si mbaron Serafina Thopia e vitit 1839? How does Serafina Thopia (1839) end?
2. Gani **Pilana**, Sadete **Pilana**: Formimi dhe shqipërimi i terminologjive teknike shqipe
3. Mustafa **Ibrahimi**: Procesi i zhargonizimit të fjalëve shqipe me anë të ndajshesave të huaja
4. Daniel Jordanov **Tomov**: Etimologjia e fjalëve për emocionet negative në gjuhët ballkanike: zemërim, egër, mëri, pezëm

E ENJTE, 17 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Tryezë**: 15-vjetori i revistës “Jeta Arbëreshe”
Drejtues: Imri Badallaj

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Referime**

Drejtues: Carrie Ann Morgan, Atdhe Hykolli

1. Carrie Ann **Morgan**: Gratë në ‘kontroll’: Nerva e në ndërrimin e kodit (code switching) ‘të trashë’
2. Matvey **Lomonosov**: Identiteti kombëtar si përpjekje morale: Intelektualët shqiptarë dhe formimi i një kundërmiti për betejën e Kosovës, 1389
3. Gabriela **Abrasowicz**: Transcultural potential in works of the contemporary Albanian playwrights and theatre producers from Kosovo
4. Atdhe **Hykolli**: Përligjja e miteve në këngët rituale kalendarike të shqiptarët
5. Adil **Olluri**: Letërsia e Ymer Shkreli

E PREMTE, 18 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Tryezë - Gjuhësi**

Ora 12:30 **Tryezë - Letërsi**

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Referime**

Drejtues: Kadire Binaj, Besim Kabashi

1. Kadire **Binaj**: Modelet e fjalive me folje dyvalente
2. Besim **Kabashi**: AICo – një korpus tekstesh i gjuhës shqipe me 100 milionë fjalë

3. Ardita **Berisha**: Kualifikimi epistemik i futurit në gjuhën shqipe
4. Bahri **Koskoviku**: Sintagmat parafjalore të shqipes nga këndvështrimi generativist

E SHTUNË, 19 GUSHT 2017

Ora 9:00 Ekskursion

E DIEL, 20 GUSHT 2017

Ekskursion

E HËNË, 21 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Ligjëratë**

Lindita **Sejdiu- Rugova**: Çështje të sintaksës së shqipes-koncepte dhe klasifikime

Drejtues: Rahman Paçarizi

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Ligjëratë**

Gëzim **Aliu**: Romanet e Kadaresë të kohës së diktaturës komuniste

Drejtues: Agron Gashi

E MARTË, 22 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 11:00 **Promovim libri**

“Ekspedita në Detin Azov. Gjuha dhe kultura e shqiptarëve të Ukrainës”

Alexander **Novik**, Maria **Morozova**, Denis **Ermolin**

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 18:00 **Tryeza e doktorantëve
Gjuhësi**

Drejtues: Agnesa Hasimja, Mensur Vokrri

1. Agnesa **Hasimja**: Folja në tekstet shkollore
2. Mensur **Vokrri**: Pikëpamjet e B. Bokshit dhe K. Topallit për prapavendosjen e nyjës shquese në gjuhën shqipe
3. Adelinë **Selmani**: Mënyrat e fjalëformimit sipas temës fjalëformuese
4. Ilmi **Rexhepi**: Gramatikaliteti i formave dysore për të shquarën e emrave "Ferizaj" dhe "Skënderaj"
5. Yllka **Imeri**, Elizabeta **Koch**: Sistemi emëror i shqipes krahasuar me sistemin emëror të gjuhës portugeze

E MËRKURË, 23 GUSHT 2017

Ora 9:00 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 9:00 **Tryeza e doktorantëve**
Gjuhësi

Drejtues: Shpëtim Elezi, Rinor Matoshi

1. Senad **Neziri**: Zhvillimi i shqipes në rajonet bilinge në Prizren
2. Sadat **Agushi**: Leksiku dialektor i muhaxhirëve të rrethinës së Preshevës
3. Shensi **Haziri**: Zhvillimi i leksikut policor në gjuhën shqipe në Kosovë
4. Rinor **Matoshi**: Arbënishtja në studimet e Idriz Ajetit
5. Lindita **Dinoha**: Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Mal të Zi
6. Manjola **Lubishtani**: Realizimi i funksioneve jashtëkundrinoe të varianteve të lidhura sipas këndvështrimit të Besim Bokshit

Ora 10:30 Pushim

Ora 11:00 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Ardita Berisha, Hana Radoniqi

7. Diellza **Hoxha**: Struktura e rrokjes në gjuhën shqipe
8. Hana **Radoniqi**: Studimi i theksit të shqipes në fonologjinë metrike dhe në teorinë e optimalitetit
9. Dritë **Bardhaj-Krasniqi**: Ndikimi i faktorëve sociolinguistikë në vlerat akustike të zanores /a/ në shqipe
10. Elona **Gjata**: Zanoerja *ë* në tekstet e At Skiroit dhe tradita shkrimore e saj
11. Hatixhe **Hoxha**: Pikëpamjet e Eqrem Çabejt për prejardhjen e gjuhës shqipe
12. Karmen **Lazri**: Ndhimesë e gjuhëtarit Xhevat Lloshi për fjalëformimin në terminologji
13. Jeton **Raja**: Përemrat e pacaktuar në veprën “Meshari” të Gjon Buzukut

12:30 Pushim

Ora 16:30 *Kurse gjuhe I, II, III*

Ora 16: 30 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Nertila Zani, Vjosa Osmani

14. Rezarta **Gjergji**:Nevoja e mësuesve për zhvillim profesional për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies
15. Tiziana **Leka**: Integrimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor në shkollat shqiptare
16. Nertila **Zani**:Retorika dhe argumentimi, përqsja dhe ndarja midis tyre
17. Froseda **Angjellari- Tola**: Ndihma e toponimisë në identifikimin e vendbanimeve te fortifikuara në prehistori.Disa shembuj nga zona e Shqipërisë Juglindore
18. Pranvera **Osmani**:Fjalitë kallëzuesore në gjuhën shqipe

17:45 Pushim

18:00 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Jahja Hondozi, Albulena Alidema

19. Albulena **Alidema**: Gjuha standarde në kinematografinë e Kosovës
20. Jahja **Hondozi**: Vështrim sociolinguistik rreth së folmes së Rahovecit
21. Vjosa **Osmani**:Etiketa seksiste ndaj femrave-mjete gjuhësore për shprehjen e tyre
22. Qëndresa **Jakupi**: Bashkërenditja e njëjësive më të vogla se fraza
23. Adelajda **Baftiu**: Sintagma parafjalore në funksion të rrethanorit të vendit

24. Faton **Krasniqi**: Leksiku i huaj në tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar VI- IX

E MËRKURË, 23 GUSHT 2017

Ora 9:00 **Tryeza e doktorantëve**
Letërsi

Drejtues: Marjela Progni, Shqipe Haziri

1. Zahrie **Kapllanaj**: Faktet dhe poezia
2. Gjylë **Totaj**: Herezia e Dervish Mallutës dhe Palimpsest për Dush Kusarin
3. Marjela **Progni-Peci**: Dashuria nën sfondin e ngjarjeve historike
4. Shqipe **Haziri**: Romani *Kënga shqiptare* dhe historia
5. Vjona **Sylejmani**: 'Teoria e origjinalitetit' – mes faktesh dhe fiksjonit letrar
6. Seadet **Beqiri**: Fiksioni letrar në dramën "Katër epoletat" – H.Mulliqi

10:30 Pushim

11:00 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Saranda Buzhala, Teuta Sula

7. Hysni **Ndreu**: *Libri i burgut* i Arshi Pipës si tekst faktografik
8. Neli **Naço**: Pikëvështrimi, vendndodhja dhe hapësira në poezinë "Poradeci"
9. Adriana **Duka**: Të dhënat historike dhe fantastikja në tregimet e Kim Mehmetit
10. Teuta **Sula**: Udhëpërshkrime të Edit Durhamit
11. Drita **Isufaj**: Uji si simbol i erotizmit në krijimtarinë popullore

12:30 Pushim

16:30 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Meliza Krasniqi, Loreta Loli

12. Jorida **Sotiri**: Femra, personazhi i simbolizuar
13. Loreta **Loli**: Raporti mes faktit e fiksionit në veprën e Konicës
14. Armonela **Paja**: Tipare novatore të narracionit në veprat e Kadaresë
15. Meliza **Krasniqi**: Fakt apo fiksion - ditari letrar
16. Saranda **Buzhala**: Tragjedia e rrënjëve si baladë për humbjen

17:45 Pushim

18:00 **Vazhdim i tryezës**

Drejtues: Flamur Maloku, Serafina Lajçi

17. Blerina **Rogova Gaxha**: Vdekja në *Andrrën e jetës*
18. Orjela **Stafasani**: *Pasardhësi* mes faktit dhe fiksionit
19. Arian **Krasniqi**: Skënderbeu në dramën e Whnichop-it, Lillo-s, Havad-it, dhe Faurres-it
20. Mimoza **Hasani Pllana**: Elemente faktike dhe fiksonale te poezia e Sabri Hamitit
21. Serafina **Lajçi**: 'Mino', mes faktit dhe fiksionit
22. Flamur **Maloku**: Letërsia e burgut përballë faktit dhe fiksionit

E ENJTE, 24 GUSHT 2017

Ora 9:00 Sesiione shkencore

E PREMTE, 25 GUSHT 2017

Ora 9:00 Sesiione shkencore

Ora 13:00 Mbyllja e punimeve të Seminarit XXXVI

Ora 20:00 Darkë e lamtumirës

SESIONI SHKENCOR I GJUHËSISË

Qendrat e zhvillimit të shqipes

E ENJTE, 24GUSHT 2017

Ora 9:00 **Seanca I**

Seancën e drejtojnë: Anton Panchev, Xhavit Beqiri

1. Naser **Pajaziti**: Studimet dialektologjike në Kosovë
2. Xhavit **Beqiri**: Fishta dhe shkolla shqipe
3. Asllan **Hamiti**: Puna mbi 60-vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe e Letërsisë shqiptare në Universitetin e Shkupit
4. Berton **Sulejmani**: Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë shqipe e Universitetit të Tetovës
5. Anton **Panchev**: Sofja si qendër e zhvillimit të shqipes

Ora 10:45 Pushim

Ora 11:00 **Vazhdim i seancës I**

Seancën e drejtojnë: Maria Morozova, Giuseppe Chiaramonte

6. Aleksandër **Rusakov**, Aleksandër **Novik**, Maria **Morozova**: 60 vjet të studimeve albanologjike në Rusi: veprimtaria e degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin Shtetëror të Sankt-Peterburgut
7. Valbona **Hystuna**: Hapësirat e shqipes në Greqi
8. Tomorr **Plangarica**, Merita **Plangarica**: *Shkolla Normale* e Elbasanit dhe studiuesit elbasanas për studimin e zhvillimin e shqipes në gjysmën e parë të shekullit XX – përvojë që u përftua e nxitur prej një tradite dhe nxitit shqyrtime të mëtejshme.
9. Giuseppe **Chiaramonte**: Diakronia e arbërishtes së Siqelisë përmes mbishkrimeve

Ora 16:00 **Seanca II**

Seancën e drejtojnë: Mimoza Priku, Linda Meniku

1. Valbona **Sinanaj**: Instituti i Studimeve Albanologjike në Universitetin “La Sapienza” të Romës dhe kontributi i profesorëve Giuseppe Gradilones e Elio Miraccos
2. Mimoza **Priku**: Shkodra - qendër e rëndësishme e leksikografisë shqipe
3. Fitor **Ollomani**: Gjuha shqipe në “Kanunin e Lek Dukagjinit”
4. Juljana **Kume**: Për një gramatikë të re të shqipes, prova të e-learning dhe të ludolinguistikës (kontribut i Departamentit të Albanologjisë, UNICAL, nën drejtimin e F. Altimarit)
5. Linda **Meniku**: Vështrim krahasues për gjuhën e administratës në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi

Ora 17:45 Pushim

Ora 18:00 **Vazhdim i seancës II**

Seancën e drejtojnë: Shkumbin Munishi, Julie Kolgjini

1. Edlira **Troplini-Abdurahmani**: Roli i studimeve sociolinguistike në zhvillimin e shqipes
2. Shkumbin **Munishi**: Studimet sociolinguistike të Rexhep Ismajlit për shqipen standarde
3. Julie **Kolgjini**: (Re)valorizing linguistic loot: The case of diaglossic Albanian in multiple spheres
4. Haki **Hysenaj**: Varieteti gjuhësor i parlamenteve shqiptare- përkime dhe diferenca
5. Majlinda **Bushaj**, Marjan **Lulçuraj**: Një vështrim për gjuhën e botimeve shqipe në Malin e Zi në këtë shekull (2001-2017)

E PREMTE, 25 GUSHT 2017

Ora 9:00 **Seanca III**

Seancën e drejtojnë: Tanja Trajković, Haki Hysenaj

1. Shpëtim **Elezi**: Grupe paradigmatiche të mbiemrave në Çetën e Bogdanit
2. Fridrik **Dulaj**: Rreth ndihmesës së Tafil Kelmendit në gjuhësinë shqiptare
3. Maria **Peeva**: *Zallahish-li pës neve?* – E folmja shqipe e Mandricës në librin e ri të Ludmill Stankovit
4. Shkelqim **Millaku**: Zbritja e arbëreshëve në Greqi sipas Aristidh Kolës
5. Tanja **Trajković**: Frazodidaktika në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë së Beogradit
6. Kledi **Shegani**, Helena **Grillo**: Mësimi i shqipes si gjuhë e dytë , urë lidhëse në komunikim

Ora 10:45 Pushim

Ora 11:00

Vazhdim i seancës III

Seancën e drejton: Aljula Jubani, Aida Uruçi

1. Bardh **Rugova**: Leksiku i arbnesëve të Zarës
2. Aljula **Jubani**: Shkolla françeskane, një traditë e rëndësishme e studimeve albanologjike
3. Elona **Limaj**: Fjalë të vjetra, kuptime të reja
4. Valbona **Kalemi**: E folmja e lumit të Kardhiqit si kalimtare nga e folmja e Labërishtes si nëndialekt i saj drejt të folmes së qytetit të Gjirokastrës
5. Elvis **Bramo**: “Disa veçori të gjuhës së shkruar me alfabet grek në shekullin XVIII”(Voskopoja)
6. Aida **Uruçi**: Kontributi i vyer i M. Camajt në revistën ”Shëjzat”

SESIONI SHKENCOR I LETËRSISË

Fakti dhe fikcioni në letërsi

E ENJTE, 24 GUSHT 2017

Ora 9:00 **Seanca I**

Seancën e drejtojnë: Nysret Krasniqi, Lili Sula

1. Nysret **Krasniqi**: Histori e letërsi nacionale
2. Abdulla **Rexhepi**: Fiksioni si mjet i kuptimit të realitetit transcendent në poezinë e Nezim Frakullas
3. Avdi **Visoka**: Fakti dhe fikcioni në romanin e Pashkut dhe Le Clézio-s
4. Albanë **Mehmetaj**: Letërsi dhe e vërtetë (Fakti dhe fikcioni letrar sipas Ibrahim Rugovës)
5. Merxhan **Avdyli**: Fakti si pikënisje e krijimit të realitetit të dytë në krijimin e poezisë
6. Adem **Jakllari**, Silvestër **Manaj**: Arkitektura reale dhe ajo fikzionale e Gjirokastrës të Kadareja
7. Lili **Sula**: Fiksioni vs. faktit në veprën Epika e yjeve të mëngjesit të R. Erebarës

Ora 10:45 Pushim

Ora 11:00 **Vazhdim i seancës I**

Seancën e drejtojnë: Erenestina Halili, Edmond Çali

8. Blerina **Suta**: Arti - Panair si lajmës i fiksonit pa fakt. Rudian Zekthi dhe brezi i viteve'90
9. Vjollca **Osja**: Faktualja dhe fikcionalja në tekstin narrativ të Konicës
10. Viola **Isufaj**: Zef Zorba: biografi dhe poezi
11. Edmond **Çali**: “Trebeshina & Kadare – fakti dhe fikcioni në *Dafinat e thara, Kënga shqiptare* dhe *Dimri i vetmisë së madhe*”

12. Anila **Mullahi**, Beti **Njuma**: Shndërrimi në fikson i faktikes, në tregimin shqiptar
13. Erenestina **Halili**: Bibliografia e munguar e dramës shqipe
14. Hamit **Xhaferi**: E vërteta dhe fikcioni në prozën romanore të F.Kongolit dhe V.Zhitit

Ora 16:00 **Seanca II**

Seancën e drejtojnë: Agron Gashi, Belfjore Qose

1. Eljon **Doçe**: “Statusi i dyfishtë në veprën e Át Zef Pllumit”(Fakti në fikson në “Rrno vetëm për me tregue”)
2. Belfjore **Qose**: Imagjinaria dhe realja në romanin *Rrathë* të M. Camajt
3. Ermir **Xhindi**: Gjendjet fiksonale të faktit si gjendje të leximit
4. Agron **Gashi**: Fakti dhe fikcioni në *autoconfession*(Një përballje teorike)
5. Virion **Graçi**: Fakti dhe fikcioni në dy romane të I. Kadaresë, “Kronikë në gur” dhe “Darka e gabuar”
6. Sherif **Selimi**: Fakti dhe fikcioni në romanet e Kim Mehmetit

Ora 17:45 Pushim

Ora 18:00 **Vazhdim i seancës II**

Seancën e drejtojnë: Ag Apolloni, Teuta Vinca Kafexholli

7. Ag **Apolloni**: Arti i arkivave (Romani “Gurit të varrit ia rrëfej” i Agron Tufës)
8. Ledri **Kurti**: Anton Harapi - Realiteti shqiptar dhe arti, përmes vëzhgimit, filozofisë dhe specifikave
9. Brikena **Smajli**: Një vështrim mbi poetikën e kujtesës në letërsinë shqipe
10. Teuta **Vinca Kafexholli**: Fakti dhe fikcioni në plan krahasues mes tre shkrimtarëve dhe tri regjioneve gjuhësore ballkanike
11. Vehbi **Miftari**: Barleti- kujtesa e rrëfyeme

E PREMTE, 25 GUSHT 2017

Ora 9:00 **Seanca III**

Seancën e drejtojnë: Dije Demiri- Frangu, Kujtim M. Shala

1. Femi **Cakolli**: Fakti dhe fikcioni në letërsinë sakrale
2. Dije **Demiri- Frangu**: Emocioni si fakt
3. Kujtim M. **Shala**: Fiksioni letrar
4. Gazmend **Krasniqi**: “Historia” e romanit dhe “romani” i historisë
5. Jolanda **Lila**: Gjurmë të realitetit social-kulturor e politik shqiptar në poezinë e Dritëro Agollit
6. Murteza **Osdautaj**: Realitetet paralele në romanin e Dritëro Agollit

Ora 10:45 Pushim

Ora 11:00 **Vazhdim i seancës III**

Seancën e drejtojnë: Anton Berishaj, Albulena Blakaj - Gashi

1. Mariglana **Memimaj**: Raporti histori-fiksion në prozën e Vath Koreshit
2. Arben **Hoxha**: Fakti dhe fikcioni në këndvështrimin fenomenologjik
3. Arben **Prendi**: Bota shqiptare te novelat e M. Camajt mes faktit dhe fikSIONIT
4. Zamira **Shkreli**, Ermira **Aliaj**: Roli i përrallave si gjuhë simbolike mes reales dhe “fiction”-it, në edukimin e fëmijës parashkollor
5. Anton **Berishaj**: Letërsia dhe botët e mundshme fiktive
6. Isak **Shema**: Njëqind e njëzet- vjetori i lindjes së Shime Deshpalit

SESIONI SHKENCOR I KULTUROLOGJISË

Media dhe identiteti kulturor

E ENJTE, 24 GUSHT 2017

Ora 9:00 **Seanca I**

Seancën e drejtojnë: Haqif Mulliqi, Alban Zeneli

1. Haqif **Mulliqi**: Ndërtimi i identitetit kombëtar nëpërmjet etno- simboleve dhe roli i medieve të reja në shpërndarjen e tyre
2. Florent **Rrahmani**: Kosova dhe fjala publike: përballë pa/përgjegjësisë
3. Rovena **Vata**: Ndhimesa e revistës “Shêjzat” në ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar
4. Eugent **Kilapi**: Karakteristika të përmbajtjes së tematikës kulturore të mediave të përditshme në Shqipëri në vitet 2013-2015
5. Ismet **Osmani**: Gjuha shqipe në komunikimin publik - roli i medimeve në gjuhën dhe kulturën shqiptare

10:30 Pushim

11:00 **Vazhdim i seancës I**

Seancën e drejtojnë: Shpresa Mulliqi, Donik Sallova

6. Mimoza **Shqefni**, Emiliano **Shqefni**: Ndikimi i teknologjisë në përcimin e vlerave kulturore identitare (rasti i digjitalizimit të fondeve të trashëgimisë kulturore në IAKSA)
7. Donik **Sallova**: Roli i medias në krijimin e identitetit kulturor kombëtar shqiptar
8. Alfred **Halilaj**: Lëvizja e popullsisë, media dhe kultura
9. Shpresë **Mulliqi**: Roli i teknologjisë informative në ndërtimin e identitetit të diasporës
10. Merita **Selimi Spahija**: Qeramika, udhëtim në kohë, nga produkti tradicional në atë industrial

ABSTRAKTET

Bekim Xhelili

Muzeu i Kosovës – kontributi dhe sfidat në fushë të kulturës

Në këtë punim synoj të pasqyroj punën, kontributin dhe të arriturat e Muzeut të Kosovës në fushën e kulturës përmes sektoreve të tij dhe njëkohësisht ti paraqes vlerat kulturore dhe artistike të koleksionit muzeal. Rëndësi do ti kushtohet dhe sfidave që është duke kaluar në vitet e fundit, sikurse mungesa e ekspozitës së përhershme në ndërtesën kryesore, plotësimi dhe sistematizimi i kuadrit profesional, pastaj mungesa e hulumtimeve dhe ekspeditave kërkimore - mbledhëse të materialeve dhe eksponateve në krahinat e Kosovës me qëllim të plotësimit të fondit muzeale si dhe mos aktivizmi pas luftës i revistës shkencore Buletini i Muzeut.

Aleksandër Novik

Dasma “arnaute” (“greko-shqiptare”) në rajonin e Detit Azov (materialet e studimeve shkencore në terren të viteve 2015-2016)

Në brigjet e detit Azov si pasojë të luftimeve turko-ruse në gjysmën e dytë të shekullit XVIII janë themeluar disa vendbanime me popullsinë arnaute: fshati Margaritovo, fshati Epirskoje, fshati Himara, fshati Allbanskoje etj. (rajonin e Rostivit, rusisht qyteti quhet *Rostov na Donu*). Në vitet 2015 – 2016 Akademia e shkencave e Rusisë dhe Universiteti Shtetëror i Sankt Peterburgut kanë organizuar dy ekspedita në këto vendbanime. Studimet në terren na kanë lejuar të grumbullojmë shumë materiale etnografike lidhur me dokët dhe zakonet familjare në rradhë të parë me dasmën tradicionale për të cilat bie fjalë në këtë referim.

Institucioni shoqëror i martesës (zgjedhja e bashkëshortit / bashkëshortes, kushtet ekonomike dhe sociale të nënshkrimit të martesës, faktori rajonal, stereotipet etnike etj.) dhe ritet martesore tek pasardhësit e popullsisë arnaute të rajonit të Detit Azov janë transformuar dukshëm në shekullin XIX – fillim të shekullit XXI nën ndikim të etnive që jetojnë në këtë zonë – kryesisht rusët, ukrainasit, armenët etj. Dasma është një nga ngjarjet kryesore jo vetëm në jetën e njeriut, i cili ndryshon statusin e tij social në mënyrë të dukshme, por edhe në jetën e familjes së tij, të farefisit,

shoqërisë vendase, nganjëherë madje edhe të komunitetit fisnor dhe krahinor. Autori në bazë të materialeve të vjela në terren gjatë ekspeditave rindërton kodin veprues të dasmës, duke sqaruar skenarin e ceremonive martesore në vitet 1940-1960, të cilat konsiderohen nga të anketuarit kryesorë dhe me autoritet si tradicionale dhe “greke” (sic!). Në këtë kumtesë analizohet leksiku i termimologjisë së riteve të dasmës (ky fjalor është shumë i pasur), vjelë nga autori, si dhe rrëfimet e regjistruara në të folmen vendase të rusishtes tek banorët e fshatrave Margaritovo, Çumbur Kosa etj. që kanë lindur në vitet 1920-2000; ky fakt lejon të bëhen krahasime të gjendjeve kalimtare që ndodhin në fushën e gjuhës dhe të traditave. Ritet dhe zakonet martesore që janë ndikuar fort prej traditave të etnive të tjera (si pasojë e kontakteve intensive me fqinjë të afërt rusë dhe ukrainas, si dhe proceseve të globalizimit në dhjetëvjeçarët e fundit) dhe struktura e të cilave është transformuar ndjeshëm me risi në kushtet e zbehjes së vazhdueshme të traditës, nga pikëpamja e metodikës shpjegohen me shumë shembuj materialesh të grumbulluara në terren. Fakti i rëndësishëm që fiksohet në rajonin e Detit Azos është revitalizimi i traditave që kanë të bëjnë me kulturën arnautë (greko-shqiptare).

Natalia Badiyan-Siekierzycka **Edith Durham and Albania**

Edith Durham was an English Victorian traveler and writer who travelled extensively in the Balkans focusing particularly on Albania. She wrote seven books on Balkan affairs, the most popular of which is *High Albania*. Edith Durham explored the Balkans on her own, learning the languages and cultures in her middle age, travelling and living under primitive conditions. In the beginning of her Balkan travels her perception of the Balkans and Albania did not differ much from other Western travelers who had visited this region before her. The traveler perceived the local people with sympathy but also with a certain dose of imperial superiority often playing the role of a mental educator and a person who knows better how to live and how to conduct political and social matters. However, with a course of time her vision of Albania and Albanians became clarified as she got more acquainted with this nation and its culture. She took an active part in the struggle for independence of Albania. She became a public advocate for the Albanians and Albanian cause. With the passing of time her ideas and views regarding Albanians became more and more uncompromising. Being convinced that Albanians had all rights to have their state she criticized hesitant steps done by her compatriots and other Western countries in assistance of this idea. Muslim Albanians simply failed to evoke the same

levels of sympathy. Durham's pro-Albanian sympathies moved her increasingly into an anti-Serb position. She perceived Serbs as the worst Albanians' enemies. This attitude led her to anti-Slavic sentiment. Her conflict with Rebecca West and especially Robert Seton-Watson who were supporters of Yugoslav idea whereas Edith Durham was a decided opponent of this idea was not without significance as well.

Sedat Baraliu, Premtim Alaj **Vendbanimet dardane të Periudhës së Hekurit në Kosovë**

Punimi Vendbanimet e Periudhës së Hekurit në Kosovë trajton llojet, organizimin dhe arkitekturën e vendbanimeve të Periudhës së Hekurit në territorin e Kosovës.

Një trajtim të veçantë do të zërë organizimi i vendbanimeve të fazës së parë të hekurit, të cilat janë fortifikime të tipit Gllasiac, të cilat janë kryesisht vendbanime kodrinore. Gjithashtu, do të trajtohet edhe evoluimi i vendbanimeve gjatë tri fazave të hekurit. Dallohen tri lloje të vendbanimeve të e periudhës së hekurit në territorin e Kosovës: vendbanuimet kodrinore, vendbanimet terracore dhe ato të rrafshta. Disa vendbanime nuk kanë ndërprerje të jetës që nga periudha Neolitit të cilat vazhdojnë deri në periudhën helenistike dhe pastaj edhe asaj të antikitetit të vonë. Të një rëndësie janë vendbanimet e fazës së parë të hekurit, të cilat dallohen me një sistem të fortifikuar me mure. Muri është ndërtuar prej gurësh gëlqerorë, me përmasa përafërsisht 0,60-0,90 m dhe 0,54x0,78 m, me trashësi 3,50-3,60 m. Ai përbëhet prej dy faqesh të brendshme dhe të jashtme, ndërsa në brendësi ka mbushës me gurë mesatarë dhe të vegjël. Faqja e tij e jashtme është e përbërë prej jo më shumë se dy ose tri radhë gurësh. Muri nuk ka themel, por është vendosur drejtpërdrejt mbi terren. Po ashtu në Kosovë ekzistojnë disa vendbanime të kësaj periudhe, të cilët fortifikohen me ledhe guri me dhe të thatë. Vendbanimet e kësaj periudhe kanë qenë të ngritura në kodra në anën më të hapur ka qenë e mbrojtur me dy radhë muresh, që rrethojnë anët më lehtë të kapërcyeshme. Mbi bazën e tipologjisë së mureve rrethuese, paraprakisht mund të shprehemi për ngjashmëri me muret e tipit Gajtan, të cilat i takojnë periudhës së hekurit.

Fjalët kyçe: Vendbanimet, Periudha e Hekurit, Kosovë

Giovanni Belluscio

How does Serafina Thopia (1839) end?

Si mbaron Serafina Thopia e vitit 1839?

Botimi i parë i *Serafina Thopia*-s ruhet sot vetëm në dy kopje, njëra në Fondin Giuseppe Gangale (1898-1978) pranë Bibliotekës humanistike (BAU) në Universitetin e Kalabrisë, dhe tjetra në Bibliotekën Kombëtare në Napoli. Që të dy kopjet janë të cinguara, d. m. th. ato mbarojnë me faqen 64 dhe me rreshtat 1-133 të këngës së XI, e cila ka titullin "*Fialeve*" (= Fialëve), pra, deri sot nuk njihet as mbarimi i kësaj kënge dhe as përfundimi i librit. Për herë të parë do të prezantohet këtu, pas 178 vitesh prej botimit të parë të veprës, pjesa e panjohur dhe e sapozbuluar që u botua italisht nga vet De Rada në numrin e 14 janarit 1841 të *Omnibus pittoreSCO*, revistë e përjavshme e arbëreshit Vincenzo Torelli (gazetar prej fshatit Barile të Bazilikatës) e cila dilte në Napoli një herë në javë.

Gani Pllana, Sadete Pllana

Formimi dhe shqipërimi i terminologjive teknike shqipe

Formimi i terminologjive teknike në gjuhën shqipe lidhet kryesisht me krijimin e fushave të dijes të tyre, të cilat kanë një histori të vonshme që i përket fillim të shek. XX, ndonëse duhet pohuar se një varg termash janë huazuar prej tyre nga shkencat bazë teorike-shkencore si nga matematika, gjeometria, kimia etj. Një pjesë e tyre kanë hyrë drejtpërdrejt me to, kurse të tjerat kanë shërbyer si bazë për formime togfjalëshore për nevoja të këtyre terminologjive.

Nga ana tjetër duhet theksuar se një pjesë e termave teknikë shqip janë ndërtuar mbi bazën e fjalëve të zakonshme, të cilat kanë shërbyer në një fazë ndërmjetëse edhe në fushat e zanateve si profesionalizma. Nga pikëpamja e lashtësisë së evidentimit të këtyre njësive mund të gjykohet për autoktoninë e tyre, çka i jep karakter origjinal autokton dhe shqiptar edhe vetë këtyre formave të hershme. Disa prej tyre kanë hyrë në terminologjitë përkatëse me kuptimet e tyre ekzistuese si në fushën e ndërtimit: derë, tavan, dysheme, disa të tjera janë përdorur për konceptet e reja si njësi të terminologjizuara ose të riterminologjizuara kurse të tjerat kanë shërbyer si bazë për formimet e reja si: suvatim, ndërçelës etj.

Duke vështruar lëvizjet zigzage të këtij leksiku amtar qysh nga lashtësia mund të nxirren në pah "përplasjet" e tij me leksikun e huaj, të cilin në pjesë më të madhe e ka nxjerrë jashtë gjuhe, ndonëse në raste të tjera ka bashkëjetuar me të në kushtet e një konkurrence të fortë.

Mustafa Ibrahim

Procesi i zhargonizimit të fjalëve shqipe me anë të ndajshesave të huaja

Shumëllojshmëri leksikore është një lloj pasurie, e cila gjithashtu duhet ruajtur njëfarësoj, së paku në arkiva ose **dat baza etno-gjuhësore**. Morfologët që merren me fjalëformimin, gjithnjë kujdesen të gjejnë nëse një ndajshesë e caktuar është apo jo aktive brenda shqipes. Si ndodh kjo është e lehtë për t'u marrë me mend: në fillim folësit e dallojnë prapashtesën duke analizuar bashkësinë e fjalëve përkatëse të huazuara; pastaj e veçojnë këtë prapashtesë dhe e përdorin me tema të tjera. Si prapashtesa më karakteristike të huaja për këtë çështje, janë prapashtesat: – **iada, -oid, lend (-land), -stan, -mania** etj. me të cilën brezat e mëparshme kanë krijuar fjalë përkatëse, por sot janë duke u zgjeruar me tema dhe kuptime të tjera. **-iada**: Zhargonizmi i fjalëve me këtë prapashtesë, mund të përmblihen në disa fusha karakteristike, siç janë: **Takime, lojëra dhe shoqërime, zakonisht të përcjella me gara: ballkaniada** (lojëra sportive ballkanike); *universiada* (takime sportive të studentëve nga universitete të ndryshme); *brucoshiada* (takim me rastin e fillimit të vitit akademik të studentëve të vitit të parë); *absolventiada* (festimi i absolventëve në fund të diplomimit); *spartakiada* (lloj garash sportive); *Al-nobeliada*. një shfaqje e zhvleftësimit dhe konsumimit të fjalëve është dhe nevoja për të krijuar fjalë të reja nëpërmjet prejardhjes. Prapashtesat dhe prapashtesat që i shtohen një fjale për krijuar një fjalë e re. *Huazimet janë kryesisht leksikore*, por mund të jenë edhe **huazime gramatikore**. Në një kuptim, këto fjalë u ngjajnë martesave ndër raciale; dhe një lloj sikurse këto martesë, luftohen me energji të madhe nga puristët, meqë thjesht ekzistenca e tyre në gjuhë ua përgënjeshtrojnë ideologjinë që i frymëzon.

Fjalët çelës: fjalëformime, prapashtesa, zhargonizimi, huazime leksikore, huazime gramatikore

Daniel Jordanov Tomov

Etimologjia e fjalëve për emocionet negative në gjuhët ballkanike: zemërim, egër, mëri, pezëm

Vështrohen kuptimet, origjina, semantika dhe marrëdhënie sintaktike dhe fonetike midis gjuhëve ballkanike. Fokusi i temës është mbi semantikën dhe fonetikën. Për mua është shumë interesante dhe rëndësishme t'i vështroj edhe rrënjët indoeuropiane. Analizohet ndryshime fonetike në çdo gjuhë ballkanike. Për bullgarishten fjalët janë krahasuar me gjuhë të tjera sllave –

rusishtja, polonishtja, çekishtja dhe bullgarishtja e vjetër. Fjalët në shqip dhe rumanisht janë komentuar në bazën e latinishtes. Është interesant varianti **greqisht > latinisht > shqip dhe rumanisht**. Ka shumë ngjashmëri midis gjuhëve ballkanike. Nga semantika, kuptimi dhe fjalëformimi interes përbëjnë fjalët **gazepmadh dhe inat, mëri, pezëm**. Kam bërë tabelë ku fjalët janë klasifikuar sipas semantikës dhe kuptimit. Materialet janë ekscerpuara nga fjalori i etimologjisë (shqip, bullgarisht, greqisht, rumanisht dhe etj), fjalori i sinonimeve, fjalori i gjuhëve indoeuropiane, fjalori shpjegues dhe etj. Në kumtesë janë analizuar të dhënat e mbledhura nga Eqrem Qabej, Bardyl Demaj, Norbert Jokyl, Orel, Gustav Weigand. Fjalë kyçe: Etimologji, fonetikë, semantikë, fjalëformimi, gjuhë ballkanike, emocione.

Carrie Ann Morgan

Gratë në ‘kontroll’: Nerva e në ndërrimin e kodit (code switching) ‘të trashë’

Gjuhëtarët kanë shkruar që në rastin e variacionit të pandryshueshëm gjuhësor, gratë kanë prirje të përdorin variantin që cilësohet si më ‘standard’ (Eckert, 2011). Por ky pohim, gjithsesi, përmban një sërë supozimesh problematike. Në radhë të parë, kategoria e ‘gruas’ nuk është homogjene dhe në radhë të dytë, edhe pse kjo mund të jetë prirje, pohimi e lë të hapur pyetjen e kuptimit që bart sjellje gjuhësore jashtë kësaj prirje. Me fjalë të tjera, si mund të shfrytëzojnë këtë prirje gratë duke u sjellë ndryshe për të shprehur kuptime të ndryshme socio-indeksuese? Në këtë kumtesë, do të prezantoj shembuj ku gratë demonstrojnë kontrollin e tyre gjuhësor (Babel, 2016) duke ndërruar kodin në momente të saktuara për të shprehur nerva, dëshmi që dialekti mund të përdoret për të zhvilluar regjistra të ndryshme (Irvine, 2001).

Matvey Lomonosov

Identiteti Kombëtar si Perpjekje Morale: Intelektualet shqiptare dhe formiti i nje kunder-miti per Betejen e Kosoves, 1389

Literatura mbi nacionalizmin dhe ndërtimin e identitetit tregon për rolin vendimtar të miteve të spikatura historike në forcimin e identitetit kombëtar dhe shkaktimin e konfliktëve ndëretnike. Megjithatë, shumë më pak vëmendje kushtohet pyetjes se çfarë i motivon mitberësit. Teoricien të shkollave “etno-simboliste” dhe “modernise” kanë tendencë për të shpjeguar motivet e mitberesve nënë një mënyrë dikotome. Disa autorë

mendojnë se mendimi e krijuesvë të narrativeve kombëtre tjesht pasqyron kujtesën popullore shumëshekullore. Të tjeret, ngulen këmbet se mitberesit jane ndikuar prej kontekstit aktual politik. Me fjalë të tjera, krijuesit e miteve shihen ose si viktime të tregimeve dhe identiteteve të qendrushme ose si aktorë racionalë dhe interesuar. Analiza e procesit te krijimit te narrativit kosovar shqiptar për betejën e Kosovës bën evidente që tregimet nacionale fillimisht mund të shfaqen si kundër-mite. Akoma me domëthenës është fakti që prodhuesit e ketyre miteve nuk janë motivuar as nga kujtesa shumëshekullore etnike as nga interesat e çastit. Përndryshe, ata e shikojnë mitberje si një fare detyrimi moral, që u imponon roli social i “mbrojtësve” të vlerave dhe dinjitetit të kombit. Ky rol, në vendin e vet, është rezultat e socializimit dhe profesionalizimit e intelektualëve ne institucionet kërkimore dhe arsimore, qellimi e të cilëve qysh nga periudha jugosllave ka qenë “afirmimi i kombit.”

Gabriela Abrasowicz
Transcultural potential in works of the contemporary Albanian playwrights and theatre producers from Kosovo

The phenomena perceptible in the contemporary sphere of drama and theatre, whose basic premise – after all – is encounter and interaction, testify to the pervasion and transfer of elements from various cultures.

The cultural scene in Kosovo seems especially complex and dynamic and it is political, social, economic and cultural transformations which originated there have generated widespread interest since the 1990s. Admittedly, this can not be attributed to artistic phenomena, but as a result this culture has become a focus of attention.

However, despite increased interest, Albanian artistic creations, especially playwriting and theatrical scene in Kosovo that emerged after 1990 still remain practically unknown, waiting their turn to be properly interpreted and assessed.

Initially, culture-forming processes focused on emphasising the unique character of Albanian drama and theatre in Kosovo, yet after a period of rift and separation, there came a turn towards cooperation, facilitation of cultural transfer and forming bonds. This kind of cultural output reflects the local specificity and represents sphere of artistic activity that can be characterised by transcultural potential, an exceptionally great degree of performativity, the power to create the reality and new grounds for dialogue.

I would like to analyze and present the transfers and transactions taking place in contemporary Albanian drama and theatre in Kosovo, which testify

to the existence of new artistic sensitivity. It will look into the manner of how artistic, socio-political and philosophical ideas are transposed and (re)constructed in the work of playwrights and theatre producers such as e.g. Jeton Neziraj, Doruntina Basha and Arta Arifi.

It seems really interesting to present and discuss examples of this artistic creation from the transcultural perspective.

Atdhe Hykoli

Përligjja e miteve në këngët rituale kalendarike te shqiptarët

Njeriu mësoi të kremtonte rite fetare, festa për gjahun, për fillimin e stinëve dhe t'i shoqëronte ato me këngë ritual, të cilat mund t'i hasim ende në viset që nuk janë prekur nga 'moderniteti'. Megjithatë, është e vështirë të paraftyrohet një qytetrim memec, i paaftë të këndojë për t'i shprehur ndjenjat e veta. Kënga shpesh u ka dhënë zë pasioneve kolektive në çastet e mëdha të punës, të besimit (idealitetit) e të kënaqësisë.

Fjalë kyçe:Këngët rituale, festat, mitet, besimi, mistike, etj

Besim Kabashi

AICo – një korpus tekstesh i gjuhës shqipe me 100 milionë fjalë

Pothuajse është e pamundur të bëhen studime serioze në fushën e gjuhëve natyrore pa u bazuar në të dhëna empirike. Si mjet ndihmës që ofron këto të dhëna duke i përmbajtur ato në vete të paprekura, pra të pandryshuara, janë korpuset e materialeve gjuhësore. Ndër të tjera, korpuset mundësojnë edhe studime cilësore si dhe përshpejtojnë njëkohësisht punën e përdoruesve të tyre – për më tepër i largojnë ata nga të dhëna joempirike apo të konstruata e përshtatura sipas rastit. Që të shfrytëzohen këto të mira që ofron një korpus, më parë duhet krijuar ai si resurs, një punë jo e thjeshtë, por e domosdoshme.

Të pranishmit do të njoftohen me punën për ndërtimin e korpusit, të dhënat që ai përmban dhe mundësitë që ai ofron për studime të gjuhës. Ata do të shohin përdorimin e tij në formë interaktive duke pasur kështu mundësinë që të propozojnë shembuj për t'i kërkuar dhe analizuar aty për aty.

Ardita Berisha

Kualifikimi epistemik i futurit në gjuhën shqipe

Në këtë punim do të paraqiten shenjuesit gramatikorë të futurit që përmbajnë vlerësim epistemik. Shenjuesit gramatikorë të futurit përveç që

shprehin një parashikim të folësit, ata mund të paraqesin vlerësim për atë se sa është i bindur folësi që veprimi i ardhshëm do të realizohet. Në gjuhën shqipe si të tillë mund të përdoren të tre shenjuesit e gramatikalizuar *do të shkoj, kam me shku(e)* dhe *kam për të shkuar*: 1. *Ajo do ta kalojë provimin, ka studiuar gjatë gjithë kohës*. 2. *Agoni ka me marrë Zanën me vete, ka thanë që pa to, s'shkon*. 3. *Të hënën kanë për të ardhur të gjithë, meqë do të shpërndahen certifikatat*. Duke qenë se që të tri trajtat përdoren edhe për të shprehur vlerësime të tjera të folësit, qoftë deontike, qoftë dinamike (sipas koncepteve të Palmerit (2000) dhe Huddlestonit(2002) mund të thuhet se ato nuk janë të specializuara vetëm si futurë epistemikë. Kështu që, për ta parë përdorimin e këyre trajtave, në këtë studim do të nisemi nga një qasje pragmatike-funksionale.

Një shkallë të lartë të epistemicitetit e paraqet përdorimi i së kryerës së thjeshtë dhe të tashmes në funksion të futurit. E kryera e thjeshtë, duke qenë se shenon veprim të përfunduar, kur përdoret në funksion të futurit ajo e paraqet veprimin si të sigurt. Koha e tashme, po ashtu, në funksion të futurit e paraqet një siguri të madhe të folësit për veprimin e së ardhmes, pasi që ajo e paraqet veprimin si të aktualizuar imperfektiv: 1. A: *Edhe ti shkove*. B: *Po, por do të kthehem prapë*; 2. A: *Kur do të shkoni atje*? B: *Me 29 maj nisemi*.

Fjalët çelës: futur epistemik, siguri, mundësi, e tashme, e kryer e thjeshtë

Bahri Koskoviku

Sintagmat parafjalore të shqipes nga këndvështrimi gjenerativist

Ndërtimet me parafjalë në studimet sintaksore të shqipes janë hulumtuar në kuadër të teorisë së togfjalëshit, e cila i trajton parafjalët si elemente funksionale që lidhin gjymtyrë të një togfjalëshi. Brenda këtij kuadrit teorik, që mbështetet kryesisht në teorinë e gjymtyrëve, por me specifika të veçanta që ka shqipja, në radhë të parë me fleksionin, parafjalët analizohen si njësi që nuk mund të përbëjnë bërthamën e një njësie sintaksore, meqë gjymtyra si koncept nënkupton fjalët emërtuese që i karakterizon pavarësia strukturore dhe semantike në fjali, gjë që parafjalët sipas këtij kriteri nuk i përmbushin këto kushte. Ato janë njësi gjuhësore të kushtëzuara nga pikëpamja semantike dhe funksionale dhe nuk mund të përbëjnë bërthamën e një togfjalëshi.

Vështrimi i sintagmave parafjalore me metoda strukturale vë në dukje se parafjalët hyjnë në kategorinë e fjalëve që mund të konstitujnë dhe karakterizojnë natyrën e një përbërësi, mbështetur në veçorinë funksionale për t'u shenjuar rasë elementeve që varen prej saj.

Studimet gjenerative avancojnë më tej studimin për kategorinë e parafjalëve në rrafshin sintaksor. Sipas konceptit gjenerativist nga

këndvështrimi sintaksor fjala analizohet si tërësi tiparesh, që përcakton natyrën një njësie gjuhësore nga pikëpamja kategoriale: si kategori funksionale apo semantike. Në kuadër të këtij punimi mëtojmë të bëjmë hulumtimin sintagmave parafjalore të shqipes mbështetur në teorinë X-Bar, duke i parë ato si projektim i një koke leksikore, mbështetur në tipare sintaksore që karakterizojnë natyrën e çdo përbërësi sintagmatik në strukturën e fjalisë.

Fjalët çelës: sintagmat parafjalore, parafjalët, gjymtyra, studimet generative, teoria X-bar.

Agnesa Hasimja

Folja në tekstet shkollore

Rol mjaft të rëndësishëm për të përmbushur objektivat e një mësimdhënësi gjatë një ore mësimore kanë edhe tekstet shkollore. Si në çdo lëndë mësimore, edhe në gjuhë shqipe, rëndësi merr vlerësimi drejt i pesë pjesëve përbërëse për mënyrën e trajtimit të koncepteve: emërtimi i konceptit, përkufizimi, karakteristikat, shembujt dhe përshkallëzimi (B.Rama,2013:107). Konceptet që lidhen me pjesët e ligjëratës, për nxënësit nga klasa e gjashtë e tutje pritet të jenë të njohura për shkak se ato janë pjesë e plan-programit të përgjithshëm edhe në shkollimin paraprak pesëvjeçar. Në këtë punim do të shtjellohet metodologjia e trajtimit të foljes në tekstet shkollore (si dhe ushtrimet) nga klasa e gjashtë deri në të dymbëdhjetën. Përmes krahasimit të teksteve, punimi do të vërë në pah përfshirjen e foljes në tërësi në këto tekste; si trajtohet ajo; a shkon duke u zgjeruar informacioni për foljen shkallë-shkallë nga cikli më i ulët në atë më të lartë.

Fjalët çelës: folja, metodologjia, tekstet shkollore

Mensur Vokri

Pikëpamjet e B. Bokshit dhe K. Topallit për prapavendosjen e nyjës shquese në gjuhën shqipe

Prapavendosja e nyjës shquese në gjuhën shqipe është një nga çështjet gramatikore më të rëndësishme, më të diskutueshme dhe më problematike në gjithë historinë e shqipes. Duke e pasur parasysh natyrën specifike e komplekse të kësaj çështjeje, janë bërë edhe përcaktime e zgjidhje të ndryshme gjuhësore nga gjuhëtarë të shumtë vendës e të huaj.

Për shkak të numrit të madh të autorëve që janë marrë me këtë problematikë gjuhësore, por edhe për arsye se e gjithë tematika trajtohet e përfaqësohet përmes dy teorive kryesore në historinë e albanistikës, ky

punim do të përqendrohet vetëm në pikëpamjet e dy gjuhëtarëve tanë, Bokshit e Topallit. Duke qenë se thelbi i prapavendosjes së nyjës shquese në shqipen, përveç disa nuancimeve, reduktohet kryesisht në dy teori, pra në atë të pozitës fillestare të paravendosur të kësaj nyje ndaj pjesëve të grupit emëror dhe në teorinë e pozitës origjinare të prapavendosur të saj ndaj elementeve të këtij grupi, rrjedhimisht, kështu arsyetohet edhe përzgjedhja e autorëve të sipërshënuar.

Janë përcaktuar këta gjuhëtarë, si dy nga përfaqësuesit më kryesorë të kohës sonë të dy teorive të ndryshme, sepse çështjes së nyjës në përgjithësi dhe prapavendosjes së nyjës shquese në veçanti, ata u kanë kushtuar edhe studime monografike. Janë të njohura në historinë e albanologjisë veprat shkencore të Bokshit *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes* (1980) e monografia *Prapavendosja e nyjës shquese në gjuhët ballkanike* (1984) dhe vepra studimore e Topallit *Nyjat e shqipes* (2009), të cilat, njëherësh, e përbëjnë edhe bazën teorike mbështetëse për këtë punim.

Përmes këtij punimi mëtohet të diskutohen e shpërfaqen teoria e paravendosjes së nyjës shquese dhe teoria e prapavendosjes së saj në shqipen, të përfaqësuar nga autorët që janë referencë e studimit dhe të nxirren dëshmi e argumente shkencore që e provojnë qoftë njëri, qoftë teorinë tjetër.

Fjalët çelës: pikëpamje, teori, prapavendosje, nyjë shquese, e paravendosur, shqipe, pozitë origjinare, emër, mbiemër, grup emëror

Adelinë Selmani

Mënyrat e fjalëformimit sipas temës fjalëformuese

Synimi i këtij punimi është trajtimi i mënyrave të fjalëformimit në varësi të temës fjalëformuese. Tradicionalisht, mënyrat e fjalëformimit në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhë të tjera përcaktohen sipas elementit të fundit që i bashkëngjitet temës aktuale, e cila është e tillë vetëm përderisa ka kapacitete për të marrë një formant fjalëformues. Parimisht është vështirë e zbatueshme, pasi jo gjithmonë e dimë se cili është elementi i fundit i shtuar apo se cila është tema e cila është zgjeruar ose konvertuar për të fituar fjalë të re, vështirësitë të tilla hasen kryesisht te tipi i fjalëve të formuara me prejardhje para dhe prapashtesore, ku duke e pasur pothuajse të pamundur identifikimin e elementit të fundit të bashkëngjitur, do të përdorim edhe parametra të tjerë si kontekstin e përdorimit të fjalës, uljen e regjistrit apo qëndrimin e folësit, si ndihmesa, në përcaktimin e llojit të fjalëformimit. Pikërisht marrja parasysh e këtyre parametrave bën që ky punim të tejkalojë

gramatikat tradicionale, të cilat klasifikimin e fjalëve sipas mënyrave të fjalëformimit e kanë bazuar në analizë të modeleve të gatshme.

Hulumtimi mbështetet në një korpus të përbërë nga tekste letrare dhe joletrare, të kategorive të ndryshme, dhe duke provuar të tejkalojë trajtimet e gjertanishme për mënyrat e formimit të fjalëve, synon të sjellë një qasje të re për temën fjalëformuese dhe llojet e fjalëformimit, në përgjithësi, në gjuhën shqipe.

Fjalët kyçe: tip fjalëformimi, temë fjalëformuese, prejardhje, folës.

Ilmi Rexhepi

Gramatikaliteti i formave dysore për të shquarën e emrave "Ferizaj" dhe "Skënderaj"

Në këtë punim trajtohen:

1. Historiku i formimit të këtyre emërvendeve
2. Prapshitesa "aj" vlera e saj ekskluzive për të formuar toponime dhe emërvende
3. Format për të shquarën e këtyre dy emërvendeve, statusi i tyre në fjalorë dhe historiku e masa e përdorimit të njëjës palë dhe të palës tjetër të trajtave
4. Arsytet pse kemi forma dysore për të shquarën e këtyre emërvendeve dhe aspekte gramatikore, fonetike dhe sociolinguistike që favorizojnë standardizimin e formave popullore "Ferizaji" dhe "Skënderaji", sikur emri "Memaliaji".

Yllka R. Imeri, Elizabeta Koch

Sistemi emëror i shqipes krahasuar me sistemin emëror të gjuhës portugeze

Synimi i këtij punimi është krahasimi i sistemit emror në mes gjuhës shqipe dhe asaj portugeze. Në fokus të këtij punimi kemi përdorimin e trajtave emrore, siç janë: lakimi i emrit, shumësi i emrit, gjinia e emrit, trajta e emrit dhe rasa e emrit, duke i krahasuar në mes dy gjuhëve që i kemi përzgjedhur. Hulumtimi bazohet në një korpus të caktuar, duke i krahasuar çështjet gramatikore të sistemit emror, të cilat do të pasqyrojnë dhe trajtojnë kategoritë gramatikore të emrit, në të dy gjuhët e zgjedhura. Punimi ynë i takon fushës së morfologjisë. Metoda të cilën kemi përdorur është metoda përshkruese krahasuese. Folësi i gjuhës së huaj krahason dhe mëson, njëkohësisht, përmes krahasimit i kupton më lehtë nocionet, trajtat dhe metodat e përdorimit të gjuhës së huaj, e lehtëson adaptimin e asaj gjuhe në

trurin e tij. Qëllimi i këtij punimi është t'i shohim dallimet në sistemin emror, në gjini, numër, rasa, dhe trajta, ku ne do ta prezantojmë strukturën morfologjike të emrit. Gjuhë bazë kemi gjuhën shqipe që i takon grupit të gjuhëve satem dhe gjuhën portugeze që i takon grupit të gjuhëve latine kentum. Nga të dhënat statistikore, të sakta, të nxjerrura nga punimi ynë do të shohim se si funksionon sistemi emror në këto dy gjuhë, ku do të shohim dallime të mëdha të mbaresat e gjinive, do të shohim mungesën e njëres prej gjinive në gjuhën portugeze dhe do të shohim se disa emra që në gjuhën shqipe janë të gjinisë femërore në gjuhën portugeze i gjejmë si emra të gjinisë mashkullore, prandaj kjo gjë ngrit shumë çështje për t'u diskutuar. Fjalët kyçe: krahasim, studim, klasifikim, dukuri, ngjajshmëri të veçanta, sistemi emror, gjuhë e huaj, gjuhë portugeze.

Senad Neziri

Zhvillimi i shqipes në rajonet bilinge në Prizren

Edhe pse Prizreni është identifikuar si qytet ku shqipja bashkëjeton ose shkrihet në një gjuhë të tretë, prapëseprapë mendimet e atilla nuk përkojnë me gjendjen reale në terren ose të pjesës më të madhe të terrenit ku shtrihet komuna. Nuk e mohojmë faktin që në pjesët e qytetit ka ndikime ose shkrirje të shqipes në gjuhë të tjera, por nuk duhet ta mohojmë faktin që shqipja është zhvilluar dhe ruajtur po në rajonet bilinge të territorit të komunës, përmes institucioneve shkollore, kulturore, bile edhe fetare.

Në kumtesën tonë, me të cilën planifikojmë të paraqitemi në këtë seminar (36), do të mundohemi ta trajtojmë çështjen e shqipes dhe zhvillimin e saj në rajonet bilinge në fshatrat e komunës ku shqipja është gjuhë e mësimit, ligjërimit fetar dhe kulturor, ndërsa gjuhët e komunikimit të përditshëm janë edhe varietetet e ndryshme të të folmeve minoritare, si në fshatrat: Mushnikovë, Lubizhdë, Skorobisht, Gërçar etj. Qëllimi ynë është që t'i sjellim fakte të reja rreth qëndrimit të popullatës minoritare ndaj shqipes dhe zhvillimin e ruajtjen e shqipes në zonat minoritare.

Për ta realizuar këtë punim kemi realizuar disa incizime të bisedave në lokalitete të lartcekura, kemi kontaktuar me udhëheqësit e institucioneve shkollore, kulturore e fetare të fshatrave të lartcekura, por kemi bërë një anketë me shoqërinë civile, ku kemi tentuar të marrim një mostër rreth gjendjes së përdorimit të shqipes në këto rajone. Rezultatet e këtij punimi do të kenë rëndësi për këtë fushë të gjuhësisë.

Fjalë kyçe: zhvillimi i shqipes, varietetet lokale, dygjuhësia, të folmet minoritare, etnolinguistika.

Sadat Agushi

Leksiku dialektor i muhaxhirëve të rrethinës së Preshevës

Në këtë punim do të mundohemi t'i japim disa dëshmi gjuhësore të së folmes së muhaxhirëve ë rrethinës së Preshevës, duke u përqëndruar kryesisht në leksikon e tyre dialektor. Në fillim do të paraqesim, në pika të shkurtra, një historik rreth shpërnguljes nga rrethi i Nishit dhe vendosjes së tyre në rajonin e Preshevës.

Punimi paraqet një pjesë të fjalorit dialektor, ku disa prej tyre janë fjalë që i kanë përdorë brezi i parë i muhaxhirëve (tani jo të përdorshme) dhe fjalë të tjera nga muhaxhirët e sotshëm. Pra, do të kemi parasysh edhe aspektin diakronik. Përveç leksikut, me shembuj koinkretë, do të sjellim edhe fjali të ligjërimimit të tyre të përditshëm. Do të përpiqem që ta paaqyroj terminologjinë bujqësore, blegtorale, ekonomike dhe fusha të tjera jetësore.

Fjalët në glosar do të renditen sipas rendit alfabetik, duke shënuar edhe fshatin ku është mbledhur. Në të folmen e tyre ndeshen fjalë të rralla që mungojnë në të folmet e tjera të gegërishtes, ndoshta edhe në mbarë shqipen si gjuhë e folur dhe e shkruar.

Kjo temë ka një rëndësi të madhe për dialektologjinë, por edhe për sociolinguistikën, sepse për herë të parë do të sillen dukuri të reja gjuhësore për të folmen në fjalë.

Fjalët kyçe: shpërngulja e muhaxhirëve, fjalori dialektor, fjali dialektore, terminologjia, rendi alfabetik.

Shemsi Haziri

Zhvillimi i leksikut policor në gjuhën shqipe në Kosovë

Në këtë punim do t'i paraqes disa faza periodike të zhvillimit të leksikut policor në gjuhën shqipe në Kosovë, të cilat, përveç mënyrës së fjalëformimit (ndajshitesimi, kompozitat etj.), kanë qenë të ndikuara drejtpërdrejt nga serbokroatishtja, periudha 1970-1999, nga anglishtja 1999-2017, e me theks të veçantë kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë nga sistemi i udhëheqjes ideo-politike si në vijim.

- Periudha 1970 – 1990 gjatë kohës së udhëheqjes komuniste jugosllave në territorin e Kosovës, në të cilën veçojmë fjalët e fushës policore, si: *milicia, milicioner, organi i punëve të brendshme, Sekretariati Krahinor i Punëve të Brendshme, Drejtorati i Sigurimit Publik, Posta e Milicisë etj.*

- Periudha 1999-2008 gjatë kohës së administrimit të UNMIK-ut, në të cilën veçojmë fjalët e fushës policore, si: *Shërbimi Policor i Kosovës, pjesëtar i SHPK-së, komandant regional i SHPK-së, komesari i Policisë së UNMIK-ut, Stacioni i Shërbimit Policor* etj.
- Periudha 2008-2017 e administruar nga udhëheqësit politikë vendorë të Republikës së Kosovës, që nga shpallja e Pavarësisë më 17 Shkurt 2008, në të cilën veçojmë fjalët e fushës policore: *Policia e Kosovës, zyrtar policor, drejtor rajonal i Policisë, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Stacion Policor, Departamenti i Hetimeve, Divizioni i Sigurisë Publike* etj.

Në përfundim të këtij hulumtimi do të nxirren rezultatet e arritura në fushën e leksikut policor të gjuhës shqipe, në të cilin do të jepen edhe rekomandimet e nevojshme lidhur me harmonizimin e leksikut të kësaj fushe sipas parametrave të duhur të zhvillimit gjuhësor.

Fjalët kyçe: *leksiku policor, periudhat e zhvillimit, ndikimi ideo-politik, fjalëformimi, ndikimi i serbishtes dhe anglishtes.*

Rinor Matoshi

Arbënishtja në studimet e Idriz Ajetit

Ndër kontributet e çmueshme shkencore të akademik Idriz Ajetit nga sfera e gjuhësisë bëjnë pjesë edhe studimet dialektologjike. Pa dyshim disertacioni i tij “Zhvillimi historik i së folmes gege të arbënesheve të Zarës” përbën kontributin e tij më madhor në këtë drejtim. Përpjekjet e shkencëtarëve Mikloshiq, Berqiq, Erber, Waigand, Talavini etj., i kurorëzoi me një sintezë shteruese pikërisht Idriz Ajeti. Ky studim nxjerr në pah prejardhjen e këtij varianti të shqipes (Shestani, Brisku – Kraja, Mali i Zi i sotëm), i cili në kontakt me gjuhët sllave e atë italiane manifestoi veçanti karakterizuese në raport me të folmet tjera gege. Këndvështrimet e Ajetit fillimisht përfshijnë aspekte fonetike, për t’u përqendruar te dimensionin morfologjik (emri dhe folja) i shqyrtimit të këtyre veçantive. Përgjithësisht kontributi studimor i Idriz Ajetit për të folmen e arbënesheve të Zarës është përmbledhur në 180 njësi studimore. Gjithashtu një vlerë të veçantë e përbëjnë edhe tekstet e transkriptuara të kësaj të folmeje, të përfshira në trajtë shtojce, nëpërmjet të cilave dëshmohet formati gjuhësor i saj.

Ky punim i Idriz Ajetit është i një rëndësie të veçantë, qoftë si analizë fonetike e morfologjike, qoftë si sintezë e vënies në pah të karakteristikave të përgjithshme të kësaj të folmeje. Përtej kësaj, autori ka ofruar edhe modelin e qasjeve dialektologjike, i cili për shumë kohë do të jetë një model funksional në studimet mbi të folmet e ndryshme të gegërishtes.

Lindita Dinosa

Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në Mal të Zi

Lajmi për zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Mal të Zi u publikua pothuajse në të gjitha mediet shqiptare. Sigurisht, ky lajm ishte vendim i shumëpritur që e gëzoi çdo shqiptar, por sidomos ata që kanë punuar aq sa kanë mundur dhe vazhdojnë të punojnë për të kontribuar në këtë drejtim. Ligji i ri ,në fakt, nuk përfshin zyrtarizimin e gjuhës shqipe në të gjithë Malin e Zi (siç mund të kuptohet ndonjëherë nga titujt e medieve), por vetëm në komunat ku popullsia shqiptare përbën më shumë se 5 % të popullsisë. E meqë Ulqini, Plava dhe Tuzi e “gëzonin” edhe deri tani këtë të drejtë, me këtë vendim u shtuan edhe tri komuna tjera ku shqiptarët e kalojnë 5 %-shin, e ato janë Podgorica, Tivari dhe Rozhaja.

Në një kohë kur edhe vetë malazezët po luftojnë për rikthimin dhe standardizimin e gjuhës së tyre, shiptarëve po ju jepet një hapësirë e re për të korrigjuar boshllëqet dhe gabimet e së kaluarës. Megjithatë, shumëçka mbetet edhe në dorën tonë, sepse përveç se ta kemi zyrtare si gjuhë ne duhet ta njohim dhe ta përdorim atë pa kompleks, e të mos ngurrojmë t'i kërkojmë të drejtat që na takojnë me ligj për zbatimin e saj, sepse zbatimi është ai që e bën realizimin e plotë të zyrtarizimit.

Në këtë punim do të mundohem të paraqes në mënyrë kronologjike zhvillimin e gjuhës shqipe në disa nga komunat ku ka shqiptarë si dhe institucionet dhe autorët që kanë ndikuar në ruajtjen dhe zbatimin e saj.

Do të njoftohemi me këto të dhëna edhe përmes zyrtarëve të lartë shqiptarë që punojnë në institucionet e Malit të Zi të cilat ndihmuan në këtë drejtim, siç janë: Ministria e Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut, Ministria e Arsimit dhe Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi.

Manjola Lubishtani

Realizimi i funksioneve jashtëkundrinore të varianteve të lidhura sipas këndvështrimit të Besim Bokshit

Qëllimi kryesor i këtij punimi është shpalosja e pikëpamjeve dhe e arritjeve konceptuale të Besim Bokshit në argumentimin e aftësisë funksionale të formave të dhanores për të realizuar funksione jashtë sferës kundrinore, përkundër funksionit të kundrinës së zhdrejtë që tradicionalisht u atribuohet varianteve përemërore të rasës dhanore.

Po ashtu, një hapësirë e nevojshme i kushtohet edhe përdorimit të varianteve të patheksuara të kallëzores brenda një grupi shprehjesh

idiomatike, krahas formave të dhanores, përdorim i cili kushtëzohet nga tiparet përkatëse të foljes.

Të gjitha këto do të analizohen sipas këndvështrimit të vetë autorit, i cili, duke analizuar në mënyrë sistematike pikëpamjet e studiuesve të ndryshëm me të cilët nuk pajtohet, i ndërton raportet funksionale të formave të patheksuara përemërore duke i parë të kushtëzuara nga tiparet kontekstuale gjatë relacioneve sintagmatike folje - forma të dhanores, gjë që i mundëson të gjenerojë bindshëm konkluzionet e tij.

Fjalët kyçe: variante të lidhura, dhanore, kallëzore, tipare kontekstuale të foljeve, funksione jashtëkundrinore.

Diellza Hoxha

Struktura e rrokjes në gjuhën shqipe

Në gjuhën shqipe rrokja cilësohet si një ndër njësitë gjuhësore më të pastudiuara, ajo është trajtuar përciptazi në aspektin teorik nga studiues shqiptarë, por një studim i mirëfilltë dhe serioz rreth hulumtimit të saj mungonte prej kohësh.

Rrokjen, prerjen e saj dhe ndarjen e fjalëve në rrokje do t'i analizojmë me anë të matjeve akustike, konkretisht me anë të Praat-it, duke i vënë në pah tiparet karakteristike të tyre.

Korpusin e fjalëve për analizë e kemi përzgjedhur nga shembuj të paraqitur nga Dodi, për të vërtetuar me matje të fonetikës eksperimentale, nëse ndarja tradicionale e rrokjeve në shqipe, e bazuar në radhë të parë në teorinë e sonoritetit, njëkohësisht e përqafuar nga Dodi, është e qëndrueshme apo e diskutueshme. Shembujt e korpusit vënë në pah se struktura e rrokjes në shqipe del më ndryshe krahasuar me studime tradicionale.

Punimi ynë përqëndrohet në trajtimin e qëndrueshmërisë ose zhbërjes së grupeve konsonantike, të cilat në trupin e tyre kanë një sonant. Me të drejtë mund të themi se studiuesja polake Irena Sawicka në punimin e saj "*Struktura e rrokjes së shqipes Kosovare*" heton problemin e ndarjes së grupeve konsonantike, e së këndejmi matjet tona mbështesin teorinë e saj. Përderisa Sawicka kishte objekt trajtimi strukturën e rrokjes kosovare, punimi ynë është i fokusuar në shqipen standarde.

Rezultatet e matjeve tona na shpiejnë në përfundim se, struktura rrokjesore e shqipes standarde ndryshon nga përshkrimet e deritanishme.

Fjalët kryesore: rrokja, parametra akustikë, grupe konsonantike, prerja rrokjesore, programi Praat.

Hana Radoniqi

Studimi i theksit të shqipes në fonologjinë metrike dhe në Teorinë e Optimalitetit

Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë shpjegime për theksin e shqipes. Ajo që e karakterizon këtë është palëvizshmëria gjatë eptimit: cilado rrokje pasuese e temës është e parëndësishme për pozitën e theksit (Lowman 1932, Bevington 1974, Canalis 2007).

Meqë mund të bjerë në rrokje të ndryshme, gjuhëtarët shqiptarë kanë arsyetuar se vendi i theksit në fjalët e shqipes nuk mund të paraqitet me një rregull të përgjithshme, duke lënë të kuptohet se rëndom, në të shquarën tek emrat, theksi bie në rrokjen parafundore: prandaj, edhe në huazimet nga gjuhë të ndryshme ky rregullohet sipas kësaj prirjeje (Dodi 1970, 2004). Përveç kësaj, edhe se lëvizja e theksit mund të paraqitet sipas rregullimit mekanik (Topalli 1995).

Punimi do të marrë parasysh zbatimin e teorive që shkojnë përtej tradicionales, për t'u afuar me teoritë e fonologjisë gjenerative. Si trajtim i parë do të merret theksi në përfaqësimet e rregullave (Bevington 1974), në kuadrin e fonologjisë metrike dhe si pjesë e Teorisë së Optimalitetit (Maynard 1997, Trommer & Grimm 2004, Canalis 2007, Bozhoviq 2012, Bermúdez-Otero 2007, 2011, Rugova 2006, 2016). Qasja e këtyre autorëve se si e kanë përfaqësuar studimin e theksit në përgjithësi dhe, studimin në shqipen në veçanti, i ka tejkaluar paraqitjet e vendosjes së tij në rrafshin e fjalës ose të rrokjes, duke u orientuar tashmë në traditën gjenerative – me sqarimin e marrëdhënies ndërmjet theksit dhe peshës së rrokjes që studiohen nga teoria metrike e fonologjisë dhe me analizën e theksit përmes kufizimeve të Teorisë së Optimalitetit.

Fjalët kyçe: theks, rrokje, morë, fonologji metrike, Teori e Optimalitetit.

Dritë Bardhaj- Krasniqi

Ndikimi i faktorëve sociolinguistikë në vlerat akustike të zanores /a/ në shqipe

Zanorja /a/ është njëra ndër shtatë zanoret e gjuhës shqipe. Deri me tani kjo zanore është studiuar nga disa gjuhëtarë, kryesisht në kuadër të studimit të sistemit të tingujve dhe në aspektin gjuhësor. Ata i studiuuan veçoritë nyjtimore, akustike dhe ato funksionale. Në këto studimeve u trajtua vetëm ndikimi i faktorëve gjuhësorë, pikërisht, në veçoritë akustike të kësaj zanoreje duke lënë anash edhe faktorët e tjerë, siç janë ata socialë.

Prandaj, vendosa të realizoj një studim sociolingistik për zanoren /a/, konkretisht për mënyrën e ndikimit të faktorëve socialë në vlerat akustike të saj.

Sigurimi i materialit akustik do të realizohet përmes fonetikës eksperimentale, ndërsa numri i informatorëve duhet përcaktuar duke e respektuar kriterin tredimensional të Sociolinguistikës. Mbështetur në këtë kriter duhet incizuar 20 persona me kryqëzim të moshës, gjinisë dhe shkallës së shkollimit. Po ashtu, edhe korpusi i fjalëve duhet të përcaktohet sipas pozicionit të kësaj foneme brenda fjaleve për të gjithë informatorët.

Pastaj materiali i siguruar hapet në dritaren e programit Praat, përmes së cilit gjenden vlerat e sakta numerike të gjatësisë, dy formanteve të lartësisë apo tonalitetit (F1 dhe F2), dhe ato të intensitetit fizik të fonemës /i/.

Pas kompletimit të vlerave do të merremi me studimin dhe analizimin e këtyre të dhënave nën këndvështrimin sociolinguistik të ndikimit të moshës, të gjinisë dhe të shkallës së shkollimit. Do të konstatohen divergjencat dhe konvergjenat për të tri grupet e informatorëve dhe do të tentohet të gjenden tendencat e ndryshimit të këtyre vlerave të vetive akustike të zanores /a/ në të ardhmen.

Fjalët kyçe: /a/, faktorë sociolinguistikë, vlerë e gjatësisë, vlera të tonalitetit (F1 dhe F2), vlerë e intensitetit.

Elona Gjata

Zanorja *ə* në tekstet e At Skiroit dhe tradita shkrimore e saj

Në interpretimin gjuhësor dhe filologjik që iu është bërë teksteve të at Skiroit ato na dalin si dokumenti më i herëshëm zyrtar i asaj kohe në të cilin shqipja përdorej si mjet komunikimi ndërinstitucional, por edhe në instanca më të larta, si Kuria e shenjtë, etj.

Ajo çka bie në sy te këto tekste është ruajtja e traditës shkrimore në këtë periudhë, që daton e shek. XVIII, dhe sidomos në Horën Arbëreshe. Ky studim do të sjellë një krahasim në ruajtjen dhe shkrimin e *ə*-së të ky autor krahasuar me Matrëngën, i cili është po i Horës Arbëreshe, por që i përket shek. të XVI.

Një syth tjetër me interes studimi do të ishte dhe krahasimi mes këtij prifti katolik dhe Gjon Nikollë Kazazit, që i përket po këtij shekulli, por një koineje tjetër, asaj të veriut. Ky studim rreket të shpreh konservimin e zanores *ə* në vijën e traditës dhe ngjashmëritë e thekshme të dy dialektve të shqipes.

Hatixhe Hoxha

Pikëpamjet e Eqrem Çabejt për prejardhjen e gjuhës shqipe

Që nga shekulli i XIX, çështjet si ajo e prejardhjes së gjuhës shqipe kishte ndarë studiuesit në dy taborre të mëdha, që mbështesnin dy teza të ndryshme e që i kunderviheshin njëra tjetrës.

E. Çabej, njëri ndër studiuesit më të thelluar të gjuhës shqipe, padyshim se në qendër të interesimit të tij shkencor do të kishte dhe pati, çështje të rëndësishme të veçantë të historisë dhe të parahistorisë së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar.

Çështjet si prejardhja e gjuhës shqipe, vendi që ajo zë në mesin e gjuhëve indoevropiane, marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera, vazhdimisht e cytën dhe ishin objekt interesimi e preokupimi për te gjatë gjithë jetës së tij.

Prof. Çabej ka shqyrtuar me shumë kujdes pikëpamjet e studiuesve të huaj, dhe ka mbajtur qëndrim kritik e të drejtë ndaj mendimeve që nuk ishin të argumentuara mjaftueshëm, si dhe ndaj atyre që kishin mendime të kundërta dhe përherë ka sjellë argument të reja e me rëndësi në të mirë të ndriqimit të këtyre çështjeve, dhe në mbështetje të prejardhjes ilire të gjuhës shqipe.

Në të mirë të vazhdimësisë iliro-shqiptare, Prof. Çabej thotë flasin: argumentet historike, arkeologjike, etnografike, etj., por edhe ato gjuhësore, si: prania e huazimeve të lashta greke, latine, sllave, etj., të dhënat nga toponomastika si vazhdimësia e emra të lashtë të vendeve, nga antika e këndeje, përdorimi pa ndërprerë në gojën e shqipfolësve i këtyre emrave. Shpjegimi i disa nga emërvendet dhe emrat e njerëzve me fjalë shqipe etj.

Fjalë kyçe: gjuha shqipe, ilirishtja, teoria ilire, huazimet

Karmen Lazri

Ndihmesë e gjuhëtarit Xhevat Lloshi për fjalëformimin në terminologji

Në këtë kumtesë, jam mbështetur në veprën e njohur leksikografike “Fjalor me emërtime të bimëve dhe të kafshëve latinisht-shqip dhe shqip-latinisht” të prof. Xhevat Lloshit, botuar nga LOGOS-A, Shkup-Prishtinë, 2010, për të nxjerrë në pah fjalëformimet në termat njëfjalëshe, si dhe emërtimet me përbërës sintagmatikë të botës bimore dhe shtazore në këtë fjalor. Objekt të punës time, kam bërë analizën e ndajshesave në formimet e shumta të emërtimeve të gjallesave në hapësirën shqiptare, por edhe më gjerë, prirjen që ka sot shqipja për t’i ndërkombëtarizuar termat në kohë të globalizmit gjuhësor, përfshirë edhe trevat ku banojnë shqiptarë jashtë kufijve politikë të vendit. Puna ime, këtu, mbështetet në disa shkronja të Fjalorit.

Jeton Raja

Përmrat e pacaktuar në veprën “Meshari” të Gjon Buzukut

Në këtë kumtesë trajtohen çështje lidhur me përmrat e pacaktuar në veprën e parë të gjuhës shqipe, të cilët paraqesin një hiperdiversitet morfologjik, duke dalë në forma arkaike, të rralla e me një larmi ndërtimesh. Fillimisht janë nxjerrë të gjitha format pronominale nga origjinali i transkriptuar i veprës “Meshari”, më tej janë bërë klasifikime të tyre sipas kuptimit individual, sipas mënyrës së formimit dhe sipas veçorive morfologjike. Sipas kuptimit individual janë dalluar:

1. *përmra të pacaktuar që tregojnë qenie frymore dhe sende materiale në mënyrë të pacaktuar;* 2. *përmra të pacaktuar që tregojnë sasi të pacaktuara.* Sipas mënyrës së formimit janë dalluar: 1. *përmra të pacaktuar të pamë (të thjeshtë);* 2. *përmra të pacaktuar me konversion;* 3. *përmra të pacaktuar me përngjitje (aglutinin).* Sipas veçorive morfologjike janë dalluar: 1. *përmra të pacaktuar të paranyjzuar e të ngjashëm me mbiemrat;* 2. *përmra të pacaktuar të shquar e të ngjashëm me emrat;* 3. *përmra të pacaktuar me elementet paraprijëse të lakueshme kush e silli;* 4. *përmra të pacaktuar të palakueshëm (të ngurosor).*

Më tej janë dhënë shpjegime morfologjike diakronike të përmrave të pacaktuar të pamë *gjithë* e *tjetër*, duke i shoqëruar me hipoteza gjuhëtarësh të ndryshëm rreth burimit të tyre dhe duke shpjeguar në veçanti mënyrën e paranyjzimit e të marrjes së fundoreve tematike në numrin shumës të të pacaktuarit *tjetër*. Më tej janë përmendur përmra të pacaktuar që nuk dalin fare në format me të cilat rezultojnë në shqipen e sotme standarde, duke paraqitur edhe format karakteristike arkaike që i zëvendësonin kuptimisht, si edhe janë përmendur format e larmishme rasore e semantike të përmrit të pacaktuar me konversion *kush*. Në fund janë paraqitur konkretisht nëpër tabela të gjitha format pronominale të pacaktuara, të përcjella nga ilustrime me shembuj fjalish të përdorimit të tyre.

Rezarta Gjergji

Nevoja e mësuesve për zhvillim profesional për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies

Mësuesit kanë përgjegjësi domethënëse në përgatitjen e brezave të rinj. Detyrë parësore dhe më e rëndësishme e arsimit fillor apo arsimit të mesëm të ulët është edukimi i nxënësve dhe aftësimi i tyre për të qenë në gjendje të ballafaqohen me sukses me sfidat e shekullit XXI. Mësuesit efektiv janë ata, të cilët janë një burim frymëzimi për nxënësit dhe kjo për

faktin se mësuesi është faktori më i rëndësishëm influencues brenda shkollës për nxënësin. Ndaj, zhvillimi profesional i mësuesit dhe formimi i tij gjatë bankave të shkollave është shumë i rëndësishëm, por nuk mund të presim që ata të jenë të përgatitur për gjithçka që mund të hasin gjatë karrierës së tyre. Sistemet arsimore synojnë që t'u sigurojnë mësuesve mundësi për zhvillimin e tyre profesional në mënyrë që të sigurojnë standarte të larta të mësimdhënies dhe një cilësi të lartë të punës së tyre në mësimdhënie.

Punimi synon që të paraqesë rëndësinë e zhvillimeve profesionale të mësuesve dhe ndikimin e tyre jo vetëm në procesin e mësimdhënies, por edhe në përmirësimin e kurrikulave, në zhvillimin profesional të mësuesve dhe azhurnimin e aftësive të tyre. Për matjen e punimit është zhvilluar pyetësori sasior, me shkallën e matjes Likert me pikëzim 1 deri në 5 i plotësuar nga mësuesit (N=100). Pyetësori është i ndarë në dy variabla: pjesëmarrja në trajnime dhe ndikimi në mësimdhënie. Në këtë studim u ftuan të merrnin pjesë 100 mësues të qytetit të Durrësit të përzgjedhur sipas mënyrës rastësore. Studimi arriti në rezultatin se zhvillimi profesional i mësuesit ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe në procesin e të nxënësve. Studimi gjithashtu rekomandon të gjithë mësuesit që të jenë pjesëmarrës aktiv në zhvillime të ndryshme profesionale dhe konferenca.

Tiziana Leka

Integrimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor në shkollat shqiptare

Vitet e fundit, vëmendje e veçantë i është kushtuar si teknologjisë, ashtu edhe integrimit të saj gjatë procesit mësimor, në shkollat shqiptare. Nisma të ndryshme si, pajisja e klasave me kompjutera, projektorë dhe tableta ka qenë në fokus të shkollave shtetërore shqiptare, edhe pse vështirësia e integrimit të tyre has me pengesa të mëdha duke filluar me ambientet fizike shkollore, mirëmbajtja e tyre dhe trajnimet e vazhdueshme të mësuesve sesi t'i përdorin dhe t'i integrojnë këto pajisje në procesin mësimor. Identifikimi i vlerave të pajisjeve teknologjike në shkolla, prej 20 vitesh tashmë ka sfiduar kërsuesit shkencor në fushën e arsimit.

Ky punim do të fokusohet te integrimi i teknologjisë gjatë procesit mësimor në shkollat shqiptare, mund të themi se teknologjia është pjesë shumë e rëndësishme gjatë mësimdhënies së gjuhëve të huaja, por jo vetëm. Për matjen e këtij studimi janë përdorur tre variabla, ajo e integrimit të teknologjisë, variabla e procesit mësimor dhe variabla e përmirësimit të mësimdhënies dhe motivimit të nxënësve kur teknologjia integrohet në orën mësimore. Instrumentat matës janë dy pyetësorë të shkallëzuar, me shkallën Likert dhe ku kanë marrë pjesë N=300 (përfshirë 100 mësues dhe 200

nxënës nga shkollat të përzgjedhura rastësisht në qytete të ndryshme nga Shqipëria). Të dhënat e përmbledhura janë përpunuar me Spss nga ku janë paraqitur edhe matjet e variablave, mean-i dhe SD.

Punimi arriti në konkluzionin, se në gjithë Shqipërinë integrimi i teknologjisë has vështirësi teknike dhe financiare, pasi nëse do flasim për integrim teknologjie, duhet të pari që shkolla të plotësojë të gjitha kushtet minimale të ambjenteve fizike (shkolla në fshatra apo rajone të largëta). Punimi konkludon te nxënësit janë më të motivuar për të mësuar në klasat ku integrohet teknologjia dhe gjithashtu punimi rekomandon trajnime të vazhdueshme të mësuesve për përdorimin e pajisjeve teknologjike.

Nertila Zani

Retorika dhe argumentimi, përqasja dhe ndarja midis tyre

Në këtë punim do të trajtojmë argumentimin gjuhësor dhe argumentimin retorik, dy qasje që kryqëzohen me njëra – tjetrën. Synimi kryesor është të paraqesim një përqasje teorike rreth këtyre dy koncepteve, duke i'u referuar gjithë autorëve që kanë hedhur themelet bazë mbi këto teori.

Në fakt, gjithmonë janë quajtur si dy fusha studimi të ndryshme. Në historinë e retorikës shohim qartë një ndarje midis artit të të arsyetuarit dhe bindjes kundrejt artit e të folurit bukur.

Në këtë punim nuk do të pasqyrojmë vetëm teoritë dhe konceptet, por do të paraqesim një studim të thukët, duke dhënë edhe mendimin tone rreth tyre.

Të studiosh tekstin argumentues, logjikisht studimin do e nisësh qysh me Aristotelin dhe, më pas, me Retorikën e Re, duke kaluar në gjuhësinë e sotme.

Përveç përqasjes që i bëhet këtyre dy koncepteve, ka edhe rrahje mendimesh midis autorëve dhe gjuhëtarëve që kanë dhënë kontributin e tyre, jo vetem në çështjet teorike, por duke i parë edhe në diskurse të ndryshme.

Sot, në disa vende të botës, si në shkollat anglo – sanksone, Kanada dhe Amerikë, Argumentimi retorik jepet si një disiplinë më vete në shkencat e gjuhësisë.

Nuk do të lemë mënjandë as autorët shqiptarë që kanë studiuar tekstin argumentues dhe përfitimin e tij në gjuhën shqipe.

Froseda Angjellari Tola

Ndihma e toponimisë në identifikimin e vendbanimeve të fortifikuara në prehistori. Disa shembuj nga zona e Shqipërisë Juglindore

Toponimet konsiderohen nga historianët dhe arkeologët elemente mjaft me vlerë të njohjes së të shkuarës historike. Ato janë jo vetëm elementi kryesor identifikues i një vendi apo krahine të caktuar por janë njëkohësisht edhe një pasqyrë e parë e prezantimit të historikut të tyre. Edhe krahina e Shqipërisë juglindore nuk bën përjashtim nga ky përcaktim. Ajo është e mbushur me emra vendesh që lidhen qoftë me elementet e natyrës, qoftë me ngjarje historike apo praninë e gjurmëve të lashta të jetës njerëzore. Për shkak të ndikimit të kulturave të ndryshme të pranishme në këtë krahinë përgjatë shekujve, gjuha e folur dhe toponimet në shumë raste kanë origjinë të huaj. Megjithatë, në po kaq shumë raste, historia e këtyre vendeve është shumë më e lashtë se periudha kur vendi ka marrë emërtimin e huaj.

Synimi i këtij prezantimi është të prekë vetëm ato toponime që janë dëshmi e pranisë së një fortifikimi të hershëm në vendin të cilin ato kanë emërtuar, prandaj këtu do të trajtohen vetëm toponimet historike të Shqipërisë juglindore, të cilat na japin dëshmi për praninë e një vendbanimi të fortifikuar apo elementit tjetër të pranisë së njerzve që në etapat më të hershme të historisë.

Pranvera Osmani

Fjalitë kallëzuese në gjuhën shqipe

Në këtë punim mëtojmë të trajtojmë fjalitë kallëzuese në gjuhën shqipe. Një çështje të diskutueshme në studimet sintaksore të shqipes përbën ky lloj i fjalive.

Fjalitë kallëzuese nuk janë trajtuar në të gjitha gramatikat e shqipes. Kjo është për shkak se në shumicën e gramatikave strukturimi i fjalive të përbëra me nënrenditje është realizuar nëpërmjet shpjegimeve vetëm për fjalitë e varura kryefjalore, kundrinore, përcaktore dhe rrethanore.

Do të trajtojmë disa konceptime e këndvështrime në sintaksat e shqipes duke filluar nga ajo me e hershmja e gjer më sot. Po ashtu do të merremi edhe çështjen e klasifikimit të fjalive të varura përkatësisht fjalitë që ne i kemi objekt studimi.

Në trajtimin e lëndës synohen të shpjegohen strukturat sintaksore të fjalive të varura, të përshkruhen në mënyrë sa më të plotë funksionet sintaksore dhe të vihen në dukje mjetet e shprehjes së këtyre funksioneve.

Këndvështrimi ynë metodologjik është kryesisht përshkruar dhe analizues.

Hipoteza jonë kryesore në trajtimin e fjalive kallëzuesore është se a përbëjnë një grup të veçantë të fjalive të përbëra me nënrenditje me tipare të veçanta në pikëpamje strukturore dhe semantike.

Fjalët çelës: fjalë kallëzuesore, gramatikat e shqipes, struktura sintaksore

Albulena Alidema

Gjuha standarde në kinematografinë e Kosovës

Gjuha është mjet komunikimi. Si e shkruar dhe si e folur ajo gjen përdorim të gjerë në mediumet e shumëllojta duke përfshirë edhe filmin. Një realizim kinematografik ndërtohet mbi bazamentin e dialogut, pra bashkëbisedimit të personazheve në film. Ky punim ka për qëllim që të analizojë përdorimin e gjuhës standarde në kinematografinë kosovare në dy periudha kryesore: 1980-1990 si dhe periudhën e pasluftës: 1999-2017. Në fokus të këtij punimi do të jenë shumica e atyre filmave që kanë bërë një jetë të suksesshme prezentimi kombëtar e ndërkombëtar në mesin e të cilëve: “Gjurmë të bardha” (1980), “Kur pranvera vonohet” (1980), “Era dhe Lisi” (1984), “Proka” (1984), “Kukumi” (2005), “Anatema” (2006), “Gomarët e kufirit”, (2009), “Heroi” (2014), “Tri dritare dhe një varje”, (2014) etj. Meqë gjuha në film, në këtë rast dialogu, njëlloj si në teatër, por edhe në letërsi, është gjuhë e personazhit, ky punim do të analizojë përdorimin e gjuhës, si në aspektin sintaksor, morfologjik ashtu edhe në atë fonetike. Rastet e marra dhe të trajtuara në këtë punim, do të jenë të mjaftueshme për të na ilustruar fakte e të dhëna se si është përdorur gjuha standarde në kinematografinë kosovare që nga viti 1980 e deri më sot.

Fjalë kyçe: variante, gjuhësore, kinematografi, film.

Jahja Hondozi

Vështrim sociolinguistik rreth së folmes së Rahovecit

Pohimi se “*njeriu banon në gjuhën e tij më shumë se sa që banon në vendin e tij*” mendojmë se do t’i shkonte për shtati më së tepërmi të folmes së Rahovecit.

Kjo, për faktin se krahas gjuhës shqipe, në Rahovec flitet prej kohësh edhe një e folme e veçantë, karakteristike, interesante dhe ‘e çuditshme’.

Për t’iu qasar shkencërisht kësaj të folme, lipset një studim i mirëfilltë objektiv në rrafshin historik-gjeografik, gjuhësor, social, psikologjik, sociolinguistik, e deri te ai politik.

Megjithë disa përpjekeve të vogla që janë bërë në ndriçimin e kësaj të folme, edhe sot e kësaj dite kjo e folme është ende e pandriçuar sa duhet, e panjohur dhe shumë shpeshnjë temë tabu, për të cilën njerëzit nuk dëshirojnë të flasin e të diskutojnë.

Sot ka ende njerëz të cilët nuk e dinë se në këtë qytezë e cila shtrihet në jug të Kosovës flitet prej kohësh një e folme 'e përzier', ku mbizotëron bullgarishtja, prandaj edhe rahovecasit me përçmim quhen 'bugarë të Rahovecit'.[†]

Kur flitet për këtë të folme, për të cilat njerëzit kanë krijuar paragjykime nga më të ndryshmet, nga teori të llojlojta rreth historikut të saj e deri te anekdotat, duhet të flitet në mënyrë objektive, me një qasje serioze dhe paanshëm.

Nuk pretendoj se do t'i jap vullë kësaj teme, e as që kam plotësisht të drejtë lidhur me këtë fenomen gjuhësor, por nisur nga materiali i vjelur në terren do të përpiqem të ofroj një përgjigje modeste lidhur me atë se çfarë është kjo e folme. Çfarë strukture ka? Cilat janë karakteristikat e kësaj të folme? Çfarë është leksiku i saj?

Fillimisht, lidhur me historikun e së folmes së Rahovecit janë dhënë disa hipoteza, por që deri më tani nuk janë mbështetur shkencërisht në mungesë të fakteve të shkruara. Po cilët janë faktorët dhe rrethanat e shfaqjes së fenomenit?

Ky punim është rezultat i punës disavjeçare në terren. Gjatë kësaj periudhe i kam vjelë fjalët dhe shprehjet që i kam dëgjuar drejtpërdrejt nga folësit e këtij lokaliteti dhe i kam regjistruar ashtu si i kam dëgjuar prej tyre.

Vjosa Osmani

Etiketa seksiste ndaj femrave-mjete gjuhësore për shprehjen e tyre

Në këtë punim, jo vetëm që do të vëmë në pah etiketa seksiste ndaj femrave, por, do të mundohemi të analizojmë kuptimin, bazën si dhe ndikimin që kanë ato në imazhin e femrave, e së këndejmi edhe në pozitën e tyre në shoqëri. Në këtë rrafsh do të trajtohen edhe probleme të tjera shoqërore që mund të lindin për shkak të tyre, si: çështje të paragjykimeve, të stereotipave, të stigmatizimit etj.

* Shih: Dr. Hilmi Agani, *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit në dritën e shqipes së Rahovecit e të Gjakovës*, Rilindja, Prishtinë, 1981.

[†]Rahoveci është i njohur për mbiemra karakteristikë që rrallë gjenden në pjesë të tjera të Kosovës. Ndër ta, i përhapur është edhe mbiemri *Bugari*.

Shembujt që do të përdoren, për të testuar etiketat e tilla, do të jenë nga më të ndryshmet dhe do të merren në gazetën: Express dhe IndexOnline, kryesisht në rubrikat e show-bizit, por jo vetëm. Gjatë hulumtimit do të mundohemi t'u përgjigjemi disa pyetjeve:

1. *Çfarë pozicionesh zënë femrat në rubrika të ndryshme?*
2. *Si portretizohen ato?*
3. *Çfarë etiketash përdoren për to?*
4. *A ndikojnë etiketat e tilla në imazhin, e së këndejmi edhe në pozitën e tyre në shoqëri?*

Metoda bazë e hulumtimit do të jetë ajo e analizës konkrete mbi vëzhgimin e drejtpërdrejtë, duke nxjerrë materialet nga korpusi dhe duke i sistemuar ato më tutje për trajtim. Sigurisht, natyra e objektit të studimit kërkon edhe përdorimin e metodave të tjera, siç janë: metoda deskriptive, e klasifikimit, e krahasimit, statistikore etj.

Qëndresa Jakupi

Bashkërenditja e njërive më të vogla se fraza

Pasi është provuar se gramatika e shqipes mund të përshkruhet në aspektin e strukturës së sintagmës, ne synojmë ta trajtojmë lidhjen e përbërësve sintaksorë (sintagmave) në rrafshin e parataksës të skenari filmik *Zoti i unazave*. Dihet se njësitë sintaksore brenda një fraze mund të lidhen me njëra-tjetrën në njërin nga dy mënyrat: sintagmatike ose josintagmatike. Marrëdhëniet sintagmatike përbëjnë lidhjet e dy ose më shumë elementeve për të formuar një ndërtim të vetëm gramatikor. Këto marrëdhënie sintagmatike përfshijnë dy lloje të lidhjeve: parataksën dhe hipotaksën. Me parataksë nënkuptohet kur çdo element ka status të barabartë në frazë dhe asnjë element nuk varet nga elementi tjetër (Peterson 1998). Pra, parataksa është ajo marrëdhënie sintagmatike që e përfshin llojin e bashkërenditjes. Koordinimi (bashkërenditja) në krahasim me subordinimin (nënrenditjen), mund t'i lidhë përbërësit më të vegjël se fraza, siç janë sintagmat dhe fjalët. Ndërsa nënrenditja nuk krijon lidhje ndërmjet dy gjymtyrëve më të vogla se fraza. Në këtë punim përmes analizës në përbërës të drejtpërdrejtë, synojmë ta hulumtojmë bashkërenditjen e njërive më të vogla se fraza, pra bashkërenditjen e sintagmave, mënyrën dhe llojin e bashkërenditjes, kufizimet që shfaqen në renditjen e tyre, po ashtu raportin e përbërësve brenda sintagmave. Bashkërenditje formojnë vetëm ato sintagma që kanë të njëjtat kategori sintaksore (Dhima 2005), por sipas studimeve të Huddleston et al. (2002: 1276), mund të bashkërenditen edhe struktura të sintagmave që nuk i përkasin të njëjtës kategori gramatikore. Ky korpus (skenari filmik *Zoti i unazave*) është përzgjedhur me qëllim, pasi filmi është produkt verbal, i shkruar dhe vizual, të gjitha përfundimet mbështeten te konteksti dhe

këndvështrimi i folësit, në bazë të të cilave ai i ndërton sintagmat, pra zgjedh përbërësit.

Fjalët kyçe: koordinim, sintagmë, analiza në përbërës të drejtpërdrejtë, strukturë e koordinuar, filmi *Zoti i unazave*.

Adelajda Baftiu

Sintagmat parafrallore në funksion të rrethanorit të vendit

Sintagma parafrallore në funksion të rrethanorit të vendit, në përgjithësi, del me një strukturë të njëjtë, me parafralën si kokë të sintagmës parafrallore dhe me sintagmën nominale si komplement të saj. Komplement tipik i sintagmës parafrallore është sintagma emërore dhe rendi tipik i saj është parafralë + komplement. Ky studim i përket fushës së sintaksës dhe është nisur duke u mbështetur në hipotezën se te tipat e ndryshëm të teksteve dallon struktura e sintagmave parafrallore që shprehin vend. Këtë hipotezë jemi munduar ta vërtetojmë me analizën e sintagmave me anë të pemës, metodës statistikore dhe asaj krahasimtare në gazetën *Koha ditore*, romanin *Pesë vakte* dhe në përkthimin e skenarit të filmit *Zoti i unazave*. Analiza e sintagmave bëhet duke u mbështetur në analizën sipas përbërësve të drejtpërdrejtë, çdo përbërës i frazës në vetvete ka përbërës më të vegjël, të cilët përimtohen deri te elementi më i imët i sintagmës. Nga të dhënat statistikore, bëhen edhe krahasimet ndërmjet teksteve, duke i nxjerrë ngjashmëritë dhe dallimet. Nga ky studim, shihet se në tekstet që kemi përzgjedhur kanë dalë sintagma parafrallore me 27 parafralë, në gazetë përdoren vetëm 5 lloje parafralësh në funksion të rrethanorit të vendit, në skenar përdoren 14, kurse në roman kemi një përdorim më të madh të parafralëve, gjithsej 21 parafralë dhe një lokucion parafralor. Pra, shohim që romani mbizotëron me shumëllojshmërinë më të madhe të parafralëve, pastaj skenari dhe gazeta.

Fjalët kyçe: sintagmë parafrallore, rrethanor i vendit, analizë në përbërës të drejtpërdrejtë, kokë, komplement

Faton Krasniqi

Leksiku i huaj në tekstet shkollorë të gjuhës shqipe dhe leximit letrar VI-IX

Gjuha shqipe po huazon shumë fjalë të huaja nga gjuhët e huaja, këto huazime vërehen qartas edhe në librat shkollorë të gjuhës shqipe dhe leximit letrar. Gjuha shqipe më së shumti huazon fjalë nga këto gjuhë, si nga: anglishtja, serbokrotishtja, turqishtja gjermanishtja, italishtja, frëngjishtja, spanjishtja, portugalishtja, etj. Normalisht që shqipja do të huazojë fjalë të

ndryshme nga këto gjuhë të ndryshme, nga fusha të ndryshme si nga: arkitektura, astronomia, bujqësia, ekonomia, teknologjia informatike, inxhinieria, mjekësia etj. Por, nëse gjuha shqipe i ka fjalët e veta atëherë nuk do të duhej që të përdorim fjalë të huaja në tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar. Në tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar ne gjejmë fjalë të huazuara gati në çdo tekst libror. Ndikimi i një gjuhë në një gjuhë tjetër mund të shprehet në leksik, në sintaksë, në fonologji dhe në morfologji. Leksiku është pjesa që e pranon dhe e përqafton shumë më lehtë se elementet e tjera gjuhësor dhe nga kjo gjë më së shumti po dëmtohet gjuha duke përdorur fjalë dhe shprehje të huaja dhe krejtësisht të panevojshme. Numri i fjalëve të huaja në këto tekste shkollore është i madh, ato janë përdorur edhe për çështje stilistike, por ky numër i madh i fjalëve të huaja duhet të shihet më me kujdes nga autorët e teksteve shkollore, sepse kështu do të rritej numri i fjalëve të huaja në tekstet shkollore. Por, gjithsesi tekstet e zgjedhura janë në pajtim me normën letrare, si edhe me kërkesat estetike e stilistike.

Fjalët kryesore:Fjalë, leksik, gjuhë, huazim, e huaj.

Zahrie Kapllanaj

Faktet dhe poezia. Arshi Pipa, Libri i burgut, Romë, 1959

Momenti i caktuar kur krijuesi përzgjedh që ngjarjet e caktuara, faktet t'i fusë në letërsi shënon përcaktimin e rëndësishëm. Zgjidhet letërsia, sepse në këtë mënyrë ato fakte shënojnë e shenjojnë më shumë se të dhënë.

Autori i vëllimit, Libri i burgut, Arshi Pipa, donte që vëllimi i tij të mos ishte vetëm një seri kronologjike faktesh të jetës së burgut. Me faktet, ai donte, siç shprehet vetë në parathënie të librit, të “jepte edhe jehonën e tyre për shpirtin”. Sepse, “fakti, materjal, abstrakt, i çveshur nga atmosfera psikike në të cilën u-jetue, a mundet me dhanë një kuadër besnik të realitetit?” shtron dilemën ai. Pastaj konstaton: “Spiritualizimi i faktit është punë e poezisë”. Kjo është arsyeja pse Arshi Pipa zgjedh që kujtimet disavjeçare nëpër burgjet e Shqipërisë t'i vargëzojë në poezi. T'i radhisë ndër strofa dhe pjesë, me një varg klasik shqip, me një metrikë të zgjedhur, me shpjegime dhe kontekstualizime konkrete-të dhëna, që ai vetë i konsideron pjesë organike të poezisë.

Nxitur nga këto dilema dhe konstatime u përzgjedh ky libër poezish për t'u trajtuar, si model i veçantë dhe shumë interesant. Tema e propozuar nga ky abstrakt, do të studiojë, pra një poezi ku e dhëna është ekskluzivisht e lidhur me poezinë në një mënyrë sintetike. Studimi i kësaj lidhjeje konsiderojmë se do të jetë i rëndësishëm në mënyrën e vet.

Gjylë Totaj

Herezia e Dervish Mallutës dhe Palimpsest për Dush Kusarin

Teki Dervishi është autor i rreth 90 veprave letrare dhe artistike, por ato që do të trajtoj ne temen e këtij punimi janë dy romanet: “Herezia e Dervish Mallutës” më 1981, dhe “Palimpsest për Dush Kusarin” më 1993. Këto dy romane të T. Dervishit na bëjnë të kuptojmë që brenda vetes kanë të veçanta idetë të ndërlidhura të ditëve të personazheve të situatave të tyre jetsore. Ku mbi tekstin burimor të librit të imagjinuar të autorit martiri Kadri Kusarit, të cilin e presupozon palimpsesti i autorit, sa është biografi dhe sa panegjiri na del figura e heroit të romanit të T. Dervishit, në nj

Këto romane dallojnë dukshëm nga romanet e tjerë që në leximin e faqeve të para dhe kjo shifet duke u nisur nga gjuha e autorit, këtu autori na flet me një “kosovarizim”, flet për fatin e personazhit i cili ka të gjitha atributet e një heroi i cili lind dhe vdes për një kauzë më sublimë njerëzore, për lirinë e vendit të vet. Kjo don të thotë se figura qendrore, Kadri Kusari dhe Dervish Malluta në romanin tjetër na dalin figura kryesore.

Figura mitologjike dhe biblike ose të një simbolizmi a metaforizimi njerëzor çfarë në përgjithësi e karakterizon stilin e shkrimtarit, por disi fate të brendshme të një drame a një përvoje shumë të hidhur kur këta luftëtarë të lirisë, fati i katandis burgjeve, duke shijuar vrerin dhe mllëfin e armikut, dhe të cilin autori përpiqet t’ua pasqyrojë lexuesëve.

Romani lind si nënvetëdije e zgjuar, si diçka e ruajtur në kujtime nga autori që në rrethanën e jetuar të bën të kuptosh atë që thuhet. Janë vepra që lindën si produkt të disa mundësive dhe kënaqësive dhe autori nuk i fsheh këto situata

Andaj duke lexuar dhe kuptuar shume situata të dhënë në këto dy romane, do të trajtoj ato gjatë punës së këtij punimi.

Fjalët çelës: knaqësia, palimpsesti, heroi, imagjinata, etj.

Marjela Progni-Peci

Dashuria nën sfondin e ngjarjeve historike

(Poema “Krutan i mërguar” – Jeronim de Rada)

Jeronim de Rada është një nga autorët e shumtë të letërsisë shqipe, që në një mënyrë apo një tjetër, përfshin në veprat e tij një shumësi faktesh që lidhen me historinë e popullit shqiptar dhe shqiptarët. Inkorporimi i këtyre fakteve, që lidhen me kohë të ndryshme historike, që përfshijnë një toponomi të gjerë ekzistente, ngjarje të ndodhura e personazhe reale, në veprat e tij artistike, hibridizohet me të dhënat fiksonale, duke ndërtuar një tekst, që pavarësisht orientimit të tij literar, të krijon iluzionin e një shkrimi faktografik historik.

Poema “Krutan i mërguar” ndërtohet tërësisht nën sfondin e ngjarjeve të ndryshme të faktuara reale, siç janë: beteja e Sfetigradit, rrethimi i Krujës dhe betejat historike të shqiptarëve për mbrojtjen e saj, rënia e kalasë nën thundrën e pushtuesve, beteja e Otrantos mes forcave osmane dhe ushtrive italiane me aleatë, organizimi i shqiptarëve arbëreshë nën udhëheqjen e Gjon Kastriotit për të zbarkuar në Shqipëri, etj.

Nën këtë sfond të ndodhurash historike strukturohet linja tematike që ka në themel dashurinë. Dashurinë e humbur të Mirbanit dhe dashurinë e fituar të Rrembelmit. Dy dashuri që paralelizohen dukshëm me fatet e atdheut, e para që përzishëm pasqyrojnë humbjen e atdheut dhe e dyta që me optimizëm trumbeton shpresën për liri.

Fjalët kyçe: Atdheu, liria, dashuria, koha

Shqipe Haziri

Romani *Kënga shqiptare* dhe historia

Në këtë kumtesë do të shqyrtojmë raportin e romanit epike të letërsisë shqipe, *Kënga shqiptare* të Kasëm Trebeshinës me historinë. *Kënga shqiptare* është roman realist, që e njeh diskursin historik dhe nëpërmjet ngjarjeve historike trajton tema referenciale me historinë, por që nuk shkon kah dokumentarizimi i letërsisë, sepse historia si faktografi në roman shfaqet në funksion të fikcionit përmes fakteve dhe të dhënave historike, prandaj, realiteti estetik i romanit është shembëlltëror e realitetit historik e shoqëror shqiptar të kohës, e paraqitur nga distanca autoriale.

Romani epike, *Kënga shqiptare*, funksionon në shtjellimin kronologjik të ngjarjeve të historisë shqiptare të shekullit njëzet nëpërmjet skicimit të ideve politike dhe shoqërore në mjedisin shqiptar, të dala edhe si *përplasje ideologjike*, në raport me shpërndërrimet e mëdha politike dhe historike të historisë botërore të periudhës së fillimit dhe mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Faktet historike të historisë shqiptare të kësaj periudhe shndërrohen në fakte letrare nëpërmjet përjetimeve dhe perceptimeve të mendësisë shqiptare, e jo nëpërmjet precizitetit të argumentit historik.

Në rrjedhën e kësaj kumtese do të shqyrtojmë luftën si një *fakt historik* në këtë roman, që paraqitet kryesisht përmes skicimit të situatave të saj si situata personale, të cilat shpërfaqen, veçanërisht, si përjetime të personazheve. Pra, situata e luftës shtrihet brenda situatës personale.

Përfundimisht, mund të themi se romani *Kënga shqiptare* në raport me historinë qëndron si funksionim i pikëtakimit të fakticitetit historik me hapësirën e fakticitetit fikcional që shpërfaqet si situata, përjetime dhe momente meditative të personazheve kryesorë.

Vjona Sylejmani

'Teoria e origjinalitetit' – mes faktesh dhe fikSIONIT letrar

Bazuar apo nxjerrur nga 'faktet', apo ndoshta duke u futur e thelluar në 'fakte' ne krijojmë 'realitetin' tonë letrar, qoftë ky edhe një fikSION. Megjithatë, konstruimi i 'reales' shpesh bie ndesh apo ndikohet nga faktorë e rrethana kulturore e shoqërore, për të mos thënë kryekëput 'historike', duke krijuar kështu një realitet të ri fiktiv. Drejt kësaj rrjedhje të krijimtarisë artistike, qoftë letrare apo pamore, vazhdojmë të thirrmi në histori e fakte, por të cilat vazhdojmë t'i shohim ashtu siç duam e siç na konvenon ne – gjuajmë ujë në mullirin tonë, edhe pse faktet si burime historike dhe si burime letrare disi dallojnë ndërmjet veti, ama *disi*. Shih nga këtu, 'teoria e origjinalitetit' vlenë si frymëzim për krijimin e fikSIONIT duke u thirrur në 'fakte' të cilat me lirinë e ofruar dhe të dalë prej binarëve bastardohen, çorientohen e shthuren nën bindjen ndaj idesë së post-modernes. Tani, kush ishte dhe kush është i pari? - duhet njohur 'teorinë e origjinalitetit', ashtu që të dihet nëse e bënë faktet fikSIONIN, apo fikSIONI faktet.

Fjalë kyçe:teori, origjinalitet, fakt, fikSION

Seadet Beqiri

FikSIONI letrar në dramën "Katër epoletat" – H.Mulliçi

Fillimisht , ndarë nga fikSIONI si zhanër , fikSIONIN letrar duhet kuptuar si një tregim faktik ku situatat janë fiktive kurse personazhet që i përkasin jetës reale gjenden në një situatë ireale. I pranishëm në dramaturgjinë kombëtare që nga fundi i viteve të '60-ta në veprat e A. Pashkut, R. Qosjes, E.Kryeziut, B. Musliut, T. Dervishi, etj. Drama me elementet dhe situatat e fikSIONIT është temë studimi i këtij punimi , duke u ndalur ne veçanti në dramën "Katër epoletat" të dramaturgut H. Mulliçi .

Në këtë dramë, përmes dy gjeneralëve Alfadorit dhe Betadorit, autori pasqyron paradoksin e një lufte pa fitues. Të gjendur në gërmadhat e një qytet imagjinar e të shkatëruar, në kërkim të zërit të arsyes, e shohin vdekjen e tyre si të vetmin shpëtim. Personazhi i tretë i cili fillimisht duket plotësisht i parëndësishëm dhe i rastësishëm, i quajtur Grajet, i verbër për gjërë që e rrethojnë, me tipare të njeriut të thjeshtë i cili vazhdimisht kërkon shpëtim me shpresë që do ta gjejë qytetin e Pangjyrë apo utopinë e premtuar, na del të jetë personazh mjaft kompleks.

FikSIONIT i pranishëm në këtë dramë i jep interpretimit të saj dimension tjetër. Sa është fikSIONI faktik ? Ky studim do të meret me elementet sureale dhe afërsinë e tyre me jetën reale. Në rafshin letrarë ku ndeshen këto dy pasqyrime bota e vogël fiktive e personazheve të krijuara hap horizonte të

reja të kuptimit të realitetit. Shpesh herë bota imagjinare dhe elementet e fikSIONIT janë më të vërteta se vet realiteti faktik.

Hysni Ndreu

Libri i burgut i Arshi Pipës si tekst faktografik

Bazuar në marrëdhënien që ka me realitetin, në referencat konkrete të tij te bota reale, *Libri i burgut* mund të shihet më shumë si një tekst faktografik, sesa si tekst fikSIONAL. Të dhënat që na çojnë të mbështesim pohimin e mësipërm e që zbulohen përmes shenjash paratekstuale, janë: a) teksti shoqërohet me fusnota, nëpërmjet të cilave autori sqaron e saktëson lexuesin për emra konkretë vendesh e njerëzish, si dhe shpjegon kontekste apo situata që lidhen me mjediset e burgjeve apo ato të kampeve të përqendrimit; b) në parathënien që shoqëron botimin, vetë Pipa parashton informacione mbi arsyet pse vendosi të shkruajë në poezi e jo në prozë, arsye të cilat ai i ngërthen me rrethanat që ia diktonin kushtet e burgut; c) në dëshmi të mëpasshme, A. Pipa shpjegon disa prej situatave në të cilat qe gjendur dhe arsyet që e shtynë të shkruante këtë libër.

Një e dhënë tjetër mbi këtë libër ka të bëjë me ndarjen e tij në cikle. Pjesët janë renditur kronologjikisht, duke pasur si bazë vendet ku u shkruan vargjet, pra, burgjet apo kampet e përqendrimit, në të cilat autori kaloi një periudhë dhjetëvjeçare. Edhe nga pikëpamja e leksikut të shfrytëzuar, vihet re një përdorim i dendur i fjalëve që kanë si referencë botën reale dhe situata konkrete: spijuna, baraka, kamxhik, moçali, tuberkuloz, brraka, spitali, Moskova, dhunë etj.

Të gjitha këto të dhëna e shndërrojnë *Librin e burgut* më shumë në një dëshmi të gjallë të asaj që ka ndodhur, sesa në një tekst fikSIONAL, më shumë në tekst informativ, sesa në tekst të imagjinatës poetike.

Fjalë kyçe: faktografi, paratekst, referencialitet, dëshmi, biografi

Neli Naço

Pikëvështrimi, vendndodhja dhe hapësira në poezinë “Poradeci”

Poezia lirike “Poradeci” e Lasgushit përbën një nga poezitë më interesante ku kryqëzohen ide dhe koncepte të rëndësishme që kanë të bëjnë me formimin letrar të Lasgush Poradecit. E vështruar shpeshherë në këndvështrime të ndryshme poezia ka reflektuar vlera që kalojnë kufijtë e asaj që poezia shqipe ka reflektuar në kohë. Një nga marrëdhëniet më interesante që ka poezia është edhe pikëvështrimi origjinal që ka zgjedhur

poeti për të konceptuar marrëdhënien personale me universin. Vendndodhja e poetit është një pikë e rëndësishme që mund të nxisë diskutimin. Prania e vendeve që janë reale në poezi na bën të mendojmë për një marrëdhënie të cilën është e rëndësishme ta marrësh në shqyrtim, sepse prej saj mund të zulohen tipare të rëndësishme të postromantizmit të Lasgush Poradecit në nivele më të gjera. Vendndodhja e poezisë, marrëdhënia e saj me hapësirën, pikëvështrimi që ka zgjedhur poeti për të vëzhguar botën, zbërthen, le të themi, në një farë mase, edhe konceptime të reflektuara në poezi të tjera të Lasgush Poradecit. Po theksojmë këtu që fjala “pikëvështrim” është e përdorur më tepër në një kuptim quasi regjisorial dhe kjo fjalë është një fjalë çelës për të kuptuar statikën dhe dinamikën e poezisë “Poradeci”. Statika dhe dinamika janë fjalë që shprehin një marrëdhënie të së dukshmes dhe të padukshmes, të së qartës dhe të fshehurës. Ato janë të lidhura kësaj me vendndodhjen dhe hapësirën e poezisë dhe lëvizjen e brendshme të saj, të pashtershmen e lëvizjes. Krahasime me disa poezi të tjera dhe me koncepte të shprehura prej Lasgush Poradecit në shkrime të tij do të hedhin më tepër dritë në këtë etnocentrizëm poetik të tijin.

Adriana Duka

Të dhënat historike dhe fantastikja në tregimet e Kim Mehmetit

Tregimet e Kim Mehmetit ndërtohen mbi dy përbërës kryesorë: realiteti historik dhe dilema fantastike. I pari shenjohe si kohë reale, shtresëzohet përmes referencave historike mbi ngjarje, territore, të dhëna historike që aludojnë mbi vazhdimësinë etnike të shqiptarëve të Maqedonisë. Në pjesën më të madhe të tregimeve hapësira territoriale është shumë e rëndësishme për banorët. Mehmeti krijon arkitekturën e një vendbanimi që dyzohet mes të shkuarës së largët, traditave të ngurta, personaliteteve që ravijëzojnë tiparet antropologjike të vendasve dhe të ardhmes së pasigurt. Banorët e fshatit metaforik, nuk ndryshojnë përgjatë peridhave të ndryshme historike, kjo i ndihmon të ruajnë identitetin etnik, të mbijetojnë. Ky realitet faktik alternohet me përbërësin e dytë, fantastiken. Botëkuptimi i personazheve për të shkuarën historike është legjendar. Bestytinitë, magjitë, elementet përrallore, zbusin herë pas herë dramacitetin e vrasjeve, shkatërrimit, tmerrit që përjetojnë banorët e një vendi që përballet me asimilimin. Mehmeti, jo pa qëllim, personazhet e tij e rimerr në tregime të ndryshme, janë të njëjtët, me kokëfortësinë për të mos ndryshuar, me respektin për traditat edhe kur ato janë të ngurta. Fantastikja, e lejon shkrimtarin të tregojë dilemat, dyzimet e banorëve të një vendi që ëndërron, e mitizon shpesh të shkuarën e prejardhjen e tij, për hir të vazhdimësisë etnike. Kim Mehmeti këta dy përbërës i shtresëzon në tregime edhe si

teknika rrëfimi: trillimin e përzien, ndër kall ose monton me esenë historike, reportazhin, esenë përshkruese, opinionin.

Kjo kumesë synon të paraqesë se si përzierja e fakteve dhe trillimit në tregimet e Kim Mehmetit kanë krijuar një tip të veçantë tregimi i cili ruan një stil origjinal, të dallueshëm nga të tjerë shkrimtarë të tregimit bashkëkohor.

Fjalë kyçe: *histori, fantastike, tregim, Kim Mehmeti*

Adil Olluri

Letërsia e Ymer Shkrelit

Ymer Shkreli është njëri nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore shqiptare, por që vepra e tij nuk është trajtuar aq sa duhet nga kritika dhe studimet letrare shqiptare. Ai i lëvroi pothuajse të gjitha llojet dhe format letrare, si romanin, tregimin, poezinë, dramën, letërsinë për fëmijë dhe autobiografinë. Pra, kemi të bëjmë me një autor të kompletuar, sa i përket trajtimit të materies së tij letrare në shumë forma e zhanre letrare.

Ai është autor i mbi tridhjetë veprave autoriale, që janë të botuara, qoftë si libër në vete, qoftë si botim në vazhdimë në revista letrare e gazeta të kohës. Andaj, një gjë e tillë e bën atë njërin ndër shkrimtarët më produktiv të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Dhe jo vetëm ndër më produktivët, por për mendimin tonë, ndër më cilësoret në letërsinë tonë, që nga fillimi e deri më sot. Kështu që, intencën jonë për ta bërë këtë studim të gjatë për veprën e Ymer Shkrelit është që, përpos potencimit të vlerave të saj artistike, edhe afirmimin e tij si shkrimtar për lexuesin e studiuesin e sotëm të letërsisë shqipe. Pra, qëllimi jonë që është që ta rikthejmë në qendër të diskutimeve një shkrimtar të mirëfilltë, vepra e të cilit panevojshëm është lënë anash nga kritika letrare shqiptare.

Fjalët çelës: *Ymer Shkreli, letërsia bashkëkohore shqiptare, format letrare, autor produktiv, krijues cilësor, intencë afirmative*

Teuta Sula

Udhëpërshkrime të Edit Durhamit

Udhëpërshkrimet nuk janë tekste të pastra në kuptimin gjinor (letrar) të fjalës; ato bashkandajnë kufij me etnografinë, gjeografinë, religjionin, literaturën shkencore etj. Për këtë arsye i njëjti udhëtar, gjegjësisht tekst udhëtimi mund të jetë “pronë” studimi nga shkencat e historisë, gjeografisë, letërsisë, etnografisë etj. Nga ana tjetër përshkrimet e udhëtimeve janë përjetime personale të subjektit rrugëtar duke i shtresuar kësaj edhe një rrafsh emocional-subjektiv e *fixional* atij. Të flasësh sot për tekstet e

udhëtimit më së pari duhet të marrësh parasysh këtë artikulum (integrim) të disa shkallëshëm të niveleve të tyre të ligjërimit. Por, udhëpërshkrimet janë edhe tekste informuese, që dëshmojnë për një gjendje të caktuar jo vetëm rrugëtimi në kuptimin fizik të fjalës, por edhe për një prerje të caktuar diakronike, kulturore, shkencore, gjeopolitike, urbanizimi e më gjerë. Librat e udhëtimit janë burime shumë të mira informative për vendin dhe popullin e vizituar, për qytetin dhe urbanizimin, për raportet e udhëtarit me hapësirën urbane etj.

Punimi synon të shqyrtojë nga pikëpamja e ligjërimit *faktik e fiksional* tekstet udhëpërshkruese të E. Durhamit, një prej udhëtareve më të shquara që vizitoi Shqipërinë e la kontribut të veçantë në këtë fushë.

Drita Isufaj

Uji si simbol i erotizmit në krijimtarinë popullore

Uji si simbol haset dendur në letërsinë tonë popullore. Atë e ndeshim thuajse në të gjitha llojet dhe nënlojet e kësaj letërsie: në epikë, lirikë, përralla, legjenda, balada, etj. Ky punim fokusohet në zbërthimin e simbolit të ujit në këto krijime duke e vëzhguar atë si mbartës të erotizmit. Hulumtimi është kryer në rrafsh vertikal dhe objekti i studimit shtrihet nga krijimet më të reja deri tek ato më të vjetra me qëllim që të zbërthehet simbolika erotike e ujit si burim jete. Janë marrë në shqyrtim kryesisht fragmente krijimesh që paraqesin takimet e çifteve në vende me burime ujore si: burimet, krojet, çezmat, puset, brigjet e lumenjve, etj, duke vërejtur se si vendtakime të tilla shndërrohen në një simbol të rëndësishëm të erotikës. Burimet ujore janë vende që i përkasin kultit të natyrës, ku njeriu nuk ka vënë dorë e rrjedhimisht ato lidhen me instinktet tona më të thella si qenie njerëzore, më i rëndësishmi ndër të cilët është instinkti seksual.

Jorida Sotiri

Femra, personazhi i simbolizuar

Mbështetur në këtë kontekst, sjellim simbolikën e femrës, si pasqyrimi real i rrethanave njerëzore. Realiteti zëvendësohet me iluzionin, i cili i referohet një përfytyrimi, ku ëndrrat dhe shpresat përpëliten me dëshirën e bukur për të mos u shuar. Iluzioni zëvendëson realitetin, atëherë kur ai vjen i ashpër, i dhimbshëm. Sado që autori pretendon të zbresë në nivel tokësor, struktura e tekstit mbetet e deshifruar në simbol. Ashtu siç konstaton edhe Bendeto Kroçe “*simboli është krijuar i pashkëputur nga intuïta e autorit, ai është një sinonim i asaj intuïte që ka shenjat e idealea.*” Për këtë, autori, bashkë me

heroinën, përjetojnë iluzionin e një kohe tjetër, të lodhur, të pafuqishëm për ta mposhtur këtë realitet njerëzor.

Jo rastësisht simboli i femrës vjen shfaqet e në veprën e Koliqit, Migjenit, Spasses, gjithnjë “*në kërkim të ëndrrës e në këto kërkime femra mbart kryqin e vuajtjeve, simbolin e dhimbjes e të shpresës*”, duke sprovuar një situatë jetësore në dialog të personazhit me lexuesin e tij. Femra bëhet simbol i pafuqisë, e shtypur si në familje, ashtu edhe në shoqëri. Ajo tjetërsohet përballë kodit moral. Interesimi për botëperceptimin femëror, ndjenjat dhe fantazitë përfytyruese të saj i shtyjnë autorët ta trajtojnë me shumë kujdes figurën e femrës nëpërmjet personazhit letrar. Bota e saj e pasur dhe me plot të fshehta veçohet nga autorët për krenarinë, trimërinë, zgjuarsinë e bukurinë. Të tre autorët zbulojnë para lexuesit paraqitjen e simbolikës femërore. Tipari i përbashkët i tyre qëndron në pikëvështrimin e skenës së veprimit dhe të pësimin të personazhit, ku në bazë të raporteve të vendosura midis botës së brendshme dhe mentalitetit që i rrethon, ndërtohet një dhimbje apo dëshirë njerëzore. “*Melankolia e thellë kaplon shpirtat njerëzorë; në çdo hap shihen anët e errëta dhe mangësitë e jetës; vdekja, vetmia, tjetërsimi dhe gjykimi për diçka të largët, për një botë të panjohur që ikën nga e përditshmja*” e shkëputën femrën nga flakja e brengave të melankolisë, por, pasi realiteti shoqëror nuk ia ofroi këtë, nisi ta kredhë në dëshpërim të një shpirti të pashërueshëm të një blasfemi qytetës.

Fjalët-çelës :Personazh, simbol, femër, ëndërr, vuajtje, dhimbje etj

Loreta Loli

Raporti mes faktit e fiksonit në veprën e Konicës Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit

Fakti/E ndodhura janë të dallueshme dhe të ndryshueshme nga Fiksioni/Të krijuarit. Fakti mund të jetë shkas për të realizuar fiksonin në letërsi, por nga ana tjetër nuk duhet të presim që i pari (fakti) dhe i dyti (fiksoni) të barazohen, sepse sigurisht që funksioni/funksionet e fiksonit nuk është/janë ato të zbardhjes së faktit/të vërtetës, madje përkundrazi, mund të ndodhë, sikundër ka ndodhur, që nga një fakt të ketë marrë jetë fiksoni i veprës letrare i cili ka rezultuar kryekëput i devijueshëm nga fakti që e bëri të jetë. Ndërkohë, vepra letrare me anë të fiksonit të vet përcjell të vërtetën e saj për tek lexuesi, një e vërtetë e vetëmjaftueshme dhe e pavarur nga rrethanat jashtëletrare.

Punimi ynë do të ketë objekt analize prozën e gjatë të Faik Konicës “*Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit*”. E zgjedhëm për ta trajtuar këtë vepër pasi në të mund të analizojmë dallueshëm raportin midis Faktit dhe Fiksonit. Siç dihet, Dr. Gjëlpera u botua me pjesë tek *Dielli*, kur në Shqipëri, përkatësisht në Mamurras, kishte ndodhur tragjedia e vrasjes së

dy turistëve amerikanë, ngjarje për të cilën Konica shkroi artikuj denoncues të drejtëpërdrejt. Por Konica i sjell lexuesit edhe veprën letrare “Dr.Gjilpëra ...”, e cila premton se do të zbardhë rrënjët e kësaj ngjarjeje të ndodhur. Sa arrin fikcioni, dmth vepra, ta mbajë këtë premtim të autorit empirik? Nëse nisemi nga titulli përgjigja është plotësisht konfirmuese duke shmangur çdo hezitim. Kjo për një arsye të thjeshtë tekstore, referenti gjeografik, (Mamurrasi) njëhërazi referent historik,(drama e Mamurrasit), është pjesë e titullit të veprës, është pjesë e një fjalie dëftore, kategori gjuhësore që në thelb pohon një ngjarje, një veprim, një dukuri dhe për më tepër, paraprihet nga folja **zbulon**, gjithashtu një folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore. Të gjithë bashkë këta tregues gjuhësorë përcjellin tek lexuesi kofirmim dhe siguri se qëllimi i parashtruar mundet vetëm të realizohet gjatë thurjes tekstore.

Nëse referohemi në subjektin e veprës konstatojmë se nuk flitet në asnjë moment për një dramë të Mamurrasit, e aq më pak për zbulimin e kësaj drame e cila duhet të kryhet nga heroi i veprës, Dr. Gjilpëra.

Si qëndron atëherë kjo marrëdhënie në këtë veprë? Çfarë zbulon Dr. Gjilpëra në vizitën e tij në Shqipëri? Sa zbulon ai nga drama(dhe jo tragjedia!) që ndodh apo ka ndodhur në Shqipëri? A bëhet fjalë për të njëjtin fakt që ka ndodhur në Mamurras apo kemi një fakt të ri letrar? Si strukturohet zbulimi i Dr. Gjilpërës në tekst?

Armonela Paja

Tipare novatore të narracionit në veprat e Kadaresë

Ismail Kadare është shembulli më tipik i forcës krijuese, shkrimtar me emër në shkallë ndërkombëtare si dhe një nga autorët shqiptar ku vihen re dukshëm elementët novatorë të rrëfimit si mënyrat e procedimit me kohën, më rrëfimitarin, me distancën, etj.

Në këtë shkrim synohet të bëhet një interpretim për veprat e marra në shqyrtim: “E pengua”, “Nata më hënë”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Piramida”, “Kronikë në gur” dhe tregimi “Përpara banjës” të cilat përbëjnë kulmë në lëtërsinë shqipe dhe sidomos në fushën e narracionit.

Arsyet pse u zgjodh kjo temë janë dy: së pari analizohen romanet më tipikë ku duken përftesat narrative dhe fuqia e rrëfimit kadarean. Arsyeja e dytë, por jo më pak e rëndësishme është se duke zgjedhur këto vepra jam munduar të ndjek si ka lëvizur dhe është zhvilluar rrëfimtaria e këtij prozatori të madh, sepse siç dihet këto vepra janë shkruar në periudha të ndryshme të krijimtarisë së tij.

Kështu “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe “Kronikë në gur” janë romanet e para, për të vazhduar me “Piramida”, “Nata me hënë”, “Përpara banjës”

që përfaqësojnë mesin e krijimtarisë së tij dhe “E pengua”, që përfaqëson fazën më të fundit të prodhimtarisë së tij.

Punimi shqyrton risitë që ka sjellë secila vepër në lidhje me tematikën, kompozicionin, etj.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë punim janë: Roli i narratorit në vepër, tregimi i ngjarjeve, distancë, narratori brendadiegjetik (brenda ngjarjes) dhe narratori jashtdiegjetik (jashtëngjarjes), kombinimi i zërave, kategoria e frekuencës, të rrëfyerit përmes fjalës, ngarkesa emocionale dhe ritmet e rrëfimit, si dhe alternimi në veprat e Kadaresë.

Fjalë kyçe: *Ismail Kdare, narracioni, veprat në prozë, distancë, frekuencë, alternimi, etj.*

Meliza Krasniqi

Fakt apo fikcion – ditari letrar

Bazuar në një rrëfim/ngjarje të vërtetë është linja e hollë midis faktit dhe fikcionit. Kufijtë letrar gjithnjë ndryshojnë, kufijtë përzihen – janë të paligjshëm. Herë pas here, statusi i padefinuar i veprës na shpie te relacionin dhe kufiri ndërmjet faktit dhe fikcionit. Diskutimet e tilla krijojnë dilema nëse fikcioni dokumentar duhet të konsiderohet si fakt apo fikcion. Për shumë vite ky ishte një *vendi ndërmjetëm* paqësor dhe i pakontestuar por edhe i braktisur.

Si zhanër i fikcionit dokumentar, ditari letrar u popullarizua në shekullin e XVII. Ditari është formë e realizimit të fjalës, që përfshin fakte të regjistruara, përshkrime, si dhe diskutimin mbi veten.

Në letërsinë botërore, ditari konsiderohet të jetë zhanër origjinal në aspektin e strukturës dhe stilit të gjuhës. Ndryshe nga të ashtuquajturat 'Zhanre tradicionale' (proza, balada, poema, drama, etj.), ditari letrar është më pak i zakonshëm. Interesi ndaj këtij zhanri me sa duket mund të shpjegohet me natyrën nxitëse dhe origjinale të këtyre veprave. Para se të trajtohet ndonjë aspekt i ditarit letrar do duhej të definohej se ditari është shënimi i ngjarjes së jetës së individit, i të dhënave ditore të atyre përvojave dhe mendimeve.

Ditarët janë kujtime - kujtime personale të cilat i referohen një periudhe të shkurtër kohore. Rrëfimi i hapur, eventualiteti përmbajtjesor, toni intim, shpërthimi i sinqertë i ndjenjave dhe i shpirtit dominojnë në ditar, si dhe në letra.

Ditarët kanë kohezion të brendshëm, atë që quhet harmoni e fshehtë, kjo shihet krejt në fund. Në rrëfimet dokumentare, ditari tregon jetën e autorit, atë personale, shoqërore ose të lidhur me veprën e tij letrarë në vetën e parë, për çdo ditë ose për disa ditë.

Fjalët kyçe: fikcion, dokumentar, ditarë, rrëfim

Saranda Buzhala

Tragjedia e rrënjëve si baladë për humbjen

Romani "Oh" i Anton Pashkut është roman karakteristik dhe njëkohësisht i veçantë në letërsinë shqipe. Rrëfimi në këtë roman shtrihet deri në kohën antike ilire, përkatësisht merret tragjedia e rënies së Ilirisë, lufta që Gentit iu desh të bënte kundër aristokracisë së lartë me tendencë proromake, e cila kishte përkrahës edhe në oborrin mbretëror. Në këtë luftë ai nuk u ndal as përpara sakrificimit të vëllait, Platorit, që Roma synonte ta vinte në fron në vend të tij.

E, kjo temë e marrë nga historia jepet përmes ngjyritit ironiko-alegorik, ku figuracioni dhe simbolika e shquajnë dhe e bëjnë më të zëshme idenë qendrore të romanit: historinë shqiptare të dhimbshme e të përsëritur. Ndërsa, kthimi në retrospektivë vjen si nevojë për t'u njohur me kohët, me të tashmen përmes së kaluarës, e cila simbolikisht arrihet përmes plakut, që nuk mund t'i bëjë bashkë kurrë të njëqind delet, përmes ushtarëve të mundur e të thyer nga romakët, pasqyrave me dy faqe, që sjellin thyerjen e vendit, etj.

Kështu, fakti historik qëndron pas fiksonit letrar dhe mjeshhtërisë antoniane krijuese.

Fjalët çelës: retrospektivë, fikSION, simbolikë, etj.

Blerina Rogova Gaxha

Vdekja në *Andrrën e jetës*

Poeti i hapësirës letrare e kulturore shqiptare, Ndre Mjedja, në lirikën e tij ofron qasje autentike në fenomenin e vdekjes, duke e projektuar poetikisht në disa tekste. Mbi konceptet e filozofisë autoriale, Mjedja thuri tekstat e jetës dhe vdekjes, duke e kapur dramën e njeriut në zemrën e realitetit drejt finalitetit - vdekjes.

Vepra e cila bukur e shtrin filozofinë e mjedjane të vdekjes është poema *Andrra e jetës*. E klasifikuar si kryevepër poetike e poetit, ajo po ashtu bëhet poema e parë shqipe që njeriun e zakonshëm e shkruan si qenie përballë vdekjes së zakonshme.

Me *Andrrën e jetës*, Mjedja duke i shkruar ciklet e mëdha të jetës, na fton të lexojmë për qenien, ekzistencën dhe esencën e saj në botë. Na fton të lexojmë për përkohshmërinë dhe mbarimin nëpërmjet rrëfimit të dhembjes njerëzore në dhembjen e përhershme jetësore.

Në këtë lexim autentik lexohet jeta dhe vdekja si esenciale në tematikën e poezisë lirike, përtej teologjisë e petkut fetar të poetit, me qëllim paraqitjen e dimensionit të fenomenit të vdekjes, si element tejet sinifikativ i

tematikës, semantikës dhe simbolikës së veprës dhe sinjifikativ në vetë traditën e letrave shqipe.

Orjela Stafasani

Pasardhësi mes faktit dhe fiksionit

Pasardhësi i Ismail Kadarese është një roman për të vërtetat historike të viteve 1981-'82 në Shqipërinë komuniste, ku përmes një rrëfimi analeptik, autori na sjell në fokus ngjarje që në mënyrë proleptike ishin parashikuar. Përmes lojës me narratorin heterodiegetik, pastaj përmes rrëfimit të Arkitektit, që bëhet narrator homodiegetik dhe monologut përmbyllës nga kryepersonazhi i romanit, Kadare na paraqet (vetë)vrasjen e Pasardhësit, duke ndërthurur mjeshtërisht historinë me fiksionin. Prandaj, ky punim ka si qëllim që përmes mbamendjes kolektive, të vërtetave historike, intertekstualitetit dhe intermedialitetit, të gjejë lidhjet mes faktit dhe fiksionit, duke parë edhe ndërvarjen mes këtyre të dyjave. Përmes personazheve realë dhe fiskionalë, Kadare jep (vetë)vrasjen më të bujshme të shekullit të kaluar në Shqipërinë komuniste, atë të kryeministrit Mehmet Shehu, e gjithashtu përfshirjen dhe arrestimin e mëvonshëm të ministrit të Brendshëm, Kadri Hazbiut, të dyja këto të nxitura nga Enver Hoxha.

Pasardhësi është një model i gërshetimit të faktit me fiksionin dhe një dëshmi se sa hipoteza mund të prodhojë një fakt i fshehur.

Arian Krasniqi

Skënderbeu në dramat e Whnichop-it, Lillo-s, Havad-it, dhe Faurres-it

Figura shumëdimensionale, shumështrësore, e gjithanshme dhe shëmbëllyese e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeu (1405-1468), për shekuj të tërë tërhoqi vëmendjen, ngacmoi imagjinatën dhe shpërtheu dellin krijues të autorëve të njohur dramatistë.

Janë një numër i konsiderueshëm krijuesish shqiptarë që në veprat e tyre dramatike kanë trajtuar temën e figurës së Skënderbeut. Megjithatë, nuk është vetëm dramaturgjia shqiptare ajo që, tematikisht, ka trajtuar figurën dhe rolin historik të Skënderbeut. Përgjatë viteve të ndryshme autorë të njohur të dramaturgjisë botërore janë provokuar dhe kanë shkruar tekste dramatike që në epiqëndër kanë Skënderbeun. Për fat të keq, këto tekste janë fare pak të njohura për audiencën shqiptare. Prandaj, përqendrimi i vëmendjes sonë bëhet mbi këta autorë dhe veprat e tyre dramatike që trajtojnë në një mënyrë a tjetrën Skënderbeun dhe periudhën në të cilën ai jetoi dhe veproi. Kështu, përgjatë shekullit 18-të, na shfaqen tre dramatistë botës angleze: Thomas Whnichop me "Skënderbeu, ose Dashuria dhe Liria"

(*Scanderbeg, or Love and Liberty*), (1727), George Lillo me “*Heroi i krishterë*” (1753), dhe William Havad me “Skënderbeu” (Scanderbeg) (1733), në dramat e të cilëve kanë gjetur shprehje bëmat dhe historitë e famshme të Skënderbeut. Dy nga këto tekste kanë ardhur deri në ditët tona në formën e tyre të plotë, prandaj përmbajtjet dhe shënimet plotësuese e analitike për to do i sjellim në formë më të detajizuar. Ndërkaq, krahas këtyre autorëve anglezë, me një tragjedi për Skënderbeun na vjen edhe Rogattien Faurres me dramën “*Skënderbeu ose heroi shqipëtar*”. Kjo tragjedi është përkthyer në shqip më 1912. Por, si na vjen dhe si na paraqitet në dramat e këtyre autorëve kryepersonazhi me emrin Skënderbe? Cilat janë pikëvështrimet shumëkëndore të figurës së Skënderbeut në këto vepra dramatike? Këto dhe pyetjet tjera të shumta do të trajtohen, analizohen dhe shtjellohen në këtë punim.

Fjalë kyçe: Skënderbeu, dramaturgjia, tekst, tragjedi, analizë, hero, kryepersonazh.

Mimoza Hasani Pillana

Elemente faktike dhe fiksonale te poezia e Sabri Hamitit

Në këtë punim do të trajtojmë faktin dhe fiksonin në poezitë e Sabri Hamitit, konkretisht në librat *Kaosmos, ABC dhe Melankolia*, ku fakti dhe fiksoni janë elemente të dukshme.

Fakti shfaqet përmes elementeve të ndikuara nga rrethanat e fëmijërisë së hershme dhe jeta e zhvilluar më vonë në rrafshet e ndryshme shoqërore e politike. *Lulja* në përgjithësi, *lulja e egër*, *lulëkuaja*, *lulja e xhenetit* në veçanti, pastaj *veku*, *pragu*, *kamxhiku* janë fakte përmes së cilave autori identifikon vendlindjen që kryesisht realizohet nëpërmjet kujtimit e mallit. Ndërsa, elemente faktike dalin edhe në temën e dashurisë, sidomos në relacionet me prindërit.

Në temat sociale, si dhuna, trysnia, tjetërsimi që reflektojnë në poezi si pasojë e rrethanave të vështira socio-politike të viteve kur u krijuan poezitë, elemente faktike krijohen brenda gjuhës poetike. Veçoj poezitë *Paqja kriminale* dhe *Pranvera stina më e tmerrshme e vitit*, ku përmes figurës së anitezës në titull dhe figurave tjera në brendi dalin elemente faktike në funksion të kujtimit dhe mesazhit qendror.

Elementet fiktive shfaqen te tema e vetmisë dhe mungesës së lirisë. Tendencia për të dalë nga gjendja e mërzi në çastet kur shpresa, gëzimi, ëndrra shuhen autori përdorë elemente fiktive brenda poezisë.

Përvëçar ndaras, fakti dhe fiksoni dalin edhe në ndërlidhura, “*U zu dielli*”, pastaj vargu “*Grua i vrarë jam dhe thirri miqtë*”.

Fjalët kyçe: fakt, fikson, poezi, temë, varg, autor.

Serafina Lajçi

'Mino', mes faktit dhe fiksionit

Vepra letrare e Zef Skiroit, është një mishërim i reales me artin. Si e tillë, ajo është reflektim i preokupimeve e shqetësimeve të autorit, jo vetëm të atyre personale, por edhe shqetësimeve të mëdha, të lidhura me fatin e realitetin arbëresh. Duke e shpalosur kështu, artin e vet krijues, Skiroi, me një talent të veçantë, e konkretizon estetikisht, përballjen e tij me realitetin. Në këtë mënyrë, poemat e Skiroit, janë shprehëse të rrethanave e situatave të caktuara, pjesë e të cilave është poeti.

'Mino' që është në qendër të studimit tonë, është një përjetim letrar i vdekjes tragjike të birit të poetit, Minos i cili qe viktimë e një vrasjeje politike. Do të jetë pikërisht kjo situatë tragjike, e cila do të ndikojë dukshëm në shëndetin dhe jetën, edhe ashtu të trazuar të Skiroit. Duke qenë poemë që shpalos një të vërtetë tronditëse të poetit, ajo është një gërshetim i faktit me fiksionin, si dy komponentë të rëndësishëm që e shquajnë përbërjen e saj. Pra, fakti, si e dhënë konkrete, reale e jetës se poetit dhe fiksioni, si shkrimje artistike e saj në poemë.

Flamur Maloku

Letërsia e burgut përballë faktit dhe fiksionit

Letërsia e burgut, si shenjëzim faktual dhe fiksional njëkohësisht, ruan specifikat e veta, të cilat lidhen me rrethanat e krijimit të saj. Duke qenë se kjo lloj letërsie përbën një rast të veçantë në letrat shqipe dhe nuk është fort e studiuar, shtyja për t'u marrë me të na vë përpara sfidash të natyrave të ndryshme, në përpjekjen për të dhënë një përkufizim mbi atë se çfarë është *Letërsia e Burgut* në vetvete, *Fiksion* apo *Fakt*. Një argumentim i këtillë kërkon, para së gjithash, edhe mendime teorike, për një venerim sa më të saktë të përballjes së ndodhive reale si fakt, me përjetimet autoriale si fiksion, e dëftuar tashmë në letrat shqipe me *Shkrimet* dhe *Autorët* e saj, ku letërsia ishte bërë hapësirë lirie, madje diçka më shumë, forcë mbijetese dhe fuqi shprehëse.

Naser Pajaziti

Studimet dialektologjike në Kosovë

Ne ketë punim të marrim në shqyrtim një varg skicash, studimesh e monografish dialektologjike që janë bërë për të folmet e Kosovës në të

cilat janë trajtuar dukuri të ndryshme gjuhësore fonetike, morfologjike, sintaksore e leksikore dhe të cilat si të tilla ndriçoj një varg tiparesh gjuhësore që janë karakteristike për këto të folme dhe njëkohësisht, duke na bërë kështu të mundur të shohim një pamje sa më të qartë gjuhësore për këto të folme.

Xhavit Beqiri **Fishta dhe shkolla shqipe**

Autori i epit nacional shqiptar “*Lahuta e Malcis*”, At Gjergj Fishta është një ndër emrat më të rëndësishëm të shkollës shqipe në gjysmën e parë të shekullit XX. Që në vitin 1899, Fishta bashkëpunoi me Preng Doçin (1846-1917), me dom Ndoc Nikajn (1864-1951) dhe me folkoristin Pashko Bardhi (1870-1948) për të themeluar shoqërinë letrare *Bashkimi* të Shkodrës, e cila i hyri punës për zgjidhjen e problemit shqetësues të alfabetit të shqipes. Fishta, figurë udhëheqëse e jetës kulturore e publike në Shqipërinë e veriut, sidomos në Shkodër, në vitin 1902, u emërua sekretar i Komisarjatit General të Misjonit Françeskan të Shqypnis dhe Drejtues i Shkollës françeskane në Shkodër, e cila “kje e para shkollë në Shkoder, në të cillen mësimet filluen me u dhanë në gjuhë shqype”.

Megjithatë, veprimtaria e gjithanshme e Gjergj Fishtës kulmoi me pjesëmarrjen në Kongresin e Manastirit (1908), në të cilin ai përfaqësoi shoqërinë letrare *Bashkimi*. Më 1913 Fishta themeloi revistën “Hylli i Dritës”, e përmuajshme françeskane, e cila botoi tekste letrare, folklorike, politike e historike. Më 1916, u rikthye në Shkodër, në kohën e zotërimit austriak, dhe mori drejtimin e gazetës “Posta e Shqypnies” (edicionin shqip). Ndërkohë, bashkë me Luigj Gurakuqin, Ndre Mjedën, Mati Logorecin etj., nisi punën për organizimin e Komisis Letrare të Shkodrës, e cila punoi për përmirësimin e drejtshkrimit dhe për unifikimin e gjuhës shqipe.

Komisia vendosi që të përdorej dialekti qendror i Elbasanit si një kompromis asnjans për gjuhën letrare. Por, ky vendim ishte në kundërshtim me dëshirat e Gjergj Fishtës, i cili *shpresonte se koineja shqiptare e veriut së shpejti do të shërbente si normë letrare për të gjithë vendin, ashtu si gjuha e Dantes kishte shërbyer si udhërrëfyes për italishten letrare.* / **Fjalët çelës:** Fishta, shkolla, gjuha, Kongresi, alfabeti, Komisia, *Bashkimi*.

Asllan Hamiti

Puna mbi 60- vjeçare e Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit

Në këtë kumtesë do të përshkruajmë historikun e veprimtarisë së suksesshme arsimore, shkencore e kulturore 66-vjeçare të Katedrës së Gjuhës e të Letërsisë Shqiptare në Universitetin e Shkupit, duke paraqitur edhe problemet dhe nevojat e kohës. Do të japim disa të dhëna të rëndësishme për ciklin e parë, të dytë e të tretë të studimeve, ndihmesën e dhënë të mësimdhënësve të kësaj Katedre në shkencën albanologjike, në hartimin e teksteve parauniversitare e universitare etj.

Përveç mësimdhënësve të rregullt, në këtë Katedër kanë ligjëruar edhe profesorët: dr. Latif Mulaku, dr. Shefqet Pllana, dr. Olivera Jashar-Nasteva, dr. Imri Badallaj, dr. Sadik Bejko, dr. Thoma Dhima etj. Herë pas here Katedrën e kanë nderuar me ligjërata edhe personalitete të shquara të shkencës e të kulturës shqiptare, si: prof. Eqrem Çabej, prof. Anastas Dodi, prof. Jani Thomai, prof. Shaban Demiraj, prof. Rexhep Ismajli, ndërsa si mentorë dhe anëtarë komisioni për mbrojtjen e doktorateve kanë marrë pjesë jo pak albanologë, si prof. Emil Lafe, prof. Xhevat Lloshi, prof. Rami Memushaj, prof. Gjovalin Shkurtaç, prof. Shaban Sinani, prof. Imri Badallaj etj.

Katedra edhe pse është njëra ndër institucionet më të mocme të arsimit të lartë të shqiptarëve, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rrafshin kombëtar, nuk e gëzon përkrahjen e nevojshme të organeve përkatëse shtetërore. Ajo përballet me shumë probleme, por më të mëdha janë tri nga to: mungesa e kuadrit si pasojë e mospranimit të asnjë mësimdhënësi në këto pesëmbëdhjetë vitet e fundit, mungesa hapësirave të nevojshme, kufizimi i përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe etj.

Berton Sulejmani

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe e Universitetit të Tetovës - vatër e zhvillimit të gjuhës shqipe dhe e përgatitjes së kuadrit arsimor e shkencor (1994 – 2017)

Në këtë kumtesë shkencore do të paraqesim rolin e Katedrës (ose Programit Studimor, siç po i thonë viteve të fundit) së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe të UT-së që nga themelimi i saj (1994) e deri më sot (2017). Siç shihet, Katedra në fjalë ka hyrë në dekadën e tretë të punës së saj, andaj, edhe të përfshihen të gjitha aktivitetet dhe historiku 23-vjeçar i saj brenda një kumtese është sa e vështirë, madje e pamundur. Por, si mësimdhënës i rregullt dhe si shef i tanishëm i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe do të përpiqem që në vija të trasha të jap të dhëna për punën arsimore,

shkencore e kulturore të saj. Profesorët e katedrës në fjalë janë edhe bartës të shumë aktiviteteve dhe ngjarje të rëndësishme të UT-së. Veç tjerash, ata janë bartës të punës 11-vjeçare të Seminarit Ndërkombëtar të Albanologjisë, Konferencës së Fakultetit të Filologjisë (sivjet bëhen 4 vjet që kur ka filluar të organizohet) e shumë ngjarje të tjera, përvjetorë, shënime e manifestime që organizohen me rastin e festave të ndryshme kombëtare, si: 7 Marsi, Kongresi i Manastirit etj. Profesorët e kësaj katedre mbajnë edhe lëndën Kulturë gjuhe, Gjuhë shqipe, Gjuhë amtare (varësisht se si është e akredituar) në programet studimore të një numri të madh të fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Anton Pançev

Sofja si qendër e zhvillimit të shqipes

Gjatë 140 viteve të fundit, Bullgaria, dhe në veçanti kryeqyteti i saj, Sofja, gjithmonë ka qenë ndër qendrat botërore shkencore dhe arsimore në fushën e shqipes. Nga njëra anë, kjo ka qenë rezultat nga puna e kolonisë shqiptare në Sofje dhe në disa qytete të tjera bullgare, nga ana tjetër, për shkak të punës së shkencëtarëve bullgarë. Librat dhe gazetat shqiptare, botuar në Bullgari, punimet shkencore të shkencëtarëve bullgarë vazhdojnë të jenë burim i çmueshëm për gjuhën shqipe. Teksti ka për qëllim prezantimin e arritjeve shkencore dhe arsimore në fushën e shqipes në Bullgari, kryesisht në gjuhësi dhe letërsi, dhe bazohet mbi hulumtime të arkivave bullgare dhe të punimeve prej autorëve me kontribut të rëndësishëm në albanologji, etj. Fjalë kyçe: Sofja, qendër, gjuha shqipe, gjuhësi, letërsi

Aleksandër Rusakov, Aleksandër Novik, Maria Morozova

60 vjet të studimeve albanologjike në Rusi:

veprimtaria e degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin Shtetëror të Sankt-Peterburgut

Në kumtesën bie fjala për historinë, personalitetet, arritjet dhe perspektivat e degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe që ekziston pranë katedrës së gjuhësisë së përgjithshme në Fakultetin Filologjik të Universitetit Shtetëror të Sankt-Peterburgut. Kjo qendër e parë e studimeve albanologjike në Rusi u themelua më 1957 me iniciativën e albanologes së shquar prof. Dr. Agnia Desnickaja, e cila së bashku me Gertrudën Ejntrej përgatiti plejadën e albanologëve të njohur rusë dhe të huaj, përkthyesve dhe profesorëve të ardhshëm të albanologjisë, ndër të cilët janë Irina Voronina, Aleksej Sitov, Alvina Zhugra, Aleksandër Rusakov, Lubovj Sharapova, Marina Domosileckaja, Valerij Modestov, Albina Girfanova,

Larisa Kaminskaja, Rusana Hristova-Bejleri, Aleksandër Novik, Julia Ivanova-Buçatškaja etj.

Gjatë historisë gjashtëdhjetëvjeçare të degës albanologjës rusë kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në fushën e historisë së shqipes, gramatologjisë, etnografisë dhe dialektologjisë shqiptare, përfshirë këtu studimet e fondit leksikor indoevropian (A. Desnickaja, A. Rusakov) dhe të huazuar (A. Morozova), etj. Veprimtaria e sotme e nëpunësve të degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe të ish-studentëve të saj, që punojnë nëpër institucione të ndryshme në Rusi dhe në mbarë botën, vazhdon të ketë për qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e albanologjisë, promovimin e imazhit të vendeve shqipfolëse dhe të shqipes, si dhe zgjerimin e njohurive shkencore për gjuhën shqipe si një gjuhë me histori të pasur që zhvillohet në mënyrë dinamike në të gjitha format e saj bashkëkohore.

Valbona Hystuna **Hapësirat e shqipes në Greqi**

Rreth 27 vjet Greqia fqinje bashkëjeton me mijëra shqiptarë që emigruan gjatë dhjetëvjeçarit '90 e më pas. Një bashkëjetesë me dobitë dhe problematikë e saj, me hapësirat dhe pengesat që krijuan faktorë të ndryshëm.

Duke qëndruar tek hapësirat, kushtet e reja të kësaj bashkëjetese nxitën një rrjet akademikësh, të rinj e të vjetër, të zbulojnë specifikat gjuhësore e kulturore të emigrantëve shqiptarë. Krahas studimeve të shumta akademike, të tjerë anëtarë të shoqërisë lindën midis tyre miqësinë, bashkëpunimin, lidhjet martesore, etj me emigrantët. Komunikimi në gjuhën shqipe, në shprehje të mirënjohjes apo bashkëveprimit reciprok, u bë një nevojë për ta. Instituti i Studimeve Ballkanike (Ιδρυμα Μελετών Χερσονήσου του Αίμου – IMXA) me histori shumëvjeçare (1953) në fushën e tij, ofroi hapësira për mësimin e shqipes tek miqtë e emigrantëve, bashkëpunëtorët, mësuesit, bashkëshortët e tyre, të etur për të njohur më mirë kapacitetet gjuhësore e kulturore të shqiptarëve.

Kjo bashkëjetesë nuk la mënjandë evoluimin gjuhësor shqip të vetë emigrantëve... fole të vogla dhe të shumta u krijuan për mësimin e gjuhës shqipe nga vatra të ndryshme komunitare. Herë me përkrahjen e

institucioneve shtetërore, herë me ato private, shtrihen çdo ditë e më shumë në të gjithë Greqinë.

Tomorr Plangarica, Merita Plangarica

***Shkolla Normale* e Elbasanit dhe studiuesit elbasanas për studimin e zhvillimin e shqipes në gjysmën e parë të shekullit XX - përvojë që u përftua e nxitur prej një tradite dhe nxitit shqyrtime të mëtejshme.**

Edhe pse përvojat studimore në lidhje me shqipen në *Shkollën Normale* të Elbasanit dhe, më gjerë, në mjedisin intelektual të këtij qyteti nuk kanë arritur të përvijojnë një kahje të dukshme me kufij lokalë lehtësisht të identifikueshëm në studim e produkt, mund të vërejmë gjithsesi kontribute që lidhen me studiues, intelektualë, mësues dhe të pasionuar pas shqipes, që sollën prurje të konsiderueshme në mendimin gjuhësor shqiptar. Këto prurje herë qëndrojnë në kuota të larta të mendimit gjuhësor, e herë të tjera sjellin fakte, ngrënë probleme të përditshmërisë së përdorimit të shqipes që u mundësojnë më tej gjuhëtarëve të tjerë më të prirur drejt përgjithësimeve e teorizimeve të vijnë e të japin zgjidhje. Ishte një përvojë që frymëzohej nga një traditë e përvijuar nga Todri e Kristoforidhi, dhe përvijohet më tej me emra të spikatur si Lef Nosi, A. Xhuvani, Kostaq Cipoja, S. Shuteriqi, krahas emrave të tjerë me kontribute më modeste, por gjithsesi të vlerësueshme.

Giuseppe Chiaramonte

Diakronia e arbërishtes së Siqelisë përmes mbishkrimeve

Përveç veprave arbërisht nga shkrimtarë dhe poetë të ndryshëm, në qytezat arbëreshe në Siqeli ruhet një mori mbishkrimesh, sidomos nepër kisha. Ato janë bërë të njohur qëmoti nga punimet e Prof. At Zef Valentini-t dhe të Prof. Papas Matteo Sciambra-s. të cilët i kanë trajtuar ato për arsye ngushtësisht historike.

Ketu do t'i vështrojmë nga pikëpamja komparative dhe të diakronisë së të shkruarit arbërisht.

Valbona Sinanaj

Instituti i Studimeve Albanologjike në Universitetin “La Sapienza” të Romës dhe kontributi i profesorëve Giuseppe Gradilones e Elio Miraccos.

Katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Universitetin “La Sapienza” të Romës (më parë *Istitutodi Studi Albananesi*) është një nga institucionet e rëndësishme albanologjike, fillimisht e drejtuar nga Ernest Koliqit, më pas nga prof. Giuseppe Gradilone dhe tani aktualisht drejtohet nga profesori arbëresh Elio Miracco.

Prof. G. Gradilone është personalitet i shkencave albanologjike, ka lindur në Shën Demetrio Korone (Kozencë), qendër e rëndësishme historike dhe kulturore e shqiptarëve të Kalabrisë. U diplomua për letërsi në Universitetin e Romës, në të cilin petagogë e mjeshtër të studimeve, si Ernest Koliqi, ndikuan në formimin e tij, në të njëjtin universitet u specializua edhe për Filologji klasike. Lektor i gjuhës shqipe që prej vitit 1952, docent i lirë që prej vitit 1962, më pas profesor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe dhe docent i parë i Filologjisë shqipe në Facoltà di Lettere e Filosofia të Universitetit të Romës “La Sapienza”. Si nxënës dhe pasardhës i aktivitetit shkencor-pedagogjik të E. Koliqit, ai ka mbajtur gjallë Institutin e Studimeve Albanologjike të këtij Fakulteti, pranë Universitetit “La Sapienza”. Metoda e tij e punës, buron nga eksperiencia të ndryshme të studimit, disa prej të cilave të panjohura në Albanistikë, si plani krahsimtar dhe ndryshueshmëria bashkëkohore, një mbizotëues historik dhe një filologji rigoroze me sensibilitet e shije për vlerat e gjuhës dhe të stilit. Studimet e tij kritike, dallohen për zbulimin njerëzor dhe artistik, në çdo mesazh letrar lexohet shkoqur lidhja me letërsinë shqipe në momentet dhe me personalitet e saj të ndryshme: nga rrënjët e letërsisë popullore tek ndikimi i letërsisë antike dhe moderne, nga formimi gradual i një tradite në impenjimin politik, civil, shoqëror dhe gjuhësor i shkrimtarëve të Shqipërisë dhe të Diasporës.

Pas diplomimit në 1967 në “La Sapienza” me temën e diplomës të udhë hequr nga Ernest Koliqi, Prof. Miracco nisi bashkëpunimin pikërisht me këtë Institut duke kontribuar në pasurimin e mëtejshëm të tij. Hulumtimet e tij u përkasin degëve të ndryshme të albanologjisë duke filluar nga çështjet filologjike e kritike të studimeve të De Radës etj.

Mimoza Priku

Shkodra - qendër e rëndësishme e leksikografisë shqipe

Leksikografia si arti i krijimit të fjalorëve ka një vend të rëndësishëm në historinë e studimit e të zhvillimit të një gjuhe. Në traditën e pasur të leksikografisë shqipe Shkodra njihet si një qendër e cila ka ndihmuar jo pak

në zhvillimin e kësaj fushe dijeje. Kjo trashëgimi ka nisur dhe është zhvilluar në krye të herës si një leksikografi dygjuhëshe për t'u pasuruar me fjalorë shpjegues e glosarë të tipeve e llojeve të ndryshme.

Në këtë kumtim do të jepet përmbledhtazi një historik i zhvillimit të këtij drejtimi bashkë me disa arritje në Shkodër. Një hov kjo traditë mori në këtë qytet-qendër në gjysmën e dytë të shek. XIX, për të ardhur tek një pasuri me vlerë sidomos gjatë gjysmës së parë të shek. XX me hartimin e fjalorëve latinisht-shqip (Jungg, Giacomo Fialuur i voghel scryp e ltinisct, Mledhun prei P. Jak Junkut t' Scocniis Jezu n' Sckoder t' Scypniis, 1895) e sidomos italisht-shqip e anasjelltas ("Fjaluer i ri i shqypes" botuar nga Shoqëria "Bashkimi", Shkodër, 1908; Antonio Busetti "Vocabolario italiano-albanese", Scutari: Tipografia dell'Immacolata, 1911; Fulvio Cordignano "Dizionario Italiano-Albanese" Shkodër: Shtypshkronja e Zojës s'Paperlyeme, 1939). Ato erdhën si domosdoshmëri e mësimi të gjuhëve klasive e atyre moderne dhe shpesh si ndihmëse të gramatikave ose si shtojcë e tyre. Mes të tjerëve ka pasur edhe fjalorë të një natyre tjetër, si *Fjalori onomastik* hartuar nga NikollëGazulli (botuar pjesë-pjesë në revistën "Hylli i Dritës" nga nr. 2, fruer 1939, vjeti XV, f. 120-129 e gjer në nr. 9-12, 1943, f. 391-406 (shkronjat A-K), gjithsej 21 numra të revistës).

Sigurisht gjatë trajtimeve do të përpiqemi t'u japim përgjigje edhe disa problematikave, si: A vazhdon Shkodra të jetë një qendër e tillë? Cilat janë sfidat e sotme? Në vëmendje do të jenë botimet e pas viteve '90 të Institutit të Studimeve Albanologjike në Shkodër (Kolë Ashta "Leksiku historik" I-VI, Kolë Kamsi Fjalor arbërisht-shqip, Shkodër, 2000), si dhe disa botime me vlerë të Shtypshkonjës Franceskane (Bardhyl Demiraj, *Dictionarium latino-epiroticum. Per R. D. Franciscum Blanchum*, (Romæ 1635), Botime Françeskane, Shkodër 2008; Gezim Gurga: *Dittionario italiano-albanese* : 1702 / at Francesco Maria da Lecce (botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip) Shkodër : Botime Franceskane, 2009.) etj.

Fitor Ollomani

Gjuha shqipe në "Kanunin e Lek Dukagjinit"

Në kumtesën tonë do të përpiqemi të parashetrojmë disa çështje të zhvillimit të gjuhës shqipe, disa çështje të dialektologjisë etj.

Hulumtimi ynë mbi gjuhën shqipe në "Kanunin e Lek Dukagjinit" do të jetë i orientuar në çështjen si më poshtë:

1. Të dhënat gjuhësore mbi zhvillimin e gjuhës shqipe në dy botimet, botimi i pjesshëm në vitin 1890 dhe botimi i plotë në vitin 1933.
2. Të dhënat mbi alafabetin e përdorur nga At Shtjefën Gjecovi në shkrimin e kanunit.

3. Pasuria leksikore, të dhënat gramatikore të gjuhës shqipe në “*Kamunin e Lek Dukagjinit*”
4. Të dhënat dialektore mbi dialektin geg.

Juljana Kume

Për një gramatikë të re të shqipes, prova të e-learning dhe të ludolinguistikës (kontribut i Departamentit të Albanologjisë, UNICAL, nën drejtimin e F. Altimarit)

Hartimi i manualit mbi bazën e praktikës dhe kërkimit shkencor disa vjeçar pranë laboratorëve gjuhësorë të Departamentit të Albanologjisë, UNICAL, sipas zhvillimeve të fundit të teknologjive didaktike dhe informatike për përmirësimin e nxënies së një gjuhe të huaj, përkatësisht shqipes standarde dhe formës dialektore të saj, arbërishtes. Plani vjetor akademik i hartuar për studentët italianë dhe arbëreshë të shqipes, ka sjellë si produkt materialet argëtuese të nxënies së shqipes nëpërmjet teknologjive informatike në kuadër të: një ure lidhëse ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë: *e-tandem, web-dokumentari dhe e-book gramatikë e integruar e shqipes* - eksperiencat e viteve **2009-2010**me tematikë *Këndi i bashkëbisedimeve*; **2010-2011**:*Vizatime komike*; **2011-2012**: *Web dokumentari*; **2012-2013**: *WebTV*; **2013-2014**: *Digital tools & Moodle për ndërtimin e një gramatike interaktive për gjuhën shqipe (e-book)*. Rezultat i eksperincës së lartpërmendur është përmirësimi i nxënies së të mësuarit në krahasim me vitet paraprake, duke u përqendruar më shumë në aspektin e cilësisë sesa në atë të sasisë, e si rrjedhim kanë rezultuar: studentë më të sigurt, me aftësi strukturuese gjuhësore sipas rregullave të shqipes dhe me rrjedhshmëri orale shumë më cilësore sipas niveleve A1, A2, B1, B2 e C1, duke i afruar atyre rrugën më të shpejtë për nxënien dhe praktimin e L2.

Linda Mëniku

Vështrim krahasues për gjuhën e administratës në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi

Gjuha administrative konsiderohet të jetë një variacion me prestigj dhe me ndikim në gjuhë, në përgjithësi.

Ky punim synon të analizojë në mënyrë krahasuese terminologjinë në gjuhën administrative në trevat shqipfolëse në Ballkan: në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe në Mal të Zi. Regjistri administrativ do të analizohet nga perspektiva gjuhësore, duke synuar studimin e terminologjisë në regjistrin administrativ, në bazë të karakteristikave leksikore dhe gramatikore.

Studimi do të bazohet në korpusin e mbledhur nga faqet e internetit të institucioneve shtetërore në këto shtete.

Edlira Troplini – Abdurahmani

Roli i studimeve sociolinguistike në zhvillimin e shqipes

Vetë objekti i sociolinguistikës si disiplina që e studion gjuhën si mjet qëndror i komunikimit konkret, me karakteristikat e saj, si diversiteti, variacioni gjuhësor e për rrjedhojë, klasat e mundshme të variacionit që mundësojnë ndryshimin gjuhësor në kohë, hapësirë, klasë, situatë... etj., flet qartë për rëndësinë e gjuhës së folur si dhe fuqinë apo përparësinë e saj ndaj gjuhës së shkruar.

E gjithë kjo, shtron përpara çdo studiuesi përgjegjësinë për zhvillimin e gjuhës amtare. Kjo përgjegjësi duket se është më urgjente tek vendet në zhvillim, ku vihet re qartë se një pjesë e mirë e gjuhëtarëve e kanë tepër të vështirë të pranojnë epërsinë e gjuhës së folur edhe pse të gjitha sistemet shkrimore rrjedhin nga njësitë e gjuhës së përditshme.

Në se do t'u referoheshim koncepteve të përdorura nga Lyons-i, kryesisht tek këto vende, kemi nga njëra anë pretendimin për “pastërti” dhe “korrektësi” dhe nga ana tjetër, të ashtuquajturin prej tyre “korrupsion” gjuhësor. Këto janë pretendime krejt të pajustificueshme për sa kohë që gjuha është një mjet i lirë, që ndryshon, përshtatet pra, lakohet nga dita në ditë përmes aftësisë dhe forcës që ajoka për t’iu përgjigjur nevojave të reja të një shoqërie të caktuar. “Pastërtia” dhe “korrektësia” ekstreme rrezikojnë ngurosjen e gjuhës, ndërsa i ashtuquajturi “korrupsion” nuk bën gjë tjetër veçse merret me studimin e gjuhës së folur, kërkesat e reja që ajo shtron për mjete të reja gjuhësore që do t’i përgjigjen përdorimit (dhe këtu nuk është fjala të justifikojmë shkeljet drejtshkrimore)

Për fat të keq në të tilla kushte gjendet edhe shqipja e cila shtron përpara nesh nevojën urgjente për matje të sakta statistikore lidhur me përdorimin e disa dukurive të cilat po humbasin në përdorim nga dita në ditë, apo dukurive të reja të domosdoshme që përdoren dhe i duhen asaj për t’u zhvilluarmë tej.

Julie Kolgjini

(Re)valorizing linguistic loot: The case of diaglossic Albanian in multiple spheres

Recently emphasis has been placed on locating linguistic materials that expose gaps between informal spoken versus formal codified written forms

of language in attempts to address various imbalances in language codification, including hegemonic forces of standard language ideology, amongst other supralocalization efforts, during previous centuries (Rutten, Vosters, & Vandenbussche, 2014). Such a focus situates Auer's (2005) dialect-standard constellations of various European languages in the limelight, thus yielding space for diaglossic and destandardization tendencies (Rutten, 2016; Cerruti & Regis, 2014; Deumert, 2010) to be investigated, where centrifugal elements in relation to various centripetal impositions are considered (Rampton, 2014; Tagg, 2016); such heterogeneous constructions allow us "to...explore the linguistic loot forgotten in the folds of time" (Rutten, Vosters, & Vandenbussche, 2014, p. 14). These linguistic dynamics can also be brought to light when codification efforts of Albanian are examined (Byron, 1976). Such diverging and converging tendencies in diaglossic language practices can be surmised when investigating various spoken and written modes of language, including hybrid forms, e.g. in ego-documents, amongst others. Such a trajectory disrupts fixed, homogenizing, and ortholinguistic standardization efforts that have attempted to stymie various language movements that "address the co-existence of multiple, varying and flexible points of normative orientation, dependent on regional, social, identity and situational factors" (Rutten, Vosters, & Vandenbussche, 2014, p. 12). This paper addresses the meshing of heteroglossic forms in various genres, registers, and modes (amongst others) in Albanian (e.g. *duke punu* '(while) working'; *medashuru* 'to love'; *prej neve* 'from us', cf. *prej nesh*) in historical and contemporary milieus, thereby highlighting diaglossic forces at work in the evolutionary language practices of everyday language users; an emphasis will also be placed on various situated centrifugal elements being (re)valorized and (de)legitimized, including truncated forms (see Agha, 2007), where language histories and changes 'from below' are considered.

Haki Hysenaj

Varieteti gjuhësor i parlamenteve shqiptare - përkime dhe diferenca

Duke u nisur nga konstatimi se pranimi formal i varietetit të kodifikuar përvetësohet përmes ndërmjetësve dhe autoriteteve, siç janë qeveria, sistemi arsimor, mjetet masive të komunikimit, institucionet fetare dhe establistmenti kulturor (Fishman) hulumtimi "*Varieteti gjuhësor i parlamenteve shqiptare-përkime dhe diferenca*" mëton studimin e varietetit të folur të shqipes standarde nga kuvendarët e legjislatoreve të fundit të dy qeverive shqiptare, të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Si institucion i rëndësishëm i shtetit, kuvendi ka ndikim në zhvillimin dhe përhapjen e varietetit të folur të gjuhës standarde. Ky ndikim vërehet në

Shqipëri dhe në Kosovë, mirëpo vëzhgimet e rastit tregojnë se zhvillimet nuk janë të njëjta. Në këtë mes, ky hulumtim mëton t'i identifikojë përkimet dhe diferencat e zhvillimeve gjuhësore të ndikuara nga gjuha e përdorur në këto institucione.

Në fokus të këtij hulumtimi janë përzgjedhjet leksikore, stilet dhe regjistrat e përdorur nga kuvendarët e të dyja shteteve. Këto struktura hulumtohen në situata të ndryshme gjuhësore të përdorimit të varietetit standard dhe të varieteteve të tjera që dalin në diskursin ligjërimit të tyre.

Hulumtimi është josistematik dhe i rastit, ndërsa realizimi i tij mbështet në matjet empirike të fushës së sociolinguistikës.

Fjalët kryesore: kuvend, varietet gjuhësor, përzgjedhje leksikore, stil, regjistër, përkime, diferenca

Majlinda Bushaj, Marjan Lulgjuraj

Nnë vështrim për gjuhën e botimeve shqipe në Malin e Zi në këtë shekull (2001-2017)

Tradita historike kulturore dhe gjuha e njësuar, ka qenë dhe mbetet faktori kryesor i krijimit të hapësirës kulturore kombëtare të mbarë botës së sotme shqiptare; ato i japin kësaj hapësire forcën e jetës dhe qenies së saj, si një realitet dhe e drejtë natyrore e një populli me identitet, pavarësisht prej konteksteve të ndryshme shtetërore në të cilat ai jeton ose mbijeton.

Objekt i këtij studimi do të jetë tradita shkrimore në Malin e Zi në këtë shekull dhe sa pasqyrohet gjuha e sotme letrare shqipe në këto botime? Si pasqyrohet gjuha e sotme shqipe, cilat janë format e reja të punës, a pasqyrohen neologjizma në këto botime dhe sa ndikojnë huazimet do të jetë objekti i këtij studimi.

Botimet i kemi klasifikuar në: revista, b. konferenca, c. vepra. Një ndër përpjekjet e para të shqiptarëve në Malin e Zi për të krijuar periodikun e vet shkencore është revista “Kraja” 1997, kjo revistë do të ishte një tribunë e mendimit të lirë e hapur për të gjithë e hapur për të gjithë, për punime e studime nga shkencat të ndryshme, për krijime letrare e artistike, për botimin e trashëgimisë kulturore popullore dhe me këtë mënyrë do t'i shërbente mbijetesës së shqiptarëve si të tillë në ato vise. Revista “Kraja” nuk mundi të mbijetonte, sepse u botua vetëm një numër, por mbijetoi ideja e saj, misioni i saj, që e vijojnë revistat sipas botimit: *Lemba* (1998), *“Buzuku”*(2001), *“Dija”* (2003), *“Malësia”* (2005) etj. Në Malin e Zi janë botuar një numër botimesh të autorëve të ndryshëm dhe janë mbajtur një varg konferencash. Këto janë një pasuri e pazvëndësueshme informacionesh shkencore.

Në disa këto studime janë botuar një varg artikujsh që trajtojnë çështje të mëdha të historisë shqiptare që nga lashtësia e deri në ditët tona, të kulturës popullore materiale e shpirtërore, të letërsisë dhe të zhvillimeve letrare në përgjithësi, të gjuhës shqipe në vështrim të gjerë që nga sjellja e visareve origjinale të atyre trevave deri te shqyrtimet shkencore për tema të rëndësishme të zhvillimit historik dhe të gjendjes së sotme të gjuhës letrare. Në këto revista dhe botime përveç autorëve vendas kanë bashkëpunuar edhe shumë autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, bota shqiptare etj.

Fjalë e shprehje kyçe: Mali i Zi, traditë shkrimore, veçori gjuhësore, risi pune, neologjizma, huazime etj.

Shpëtim Elezi

Grupe paradigmatiche të mbiemrave në Çetën e Bogdanit

Punimi trajton mbiemrin në aspektin morfologjik e fjalëformues në veprën "Çeta e profetëve" të Pjetër Bogdanit. Në aspektin morfologjik përshkruhen veçoritë strukturore të mbiemrit dhe, rrjedhimisht, sipas rrafshit formal morfologjik, sistematizohen në dy paradigma që i kundërvihen njëra-tjetrës: *të nyjshëm ~ të panyjshëm*. Në punim evidentohen të gjitha rastet e përdorimit të të dyja llojeve të mbiemrave, paraqiten veçoritë strukturore, si dhe mbi bazën e të dhënave statistikore përcaktohet edhe denduria përdorimit të tyre. Duke u trajtuar këto çështje, del edhe problemi i përcaktimit të burimit dhe formimit. Kjo çështje e fundit shtrun nevojën që mbiemrat në këtë vepër të vështrohen edhe në aspektin fjalëformues, duke i sistematizuar në paradigma në varësi nga mënyra dhe tipi mbiemërformues. Kështu, duke u vështruar mënyrat dhe mjetet e ndryshme fjalëformuese, hetohen edhe prirjet mbiemërformuese në gjuhën e Bogdanit dhe, së këndejmi, edhe në shqipen e fundshekullit XVII.

Fjalët kyçe: Çeta e profetëve, Bogdani, mbiemër, të nyjshëm, të panyjshëm, denduria, fjalëformim.

Fridrik Dulaj

Rreth ndihmesës së Tafil Kelmendit në gjuhësinë shqiptare

Punimi ynë synon të marrë në shqyrtim ndihmesën e njërit prej studiuesve të zellshëm të gjuhës shqipe, i cili aktivitetin e tij e ka zhvilluar kryesisht në Universitetin e Prishtinës. Tafil Kelmendi ndonëse u nda shumë herët nga jeta, ndihmesa e tij në fushën e studimeve të morfologjisë dhe të sintaksës mbetet tepër e çmuar. Korpusi i këtij punimi do të jetë trajtesat e T. Kelmendit rreth gjuhës shqipe, me theks të veçantë në fushën gramatikës, fushë kjo të cilat ai e kundroi me përkushtim për aq kohë sa ka jetuar dhe ka

studiuar. Një vend të rëndësishëm në këtë punim do të zë studimi që Kelmendi i bëri çështjes së paskajores dhe funksioneve sintaksore të saj. Gjithashtu me shumë interes do të trajtohet edhe studimi i T. Kelmendit që lidhen ngushtë me kategorinë gramatikore të kohës së foljes, me ndarjen dhe nëndarjen saj, renditjen e tyre në strukturën e fjalisë së përbërë, si dhe përdorimin e tyre kontekstual apo siç e quante T. Kelmendi përdorim aspektor.

Krejt kësaj, kur i shtojmë përcaktimin e hulumtimit në folklor të kryer nga studiuesi Kelmendi, na del se ai kishte për qëllim që hulumtimit të tij t'i jepte kahe shumëdimensionale siç janë fushat: morfologjia, sintaksa, zhvillimet e morfologjisë historike, por edhe në fushat deri atëherë ende të padefinuara në gjuhësinë shqiptare, siç është sociolinguistika e etnografia e të folurit.

Metodologjia e trajtimit do të jetë e kombinuar në mes deduksionit dhe induksionit, pra me përshkrim diakronik dhe sinkronik.

Fjalët çelës: funksion, korpus, paskajore, studim, trajtesa, etj

Maria Peeva

***Zallahish-li pës neve?* – E folmja shqipe e Mandricës në librin e ri të Ludmill Stankovit**

Në tregun e librave të Bullgarisë këtë vit doli studimi më i ri i Ludmill Stankovit në sferën e albanologjisë – “E folmja shqipe në fshatin Mandrica”. Libri pasqyron varietetin e shqipes në fshatin e Mandricës. Ky fshat autentik shqiptar ku akoma flitet gjuha shqipe ndodhet në pjesën juglindore të Bullgarisë. Sipas legjendës vendbanimi është themeluar në vitin 1636 nga tre vëllezër blektorë të cilët kanë ardhur nga fshati Vithkuq afër Korçës. Pas vendosjes ata kanë ndërtuar një baxho, prej së cilës vjen edhe emri i vendbanimit (në bullgarisht baxho është “mandra”). E folmja e Mandricës ka trajta të përbashkëta me toskërishten jugore, më saktë me variantin verilindor të saj folur në Korçë, në zonat Opar dhe Gora, në rrethet Devollë dhe Kolonjë, ashtu edhe në zonën e Dangëllise – në pjesën verilindore të rrethit të Përmetit. Nën ndikimin e bullgarishtes e folmja në Mandricë ka pësuar ndryshime fonetike edhe në gjininë e shumë emrave.

Hulumtimi i fundit i ish diplomati dhe studiues të pasionuar të gjuhës shqipe është bazuar mbi studimet e Dhimitër Shuteriqit dhe të Mahir Domnit, pasi Dhimitër Shuteriqi ka studiuar në 1959 në terren në Mandricë të folmen vendase shqipe. Mirëpo Ludmill Stankovi i ka pasuruar hulumtimet duke përkthyer në gjuhën bullgare tekstet e studimeve duke bërë shënime dhe plotësime. I ka zgjeruar edhe fjalorin e përgatitur nga Dhimitër Shuteriqi me fjalë të reja, duke futur edhe shumë elemente etimologjike.

Shkelqim Millaku

Zbritja e arbëreshëve në Greqi sipas Aristidh Kolës

Për kohën dhe rrethanat e zbritjes së arbëreshëve në Greqi ishte vazhdimisht shqetësim i studiuesve, mirëpo është bërë përpjekje serioze për të argumentuar të vërtetën historike të tyre.

Zbritja e parë e avarëve sipas historianit mesjetar Satha ishte në shek. VII, por kjo ishte një hipotezë, e cila nuk gjeti mbështetje.

“Avarët dhe arbëreshët nuk kanë asnjë lidhje ndërmjet tyre” thekson Aristidh Kola, mirëpo kemi pasur zbritje të arbëreshëve që nga shek. VII.

Në këtë studim do të analizojmë zbritjen e arbëreshëve në Greqi, çdoherë sipas Aristidh Kolës dhe studiuesve të tjerë serioz që kanë studiuar për temën në fjalë.

Fjalët kryesore: Avarët dhe arbëreshët, Aristidh Kolës, gjuha, mesjetë, zbritje.

Tanja Trajković

Frazodidaktika në mësimdhënien e gjuhës shqipe në Fakultetin e Filologjisë së Beogradit

Duke u nisur nga qëndrimi i Buslajevit „që në gjuhë pasqyrohet tërë jetën popullore e që ajo na vjen si thesari i jetës sonë të kaluar“, mund të thuhet se ambient gjuhësor në të cilin format kalimtare e thënies popullore por edhe lloji i të shprehurit shpirtëror me vizë të ashpër stilistike i cili përfshin panoramën kulturore të një populli, trashëgimin e tij shpirtëror, shumë anët e jetës së njeriut dhe përvojën e tij jetësore, është frazeologjia. Ehoja e mjeteve të saj gjuhësore dëgjohet edhe sot në frazeologjinë aktuale të gjuhës letrare serbe dhe shqipe. Rrënjët historike, historia konceptuale, vlera kulturore-historike të këtyre gjuhëve gjeografikisht të afërta, përvoja universale njerëzore e folësve të tyre, zhvillim letrar e kulturor të këtyre popujve, ngjashmëri në mentalitet dhe motivim semantik kanë motivuar autorin në analizën e materialeve mësimdhënëse (doracakë, libra mësimi etj.), ky qëllim kryesor është përvetësimi i drejtë i minimumit, përkatësisht, maksimumit frazeologjik, zhvillimi i kompetencës frazeologjike, zbulimi i logjikës, natyrës dhe karakterit frazeologjik në njësitë e shënuara me grupin e vogël apo të madh të dallimeve që mundëson një komunikim të suksesshëm midis përfaqësuesve të dy kulturave. Rezultati i punës nuk është vetëm përmirësimi i frazodidaktikës në mësimdhënien e gjuhës shqipe por edhe konstatimi i lidhjes së ngushtë të frazeologjive. Në këtë mënyrë është

treguar edhe dimension esktrajgjuhësor të materialit, duke qenë se ai mund të shërbejë si material gjuhësor-kulturor dhe shoqëror meqë me përmbajtjen e tij, pasurinë e temave dhe motiveve zbulon rrjedha qytetëruese, kulturë shpirtërore të traditave të ndryshme, habitus të shoqërisë, modelet e të menduarit dhe shprehjes kulturore dhe gjuhësore.

Fjalët çelëse: mësimdhënia, frazeologjia, gjuha serbe, gjuha shqipe, materiale

Kledi Shegani - Helena Grillo

Mësimi i shqipes si gjuhë e dytë , urë lidhëse në komunikim

Në kumtesën tonë do të trajtojmë mësimin e shqipes si gjuhë e dytë si një institucion me vlera jo vetëm gjuhësore, por edhe ndërinstitutionale, duke e parë si urë lidhëse mes shqiptarëve kudo që jetojnë dhe të huajve që shfaqin interes për mësimin e shqipes si gjuhë e dytë . Përtej aspektit gjuhësor, në këtë këndvështrim domosdoshmërisht do të shohim veçoritë e shqipes si një gjuhë e dytë , duke analizuar aspektin kuptimor dhe sociolinguistik të përvetësimit të saj.

Nga pikëpamja gjeografike ekzistojnë një sërë rrejetesh , funksionaliteti i të cilave do të provohet nga analizat e politikave institucionale të vendeve ku shqipja mësohet si gjuhë e dytë . Në këtë kuadër, vend të veçantë në punimin tonë do të zënë dhe përpjekjet për të unifikuar dhe standardizuar tekstet dhe metodat për përvetësimin e shqipes si një gjuhë e dytë. Shpeshherë , abetaret e gjuhës amtare janë përdorur si tekste të para për mësimin e shqipes.

Nga vëzhgimet dhe analizat konstatojmë se mësimi i shqipes si gjuhë e dytë tejkalon përpjekjet individuale dhe nevojiten politika shtetërore të mirorganiizuara për funksionimin e rrjeteve dhe mekanizmave të tyre.

Aljula Jubani

Shkolla françeskane, një traditë e rëndësishme e studimeve albanologjike

Pse historiografia jonë tradicionale la në harresë një trashëgimi të shkëlqyer kombëtare?! Edhe një herë dëshmohet shtrembërimi jo vetëm i historisë, por edhe i vlerave të rëndësishme. Natyrisht, si edhe në mjaft raste të tjera rrënjët e kulturës të mbështetura në fe, ishin një rrezik i pakonkurrueshëm për diktaturën, për të cilën vlerat kombëtare nuk mund të ishin religjioze dhe se çdo trashëgimi shpirtërore kombëtare quhej vlerë vetëm në laicitet. Por si mund të lexohet kështu historia? A mund të zhvishet, Buzuku, Budi,

Bogdani, Bardhi, Da Lecce, Kazazi etj. nga religjoni, për të qenë thjesht shqipshkrues?!

Elona Limaj

Fjalë të vjetra, kuptime të reja

Interneti është një medium i habitshëm për gjuhën. Ai është i mbushur me neologjizma. Gjuha në vetvete ndryshon ngadalë, por interneti e ka përshpejtuar procesin e këtyre ndryshimeve duke i bërë ato më të dukshme. Brezi i ri po përdor një të folur tjetër me zhargone, shkurtime apo “shpikje” gjuhësore.

Media sociale ka një ndikim të dukshëm në gjuhë. Komunikimi i ri përfshin përdorimin e akronimeve, shkurtimeve dhe neologjizmave, mund të themi që kemi një revolucion në mënyrën e komunikimit. Ne po ndajmë më shumë informacion personal dhe po komunikojmë me audiencën më të mëdha. Media sociale po na bën të jemi më krijuar dhe dalim në thelb menjëherë. Për këtë, janë krijuar kuptime të reja të fjalëve ekzistuese.

Leksiku është pjesa më lëvizshme e gjuhës. Në fjalët e përdorura në median sociale kemi një shndërrim të kuptimit, i cili ndodh kryesisht për shkak të ndryshimeve gjatë zhvillimit historik të gjuhës, kur fjala humbet kuptimin e parë e fiton një kuptim të ri.

Shohim një përdorim të gjerë të fjalëve *postim, mik, reja, status, mur, faqe, llogari, bllokim, ndjek* në një kuptim ndryshe nga ai që jemi mësuar të kemi. Ndërkohë fjalë të huaja, si *tag, timeline, viral, check-in* kanë hyrë natyrshëm në fjalorin tonë të përditshëm.

Pyetjet që ngrihen në këtë punim janë : A po e ndryshon media sociale gjuhën dhe a janë të gjithë duke e ndjekur këtë ndryshim? A shërbejnë këto ndryshime në pasurimin e gjuhës?

Gjithashtu, ky punim do të përpiqet të bëjë edhe një krahasim mes kuptimit të ri dhe atij të vjetër.

Valbona Kalemi

E folmja e lumit të Kardhiqit si kalimtare nga e folmja e Labërishtes si nëndialekt i saj drejt të folmes së qytetit të Gjirokastrës

E folmja e krahinës së Kardhiqit bën pjesë në strukturën ligjërimore të arealeve të Jugut, duke shpalosur vlerat e saj diferencuese dhe ngjyresën krahinore të Toskërishtes jugore. Kjo e folme si pasojë e kontaktit të vazhdueshëm të fqinjësisë me qytetin e Gjirokastrës si: kontaktet social-ekonomike dhe kulturore si një proces real i bashkëveprimit ndërkëmben fjalë e trajta fjalësh duke përvetësuar zakone fonetike, por edhe dukuri të

tjera gjuhësore. Kjo prirje drejt të folmes së qytetit vjen edhe si rezultat i kryerjes së shërbimeve të shumëllojshme, por edhe i migrimit të shumë familjeve në qytet.

Metoda e përdorur: Puna jonë u përqëndrua në mbledhjen e materialit gjuhësor në terren nga hulumtimi i gjuhës së folur i një morie familjesh të shpërngulura në qytet këto vitet e fundit si dhe banorëve që jetojnë ende në fshatrat e krahinës. Ne vumë re, bazën rruajtëse dhe atë kah prirjes së qytetit, shkallën e përfaqësimit, cilat grupmosha rrezikojnë ta humbasin konkretisht përdorimin e kësaj të folmeje si dhe kahjen e re si një e folme kalimtare drejt të folmes së qytetit të Gjirokastrës. Nga studimet e mëparshme vihej re një besnikëri përdorimi nga mosha e tretë, por me kalimin e viteve shohim gjithnjë e më pak përdorime si pasojë humbjes së madhe të kësaj moshe vitin e fundit ku dhe ne i kishim si bazë hulumtimi për gjuhën e veçantë të krahinës.

Elvis Bramo

Disa veçori të gjuhës së shkruar me alfabet grek në shekullin XVIII (Voskopoja)

Në këtë shkrim, autori bën objekt të punës së tij, gjuhën e shkruar me alfabet grek të

Theodhor Bogomilit, Kostandin Beratit, Vangjel Meksit dhe Grigor Gjirokastrit, të cilët bëjnë pjesë në atë grup përkthyesish të Biblës, të cilët dëshironin që shërbesat fetare të bëheshin në gjuhën amtare. Në radhën e studiuesve tanë ata shpesh janë quajtur se kanë formuar një drejtim letrar, të quajtur 'neoklerikazëm'. Bramo e vështron gjuhën e këtyre autorëve nga rrafshi fonetik, morfologjik dhe sidomos në nivelin e sintaksës, edhe në rrafsh krahasimtar me gjuhën greke, nga përkthyen ata.

Aida Uruçi

Kontributi i vyer i M. Camajt në revistën "Shêjzat"

Revista "Shêjzat" ishte një e përkohshme kulturore, shoqërore, artistike e botuar jashtë atdheut në gjysmën e dytë të shekullit XX. Dy zërat kryesorë të saj ishin: E.Koliqi -themeluesii kësaj reviste e M.Camaj, i cili ishte në rolin e kryeredaktorit. Camajn në këtë revistë e ndeshim si: poet, prozator, studiues i letërsisë e i gjuhësisë, kritik, gramatikan e përkthyes.

Në këtë temë ne do të përqendrohemi tek ndihmesa që solli M.Camaj me anë të punimeve gjuhësore, ku duam të veçojmë studimin kushtuar Jeronim

de Radës, autori thekson edhe pse De Rada nuk ishte gjuhëtar ai u përpoq të shpjegonte mjaft fjalë me anë të shqipes. Me interes janë edhe studimet gjuhësore mbi të folme e traditën arbëreshëve të Kalabrisë.

Në faqet e *Shëzave* na bien në sy edhe studimet e recensionet mbi probleme të ndryshme gjuhësore e letrare. Camaj kur recensionon veprën “Gramatika e gjuhës shqipe” të K. Gurakuqit, ishte i mendimit që “Ortografia e gjuhës shqipe” e hartuar nga Xhuvani, Cipoja e Çabej të mbetet si variant më i mirë i gjuhës së shkruar, pasi tek gramatika e Gurakuqit haste vështirësi tek vokalizmi. Me interes janë edhe dy studimet mbi veprën e At Gjergj Fishtës, ku autori vë në dukje jo vetëm pasurinë shpirtërore të popullit shqiptar, por edhe atë gjuhësore.

Nysret Krasniqi **Histori e letërsi nacionale**

Kur dijetari plak shtyhet ta rimësojë historinë nacionale nga nevoja e brendshme që të mbush zbrazëtitë për ngjarjet, politikat apo edhe për figurat themelore historike të kombit, një dukuri është më se e sigurt: historia e mësuar në shkolla ka prekur majat e ideologjizimit selektues e përjashtues. Dijetari plak, tashmë i formuar me këtë lexim historik, është vënë në krizë, e cila mund ta prekë edhe identitetin e dinjitetin e tij shkencor! Por, kriza e tij nuk mund të konsiderohet mëkat i tij. Më shumë i ngjet një fatkeqësie të besimit rinor, asaj forme besueshmerie, e cila thadrohet në vrullit rinor të ekzaltimit për të absorbuar tekstin historik pa i venë dyshimet ndaj tij, pra duke e parë si markë super të mirëqenë! A nuk i ka ndodhur kjo gjithsecilit njeri të letrave te ne? Por, tashmë, me ndjesinë e një faji të pafaj, të zbrazëtisë, e sidomos me peshën e mohimit të një formimi të pezullt, dijetari plak kërkon plotësimin e kohës së humbur duke gërmuar në tekstet historike, të cilat do të duhej t’i njihte siç duhet që në rininë e tij shekecore. Pse dijetarit plak i ndodh kjo përmbysje? Pse dijetari plak në vend që të shkruajë histori, mëson histori “elementare” për paraardhësit e tij? Këtyre pyetjeve do të synojmë t’u përgjigjemi për të parë raportin e ndërliqshëm të dijetarit me historinë dhe njëkohësisht, kur ky dijetar është njëri i letrave shqipe, të raportit të historisë nacionale me letërsinë nacionale.

Abdulla Rexhepi **Fiksioni si mjet i kuptimit të realitetit transcidental në poezinë e Nezim Frakullas**

Në këtë shkrim mëtohet të trajtohet fikcioni si një mjet i shprehjes të përvojave dhe përjetimeve transcendentale në letërsinë mistike dhe në

poezinë e Nezim Frakullas, si trashëguesi kryesor i kësaj shkolle në letërsinë shqipe. Për mistikët, gjuha konvencionale është e pamjaftueshme për të shprehur përjetimet transcendentale, prandaj dhe disa prej tyre shpesh u detyruan të thyejnë kodifikimet gjuhësore dhe kështu u bënë objekte të persekutimeve dhe eliminimeve fizike. Por shumica prej tyre, që njihen si mistikët poetë apo poetët mistikë, për të rrëfyer realitetin e tyre transcendent shfrytëzuan zhanret fiksonale. Prandaj dhe ata, nëpërmjet shkëlqes së konvencionalitetit gjuhësor dhe zhanreve fiksonale ia dolën të krijojnë letërsi të pasur dhe me ndikim. Përfaqësusi më i denj i letërsisë mistike islame, Nezim Frakulla, në shumë vende të përmbledhjes së tij poetike në gjuhën shqipe, shprehë qëndrimet për poezinë dhe se çfarë dëshiron t'i rrëfejë lexuesit me krijimtarinë e tij poetike. Në shkrim, njëherë do të diskutohet për pozitën dhe rolin e gjuhës dhe fiksonit në traditën mistike islame, më pastaj, do të analizohen idetë e Nezimit për poezinë dhe qëllimin e saj.

Fjalë Kyçe: Fiksioni, realiteti transcendent, poezia mistike, Nezim Frakulla

Avdi Visoka

Fakti dhe fiksoni në romanin e Pashkut dhe Le Clézio-s

Relacioni i paktit fiksonal dhe paktit referencial është në thelb të preokupimeve letrare që në origjinat e tekstit romanesk. Shpeshherë herë ato i janë kundërvënë njëra-tjetrës. Megjithatë në gjirin e fiksonales, fiksoni mund të zë vend më shumë ose më pak qenësor. Ai qëndron në proporcion të drejtë me të besueshmen, me të gjasëshmen dhe varet drejtpërdrejt nga sasia e fakteve reale të ndërfutura në diegjezë.

Romani bashkëkohor karakterizohet nga një vetëdije e fuqishme e trajtimit të referencave reale përbrenda fiksonales. Anton Pashku, në letërsinë shqipe, dhe Jean-Marie Gustave Le Clézio, në letërsinë frënge, paraqesin dy modele krejt origjinale të trajtimit të paktit fiksonal dhe atij referencial në universin e tyre romanesk. *Oh-i* dhe *Shkretëtira* shquhen për një ndërthurje komplekse metatekstuale të kësaj problematike prandaj vënia e një paraleleje krahasimi ndërmjet tyre është e rëndësishme jo vetëm për hulumtimin letrar të relacionit ndërmjet faktit dhe fiksonit por edhe për studimet krahasimtare për dy letërsitë respektive nacionale.

Albanë Mehmetaj

Letërsi dhe e vërtetë

(Fakti dhe fikcioni letrar sipas Ibrahim Rugovës)

Në këtë kumtesë tonën do të vërojme problemin e përhershëm të letërsisë, fiksonit, me të vërtetën, të artit me jetën dhe me fjalën e dëshmuar si fakt. Ky problem është trajtuar përgjatë historisë së letërsisë, që nga Antika, kur është shpjeguar për së pari natyra e letërsisë apo funksioni i saj letrar dhe joletrar. Në këtë tekst problemi vërohet te një dijetar yni, Ibrahim Rugova, i cili raportin e fiksonit letrar me faktin e ka trajtuar në vazhdimësi si problem të estetikës, të filozofisë së artit dhe të teorisë letrare, në vepra si: *Kah teoria, Strategjia e kuptimit, Refuzimi estetik, Ese letrare* etj. Ne, kur trajtojmë idetë e Rugovës për këtë problem, e shohim konkretisht atë në dijen moderne letrare dhe njohim propozimet që jep një dijetar modern, i formuar si filozof i letërsisë, estet e teoricien letrar. Ndëra, brenda veprës së tij, do të ndalemi tek esetë, meqë aty probemi del shumë i fokusuar, por edhe zgjidhjet janë shumë të hapura, në trajtën e diskutimit modern për natyrën e letërsisë.

Merxhan Avdyli

Fakti si pikënisje e krijimit të realitetit të dytë në krijimtarinë e poezisë

Ideja për shkrimin e një poezie mund të jetë e krijuar në raste të ndryshme, sikurse mund të jetë krijuar edhe në çaste të ndryshme jetësore, por gjithsesi në të shumtën e rasteve poezia ka një pikënisje nga realiteti jetësor, biografik do të thoshim, që më vonë, duke u sublimuar dhe duke marrë trajta të ndryshem figurative, merr konturat e artit letrar, duke u shndëruar kështu e gjithë biogarfia në realitet të dytë.

Në këtë mënyrë nga jeta reale, nga një ngjarje jete, një fakt jetësor, jo vetëm si përjetim ndijor dhe shqisor por si një ndodhi, sikurse edhe akëcili çast jetësor, mund të merret lënda për krijimin e një poezie dhe kur ajo realizohet fiton dimensione të tjera.

Realiteti jetësor dhe realiteti artistik e kanë përcjellë poezinë që nga lashtësia e deri në ditët e sotme, qoftë si qëllim jetësor, qoftë si qëllim letrar. Ndonëse në kohë të ndryshme ka pasur lëvizje jo vetëm në sferëb e perceptimeve, jo vetëm lidhur me krijimin e poezisë, megjithatë që nga lashtësia janë ruajtur esencat nga është nisur krijimi i poezisë – fakti (faksioni), i cili më tutje është shndërruar në fikson.

Ndonëse në vete shkrimi letrar është kyesisht fikson, ide të cilën e mbron shumica dërrmuese e teoricenëve të letërsisë, megjithatë edhe fakti, jo

vetëm si pikënsje letrare-artistike, jo pak ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në krijimin e realitetit të dytë, duke shndërruar fund e krye në fiksion.

Në punimin tim do të shtroj problemin e qasjes teorike ndaj dy realiteteve në krijimin e poezisë, si dhe problemin e ndërlidhjes së tyre.

A është poezia çast jetësor apo çast letrar, përkatësisht a është fakt jetësor apo fakt artistik? Si i ka qëndruar poezia kohës? Pse megjithë larushinë dhe shumësinë e formave poetike, filli nga nis një poezi deri te realizimi i saj pothuajse nuk kanë ndryshar që nga antika. Po kështu një pjesë e konsiderueshme e formave poetike janë ruajtur me shekuj.

Faktori ndërlidhës i faktit me poezinë, gjithsesi është uni, i cili edhe edhe në këtë rast është ambiguitiv – uni si faksion (jam unë) dhe uni si fiksion. Duke e mbrojtur tezën e krijimit të poezisë nga faket jetësore, rrjedhimisht uni si fiksion është, sidomos në poezi është pika fullestare nga buron poezia.

Në punim do të trajtohen edhe çështje të tjera lidhur me faktin dhe poezinë.

Fjalët çelës: poezia, fakti, fiksioni, letërisa, antika, kritika, poeti, uni, jeta, realiteti

Adem Jakllari, Silvestër Mana

Arkitektura reale dhe ajo fikionale e Gjirokastrës te Kadareja

Objekt i hulumtimit në kumtesë do të jenë kryesisht tri romanet e Kadarese: *Kronikë në gur*, *Çështje të marrëzisë* dhe *Darka e gabuar*, në të cilat referencat me kartografinë e qytetit dhe banorit të saj janë më eksplicite. Duke u mbështetur në një teori të gjerë që vjen që nga Antikiteti deri në ditët e sotme, e cila shqyrton kufijtë midis reales dhe fikionales, do të përpiqemi të ndriçojmë mpleksjen e dy rrafsheve në poetikën romanore kadareane. Fokusi kryesor i studimit tonë do të jetë mënyra sesi një univers i tërë shenjash njerëzore, soimbolikash antropologjike, kordinatash arketikurore trashëgimore të qytetit dhe psikës së gjirokastritit shndërrohen në materie dhe strukturë artistike. Raporti intensiv, që shkrintari i madh krijon me qytetin e tij të lindjes në nivel antropologjik dhe simbolik, ushqen po të njëjtin raport edhe në nivel të idiomës gjuhësorë. Toposi i qytetit, lehtësisht i identifikueshëm, është, në këtë mënyrë, jo vetëm produkt i referencave jetësore, por edhe i lëndës gjuhësore më të cilin ndërtohet ligjërata artistike. Në kumtesë do të argumentohet, gjithashtu, sesi e gjithë kjo botë mimetike, që është prezente te Kadareja, nuk çënon karakterin e njëmendtë të rrëfimit artistik.

Lili Sula

Fiksioni vs. faktit në veprën *Epika e yjeve të mëngjesit* të R. Erebarës

Megjithëse realizojnë një domethënie që e ka burimin në “faktin” personal, social, historik, religjioz e ideologjik të epërsisë së lirisë njerëzore ndaj diktatit, rrafshet e shumta të narracionit, synojnë krijimin e një “poetike” të “gjendjes së ndërmjetme”, siç e ka përcaktuar vetë autori, duke sfiduar hapur kultin e përkueshmërisë mes faktit dhe letërsisë në soc-realizëm.

Me romanin *Epika e yjeve të mëngjesit* R. Erebara sjell skema dhe boca të një picture të frikshme të fatit personal dhe kolektiv në periudhën e diktaturës, të cilat ngrihen artistikisht si përmendore e kujtesës sonë të afërt kombëtare.

Vjollca Osja

Faktualja dhe fiksionalja në tekstin narrativ të Konicës

Punimi ynë synon të marrë në analizë raportin e faktit dhe fiksionit në prozën e Konicës. Në këtë kuadër, qasja do të jetë në këndvështrimin aristotelian të përballjes mimesis/ diegjesis dhe në këndvështrimin modern të shkrirjes së dy modaliteteve në të mirë të një diskursi të ri. Po kështu, në fokus do të jenë edhe instanca të tilla si: referencialiteti dhe mungesa e tij; teknika narrative e organizimit të ligjërit, raportet autor/ narrator/ personazh; nivelet e para dhe ato figurative të ligjërit (shenjat simbolike, alegorike, paradoksale, strategjia ironike e tekstit etj.)

Fjalët kyçe: fikson, mimesis, diegjesis, referencialitet, “historie”, nivele ligjërimi, teknika narrative

Viola Isufaj

Zef Zorba: biografi dhe poezi

Këtu do të ndërtohet një biografi e Zef Zorbës pasi për të dihet shumë pak dhe dëshmitë biografike deri tashmë nuk kanë qenë të bollshme. Jeta e tij e pa rënë aq shumë në sy, meriton vëmendje.

Përtej interesit të brendshëm për biografinë e poetit në fjalë, në këtë punim, ajo (biografia) do të gjykohet për aq sa hedh dritë mbi veprën e autorit; do të shkojmë deri në atë pikë sa përfundimet e jetëshkrimit të jenë të vlefshme e të dobishme për të ndërmjetësuar në veprën artistike të autorit, për të dhënë rezultate me interes letrar.

Poezia e Zorbës, një poezi moderne, e ndikuar thellësisht nga afiniteti për hermetikët, e dalë nga eksperimente avangardiste, duket se ka shumë pak

referenca historike e sociale. Mirëpo në disa shenja të tekstit të këtij autori, atje ku duket se elementi i shprehësisë personale del mjaft i zbehtë, pikërisht aty është zhytur thellë dhe ndërlíkueshëm përvoja e tij jetësore.

Ne do të hetojmë këto shenja të tekstit letrar që kondensojnë përvojën dhe personalitetin e tij.

Do të hetojmë sesi ndërthuren ëndrra, përjetimi dhe jeta reale, sesi ngjashmëritë opake dhe pasqyrat shformuese rístrukturojnë, transformojnë dhe integrojnë realitete të jetuara- dhe ç'është më e rëndësishmja- sesi në këtë integrim humbasin kuptimet ngushtësisht personale për të përftuar një material gjithënjëzësor.

Edmond Çali

“Trebeshina & Kadare – fakti dhe fikcioni në *Dafinat e thara, Kënga shqiptare* dhe *Dimri i vetmisë së madhe*”

Në këtë punim shqyrtojmë rëndësinë e lidhjes fakt dhe fikcion në strukturën e dy veprave të K. Trebeshinës, në romanin autobiografik *Dafinat e thara. Romani i jetës sime* (Tiranë, 1988) dhe në romanin në pesë vëllime *Kënga shqiptare* (Tiranë, 2001). E shqyrtojmë temën duke krahasuar dy veprat midis tyre dhe dy veprat me të dhënat autobiografike të K. Trebeshinës. Romanin e I. Kadaresë *Dimri i vetmisë së madhe* e shqyrtojmë duke e krahasuar me materialet e arkivave që autori konsultoi gjatë shkrimit të librit dhe të botuara më vonë (Enver Hoxha, *VEPRA 19*, qershor 1960 – dhjetor 1960, Tiranë, 1975). Nga analiza e dy veprave të Trebeshinës na rezulton se përsëritja krijuese na garanton praninë e lidhjes histori-letërsi. Nga krahasimi i materialeve historike me lëndën e romanit të I. Kadaresë kemi një dëshmi tjetër se kjo vepër është një tekst shumë i rëndësishëm i letrave bashkëkohore shqiptare dhe një roman i madh historik.

Anila Mullahi, Beti Njuma

Shndërrimi në fikcion i faktikes, në tregimin shqiptar

Letërsia është e ndërtuar si endje imagjinare e ndjesive dhe eksperiencave të njohshme. Lexuesi njeh nëpërmjet shenjës letrare ndjesitë dhe botën ku lëviz. Arti në përgjithësi dhe letërsia në veçanti, nuk ndërtohen në bazë të fakteve, por si frymimi lirë, si imagjinatë e paskajshme. Imagjinata ndonëse nuk njeh kufij, është projektion i eksperiencave shpesh reale. Shkrimtari e ndërton imagjinatën e tij letrare si transfigurim të eksperiencave reale personale ose të treguara nga të tjerë.

Në letërsinë shqipe ka mjaft tregimtarë që rrëfimin e tyre e kanë ngritur mbi një realitet faktik ose autobiografik duke e shndërruar detajet e vërteta në

bërthamë artistike fikzionale. Kalimin nga fakti në fikcion do ta analizojmë duke marrë në shqyrtim prozën tregimtare të katër autorëve të njohur të letrave shqipe, Dritëro Agollit, Mihal Hanxharit, Moikom Zeqos dhe Teodor Kekos. Në disa raste vihet re se autorët nuk ndiejnë nevojën të distancohen dhe rrëfejnë pa ndërmjetësim konvencional detaje dhe atmosfera konkrete që lidhen drejtpërdrejt me jetën e tyre, duke e futur lexuesin brenda kohës dhe ngjarjeve të jetuara, duke e zhvendosur kohën nga e kaluara në të tashmen.

Erenestina Halili

Bibliografia e munguar e dramës shqipe

Mungesa deri më tash e një bibliografie unike, ku të refektohet botimi I dramës kombëtare, si dhe nevoja e një informacioni të përmbledhur bibliografik për qëllime studimore, ishte shtysa që çoi në hartimin e Bibliografisë së parë të dramës shqipe.

Kërkimet, prej së pares dramë, deri në vitin 2017, të shtrira në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Turqi, Itali, Greqi, Kroaci, në vende të tjera të Ballkanit, në Evropë e më gjerë, arkivave, revistave letrare etj, rezultuan në 1213 tituj të krijimit dramatik.

Një sere problematikash historike- letrare janë vënë re, mbi të gjitha shihet se gjinia e dramës, paraqitet më e pakta në numër të botimeve.

Pikërisht aspektet historike, si dhe zhvillimet tipologjike të gjinisë së botuar, do të trajtojnë kjo kumtesë.

Konceptet çelës: Dramë, bibliografi, histori, tipologji, autorë

Hamit Xhaferi

E vërteta dhe fikcioni në prozën romanore të F.Kongolit dhe V.Zhitit

Në letërsinë tonë, veprat letrare në prozë, kanë një hapësirë të veçantë në artin letrar dhe rrethanat historike krijuese prej ku u lëvrua proza tregimtare. Në orvatje lidhur me evokimin e së kaluarës të romanit dhe veçanërisht shprehjen e modernitetit, kemi arritur të futemi në thelbin e zhvillimeve të romanit shqiptar. Në mënyrë të zakonshme këto ecuri jo vetëm do interferonin veçse do ringjallehin nëpër kohë gjatë ecures së letërsisë sonë. Andaj, objektivi ynë është të kemi një pamje të kuptueshme të vështrimit kulturor në planin kombëtar lidhur me çastet më të rëndësishme, që falë personazheve kryesore të tyre, e bënë të arrirë romanin tonë të viteve pesëdhjeta e këtej, duke mos qëndruar në kornizën e krijimeve të thjeshta, megjithatë e shpie pak më afër me skemat më të zhvilluara letrare të kohës, duke përkrahur autenticitetin estetik kombëtar,

përtu bërë çështje e zhvillimit dhe evolucionit artistik letrar në rrafsh kombëtar. Pikësynimi parësor është gjurmimi në shtrirjet që ndërmori letërsia shqipe në vitet gjashtëdhjeta e këtej, gjer tekpërvijimii vlerësimit të çështjeve të njëjta dhe veçorivëtë cilat u dalluan me ecurinë e evoluimit të letërsisë kombëtare, si element bashkuesi kulturës letrare gjithëshqiptare. Një prej veçantive thelbësore është ndarja e panatyrshme e letërsisë prej traditës dhe influenca vepruese jonatyrrore, duke ushtruar në sprovë kompozuesetë sistemit të realizmit socialist. Megjithatë kjo lëkundjes'ishtendërprerë ngarrjedhatdeshndërrimetepërjetuara të ecurisë letrare në Evropë e më gjerë. Ishin format dhe kushtetë cilat dominonin në botën letrare evropiane si faktor kryesor që shprehte efektet dhe vartësinë e tyre në ecurinë që përbironte letërsinë shqipe. Për të mbetur brenda kontekstit letrar, proza artistike romanore shqipe së bashku meshfaqjet dhe faktorë të ndryshëm që dallojnë këtë etapë, ka shprehur hapur e përnjëherësh influencë përparimeve të mëtejshme letrare mbindërtimin e një skeme origjinale letrare, e cila ka lënë gjurmë në prezantimin e saj në rrafsh evropian.

Fjalë kyçe: romanet, identiteti, rolet gjinore, e vërteta, fikcioni

Eljon Doçe

“Statusi i dyfishtë në veprën e *At Zef Pllumit*” (Fakti në fikson në “*Rrno vetëm për me tregue*”)

Në kumtesën me titull “Statusi i dyfishtë në veprën e *At Zef Pllumit*”, do të trajtohet natyra që vepra e *At Zef Pllumit* ka nga njëra anë si memuar, si shkrim dëshmues, përfund, si fakt dhe, nga ana tjetër, si fikson, si gjuhë e figurshme, për aq sa kënaqësia dhe interesi i leximit nuk qëndron vetëm në njohjen e faktit apo dëshmisë historike, por po aq në kënaqësinë e shijimit të një diskursi i cili nuk duket se respekton një formulë shkrimi ngurtësisht “dokumentuese”.

“*Rrno vetëm për me tregue*” vjen si nevojë jo vetëm për të dëshmuar atë që ka ndodhur, por mbi të gjitha kjo nevojë duket se lidhet me një arsye tjetër, po aq të rëndësishme, nevojën për ta *rrëfyer* faktin e ndodhur. Kështu paskajorja “me tregue” bëhet një kategori e pastër letrare sepse nuk nënkupton vetëm të dëftuarit e faktit, por njëkohësisht ajo shenjon edhe kategorinë e mirëfilltë letrare të rrëfimit/tregimtarisë.

Shpesh gjuha që rrëfen faktin del nga kufijtë e një diskursi denotativ, ajo bëhet e figurshme dhe kufijtë mes *autorit të dëshmisë* dhe *narratorit të rrëfimit* vazhdimisht ndërëmbëhen sa që shpesh vëmendja e lexuesit ndoshta më tepër sesa te mësimi/zhbulimi i faktit që po tregohet, përqendrohet te ligjërimi që merr përsipër ta tregojë këtë fakt dhe pikërisht këtu lind fikcionaliteti, i kuptuar ky i fundit jo në nivel të “vërtetësisë” të

asaj që tregohet, por në kuptimin se si ndërtohet gjuha që e tregon/rrëfen këtë fakt.

Belfjore Qose

Imagjinaria dhe realja në romanin *Rrathë* të M. Camajt

I ndërtuar mbi një sërë shenjash të mbështetura në një kulturë thellësisht tradicionale, në një rrafsh simbolesh sa të gatshme aq edhe të krijuara, romani *Rrathë* është një rast i veçantë i një narrative që e ndërton në mënyrë krejt të veçantë raportin me imagjinaren dhe realen. Në këtë punim do të analizohen procedimet narrative dhe përthyerjet kohore që realizojnë një botë sa reale aq edhe mitike, sa moderne aq edhe arketipale, një botë e cila na bën të ringjallim dyshimin metafizik: a është gjithçka trillim, apo në terma letrarë fiksion?

Mbajtja gjallë e ambiguitetit gjatë tërë rrëfimit, për Todorovin është procedimi bazë i ndërtimit të fantastikes në prozën letrare. Duke u mbështetur në teorinë e tij mbi zhanrin fantastik, do përpiqemi të identifikojmë tërë elementet që e krijojnë dhe mbajnë gjallë këtë dualizëm dhe paqartësi gjatë rrëfimit. Tek “*Rrathët*” Camaj qëllimisht ndërton një botë ku shpesh nuk kuptohet ku mbaron realja dhe fillon onirikja, ku e tashmja përzihet me kohë të tjera, për të kaluar në dimensione mbikohore, përtej kohëve dhe realiteteve konkrete, duke qenë njëherësh edhe po kaq konkretet dhe detajist në përshkrimin gati antropologjik të kontekstit. Në qendër të analizave do jetë një udhëtim nëpër narracionin dhe procedimet që e realizojnë rrëfimin, duke e parë në vështrimin e kritikës klasike të dualizmit faktuale / fiksionale dhe të pikëpamjeve poststrukturaliste, ku ky dualizëm e sheh këtë model në një kontekst më të gjerë. Dinamika fiksionalizuese e veprës që është gjithnjë në proces shndërrimi, ndryshimi, bën po aq të qartë edhe rrëfimin introspektiv, subjektivitetin e rrëfimit nga pikëvështrimi i Bardhit, që janë pjesë e të njëjtës strategji narrative. Prania e gjuhës qartë joreferenciale, stilit të ndërlikuar e madje ndonjëherë kinse naiv, ëndrrave, fiksionit jorealit, objekteve me ngarkesa simbolike, për të ndërtuar një univers ftues, që na përfshin në nivel përjetimi dhe afeksioni me ngjarjet dhe personazhet.

Metodat e përdorura në këtë punim do ndërthurin analizën tekstuale, narratologjinë, induksionin me deduksionin, si dhe do synohet që nga analiza e imtësishme tekstuale të arrihet në sinteza mbi poetikën e romanit.

Fjalë kyçe: imagjinare, narracion, kohë fiksionale, procedim

Ermir Xhindi

Gjendjet fiksonale të *Faktit* si Gjendje të leximit

Kë quajmë *Fakt*? A mund të pajtohemi mbi çfarë e prodhon atë, mbi gjendjen e tij si objekt? Nëse po, a është e mundshme një gjendje fiksonale e *Faktit* dhe a ka kuptim të flitet për të? Në ç'masë e ndikon përvoja jonë mbi *Faktin*, 'kuptimin' e tekstit letrar të kryer gjatë leximit? Në kumtesë, ne u japim përgjigje pyetjeve të mësipërme, në përputhje me pikëpamjen tonë mbi ekzistencën e një Matrice Zotëruese të Kuptimit gjatë një periudhe të dhënë, të kryer nga lexuesit, pavarësisht nga tekstet, nëpër një kapërcyell me kulme të ndryshme dendurie.

Kjo Matricë e Kuptimit, si 'vullnet' e praktikë e një bashkësie të dhënë, të përkufizueshme të leximit, në trajtën e Lexuesit të Mundshëm, shfaqet si një integrale, relativisht e përkohshme në marrëdhënie me një kategori *Faktesh* të përhershme, p.sh., 'Vdekja', në tekstet letrare. Ne hulumtojmë mbi shkallën e ndikimit të kësaj marrëdhënieje në disa tekste të I. Kadaresë, mbi strukturat e kuptimit përkatës, në përpjekje për të ndërtuar pamjen e një procesi të mundshëm e të tipologjisë së tij.

Agron Gashi

Fakti dhe fikcioni në *autoconfession*

(Një përballje teorike)

Formulimi i temës *Fakt, fikcion në autoconfession* vjen si rezultat i kërkimeve të mëhershme, ku përballjet më të mëdha teorike bëhen në prozën autobiografike. Në këtë punim shtrojmë dhe shqyrtojmë çështje me të cilat përballlet poetika bashkëkohore lidhur me konceptet në fjalë, sidomos kur ato koekzistojnë brenda një vepre qoftë me kodifikim zhanri, qoftë me status të padefinuar (zhanër hibrid).

Diskutimet e tilla janë shoqëruar shpesh me dilemat e mëdha, nëse tekstet autokonfesionale siç është autobiografia a proza autobiografike duhen të konsiderohet si fakt apo fikcion. Duke qenë një përballje e fortë, sidomos për një zhanër që konsiderohet si zhanër me kompromis dhe faktet thuren sipas praktikës fiksonale, themi se një lexim i dyfishtë (fakt-fikcion) do të vë në pah çështje të cilat janë esenciale për ta interpretuar dhe dekoduar një tekst me premisa autokonfesionale dhe, përtej kësaj, dhe një kodifikim zhanri mu atëherë kur dilemat shtrohen e bëhen edhe më të mëdha: zhanër fikcional, jofikcional, roman, roman autobiografik, autobiografi etj. Në këtë përballje teorike gjithnjë u referohemi konkludimeve të teoricienëve të sprovuar në këtë fushë, si: Adams, Lejeune, de Man, Jefferson, Doubrovsky, Barthes, Derrida, Genette, Eakin, Collet, Mauriac, Lloyd,

Fleishman, Pascal, Claudel, të mbështetura edhe me sprovat eseistike të autorëve të njohur, si: Camus, Mario V. Llosa, Julian Barnes, André Gide etj.

Fjalët çelës: *fakt, fikSION, autofiksion, zhanër fikSIONAL dhe jofiksional, subzhanër, pakt fantasmatik dhe autobiografik, prozë autobiografike etj.*

Virion Graçi

Fakti dhe fikSIONI në dy romane të I. Kadaresë, “Kronikë në gur” dhe “Darka e gabuar”

Në këtë kumtesë do të marrim në shqyrtim dy nga romanet më të rëndësishëm të Ismail Kadaresë, “Kronikë në gur” dhe “Darka e gabuar” për shkak se janë libra të lidhur ngushtësisht me qytetin e tij të lindjes e të fëmijërisë dhe elementët fikSIONALË gërshetohen me elementët faktikë më mirë se në çdo roman tjetër të tij. Në pjesën hyrëse do të mundohemi të bëjmë një parashtrim teorik të marrdhënieve midis fikSIONIT dhe faktit kurse pjesën tjetër të punimit do të zërë hetimi dhe interpretimi i fakteve historike në veprat e sipërpërmendura të I. Kadaresë.

Sherif Selimi

Fakti dhe fikSIONI në romanet e Kim Mehmetit

Romanet e Kim Mehmetit janë tekste narrative në të cilat elementet e fikSIONIT ekzistojnë. Duke bërë interpretimin e diskursit narrativ të romaneve kemi bindjen që elementet e realizmit magjik, analiza e tyre do të shpjegojë faktin e lidhjes së fakticitetit me fikSIONIN.

Ag Apolloni

Arti i arkivave

(Romani “Gurit të varrit ia rrëfej” i Agron Tufës)

Romani “Gurit të varrit ia rrëfej” i Agron Tufës, si hipertekst fikSIONAL i shkruar mbi hipotekste dokumentare, është roman me dy linja narrative që përmbajnë historitë e rrëfyera nga dy femra të përdhunuara në dy periudha: komuniste dhe demokratike. Rrëfimi nga perspektiva e femrës e kthen romanin në diskurs gjinocentrik, ku dallohet artikulimi lirik brenda mënyrës epike. Historitë e Lirikës dhe Ritës jepen si fakte, si dokumente, si incizime, pasi ato edhe janë nxjerrë nga dosjet e vërteta dhe pastaj janë modifikuar nga autori.

Agron Tufa me këtë roman i kthen rrëfimet e arkivave në një art tronditës që depërton thellë në psikologjinë e dhunuesve dhe viktimave.

Kështu, romani njëkohësisht mund të lexohet si ankim dhe si nderim (homazh): si ankim i dy femrave për fatin e tyre në dy regjime dhe si nderim i autorit për viktimat.

Ledri Kurti

Anton Harapi - Realiteti shqiptar dhe arti, përmes vëzhgimit, filozofisë dhe specifikave

At Anton Harapi spikat me fuqinë e arsyes e na ofron forcën e saj, me kryeartikujt socio-psikologjikë, polemikat dhe analizat detajuese politike-sociale, qoftë edhe qëllimisht pastër psikologjike, që ai bëri për trajtimin shpirtëror e ideal të shqiptarit, individualitetin, psikën e tij, plus-minuset e karakterit e ndryshimet nga kombet e tjera, qoftë këto edhe brenda Ballkanit.

Vlera e mendimit të tij të shkruar spikat rreth viteve 1912-1933. Më 1930-'36 e gjejmë si drejtor i "*Hyllit të Dritës*" Më 1936, do të shfaqte oratorinë e tij të përsosur me serinë e konferencave, të përmbledhura tashmë nën titullin "*Vlerë Shpirtërore*". Më 1939 do të shfaqet me prozën e guximshme me nota të theksuara psikologjike dhe filozofike si "*Valë mbi Valë*" por edhe me një tjetër lloj proze, si "*Andrra e Pretashit*".

Njihet si publicist, orator, shkrimtar. Bashkëpunoi me shtypin e kohës si "*Hylli i Dritës*", "*Ora e Maleve*", "*Posta e Shqypnisë*" etj... . Me Harapin, njohim dualitetet kundërshtuese, që ofron realiteti shqiptar i kohës. Këto kundërshti gjer në alogjizëm, sipas Harapit, vijnë si pasojë e mosrespektimit të masës. Duke mos respektuar masën, arrin në përfundimin zero, të përpjekjeve për kulturë të kombit, nga vetë kombi.

Ja vlen të kihet gjithnjë konsideratë lloji i shkrimit, mendimit dhe artit të Anton Harapit, qëzbardh gjurmë të realitetit dhe që të përfshin përmes filozofisë së mendimit. Edhe vetë arti i Anton Harapit i ndryshëm në llojin e vet për kulturën shqiptare, i ngjiz këto elementë me të cilat shquan pastërtisht stilin e tij.

Brikena Smajli

Një vështrim mbi poetikën e kujtesës në letërsinë shqipe

Punimi merr në shqyrtim përpjekjen për të përcaktuar një poetikë të kujtesës në letërsinë shqipe, duke u ndalur në dy romane specifikë të botuar kohët e fundit: "Secili çmendet simbas mënyrës së vet" dhe "Epika e yjeve të mëngjesit". Distanca kohore nga koha e ngjarjes me kohën e rrëfimit i jep shkruarit mundësinë e drejtpeshimit të tij, i cili formësohet e riformësohet si një kohë e vërtetë në letërsi. Shkrimi i një letërsie, që të

dëshmojë, jo në mënyrë thjesht dokumentare të vërtetat e veta, qoftë kjo edhe nga pikëpamja e brezit, është një proces i cili ka filluar në letërsinë shqipe, por ndërsa në memuaristikën letrare, kjo lloj letërsie është shkruar nga këndvështrimi i të burgosurit, përjetimi dhe ripërjetimi i një shkrimi prej një brezi “*të burgosurish të lirë*”, numëron sot vepra që lipset të marrin vëmendje të veçantë në studimet letrare dhe më gjerë, në drejtim të këndvështrimit të së kaluarës së afërt, në zhvillimin e shprehësisë së një poetike të kujtesës në letërsi, mes faktit dhe fiksionit, në vetëdijen që qenëson kjo pastaj në strukturat e mendimit. Mund të tërheqim vëmendjen kështu për “*Vajzat me çelës në qafë*” të Lindita Arapit, “*Tenxherja*” e Agron Tufës, “*Gjumi mbi dëborë*” i Ridvan Dibrës, “*Epika e yjeve*” dhe “*Vezët e thëllëzave*” të Rudi Erebarës, “*Kulla e mishit*” dhe “*Histori eskatologjike*” të Arben Dedjes. Në këto romane shkruhet përjetimi i një brezi që jetoi në ndërmjet një diktature, duke shënuar përfundimisht individët përjetues, me vulën e saj. Në këtë pikë këto romane përpiqen të sjellin nëpërmjet kundrimit dhe një vështrimi të vërtetë e reflektues të vërtetat e brezit dhe të japin ndihmesën e tyre në një **poetikë të kujtesës në letërsinë shqipe**.

Fjalë çelës: poetika e kujtesës, koha historike, koha e rrëfimit, e vërteta, shpërndërimi, literariteti, fakti

Teuta Vinca Kafexholli

Fakti dhe fikcioni në plan krahasues mes tre shkrimtarëve dhe tri regjioneve gjuhësore ballkanike

Në kumtesë, me metodën krahasimtare, theksohen edhe jeta edhe motivet e poemës së Mitrush Kutelit “Poemi kosovar” me krijimtarinë e të tjerëve, sidomos të viteve 1937 ose kah gjysma e shekullit XX-të.

Gjithashtu në kumtesën e zgjeruar theksohet shkrimi i Radovan Zogoviqit, që çuditërisht dhe pa kontakte me Kutelin, trajton të njëjtat fakte dhe invenca që i ka trajtuar te poema në fjalë Kuteli. Kështu veprohet edhe me një shkrimtare elitare bullgare, Bllaga Dimitrova, e cila trajton tematikë analoge me Kutelin.

Pra kumtesa pos “Poemit Kosovar” të Kutelit, do të bëjë fjalë edhe për disa shkrimtarë shqiptarë dhe të huaj që kanë trajtuar ato motive që i kanë transponuar artistikisht edhe si fakte edhe si fikcione edhe Kuteli edhe shkrimtarë të tjerë me motive analoge.

Fjalë kyçe: poezi, metodë krahasimtare, shkrimtarë ballkanik, motive analoge.

Vehbi Miftari

Barleti - kujtesa e rrëfyeme

Letërsia, sikundër dihet, e ndihmon pikëvështrimin historik duke e pasqyruar “nderin epik”. Shembujt janë të shumtë nga antika te këngët osianike dhe, më tej, te letërsia bashkëkohëse. Akili njihet përmes Homerit, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu njihet përmes Barletit, po kaq sa nga mësimet e historisë, ndërsa heronjtë epikë të Fishtës janë po aq “historikë” sa edhe letrarë. Muzae ngjarjeve “të rrëfyeme” letrarisht, prandaj, mund ta shndërrojë *kujtesën* në substrat të fuqishëm për krijimin letrar me parabazë historinë, në një raport të fuqishëm ndërvarshmërie mes saj e historisë.

Kumtesa synon ta analizojë historinë e rrëfyemepër *ngjarje të kujtueme* në librin *Historia e Skënderbeut* të Barletit, i cili, sikur thoshte vetë, po e shkruante librin e tij duke u mbështetur në kujtimet e atyre që mund ta kishin jetuar “epokën e Skënderbeut”. Pra, ai po e ringjallte kujtesën duke i mbledhur copat e rrëfimeve, *mbetjet kujtesore*, përfytyrimet e luftëtarëve e të bashkëkohësve dhe dëshminë personale dhe këtë e bënte me të vetmin qëllim që ta shpëtonte nga bjerrja kujtesore madhështinë arbërore. Ky përbën raportin thelbësor mes kujtesës e historisë. Por, meqë kujtesa aty “rrëfëhet”, fikcioni është i pashmangshëm. “Historia” e Barletit e fton në ndihmë “kujtesën letrare” krahas asaj historike. E, sikur është nënvizuar nga P. Nora, kujtesa i njeh vëtëm këto dy trajta të rishpalosjes së saj.

Kumetsa, prandaj, synon të japë përgjigje se si ngjet që *kujtesa historike* të bartet përmes transformimit të dëshmisë në një *dëshmi* të dytë, artistike dhe t’i shërbejë krijimit të përfytyrimit për *përbashkësitë* (Weber).

Fjalët çelës: *historia, nderi epik, kujtesa historike, “kujtesa” letrare, rrëfimi, përbashkësia, letrat.*

Femi Cakolli

Fakti dhe fikcioni në letërsinë sakrale

Me faktin në letërsi kuptojmë objektivën, të prekshmen, realen, historinë, dëshminë kallëzimore – pra e thëna, sakralen, humanen, tokësoren, temën dhe kujtesën, kurse me fikcionin në letërsi kuptojmë subjektivën, të paprekshmen, irealen ose imagjinaren, baladën, rrëfimin – pra e pathëna, motivin, ëndrën, legjendja, shpirtërorja, qiellorja kënga dhe sakrilegjia. Fakti është epikja kurse fikcioni është lirikja. Marrëdhëniet mes faktit dhe fikcionit në një tekst letrar krijojnë unitetin sikurse edhe iluzionin e tipit epiko-lirik.

Letërsia sakrale në përkufizimin tonë hynë gjithë teksti biblik, gjithë teksti kuranor, gjithë teksti talmudik, gjithë teksti i shkrimeve të etërve, tradita

hadithore, gjitha tekstet e kanuneve shqiptare sikurse edhe në një masë e madhe e eposit të kreshnikëve meqë ky epos përpos se përjetohet si art a këngë njëherit besohet qoftë edhe në formë miti ose si e dhënë parashkencore. Pra gjitha ato tekste që aplikohen me një status mbilettrar të besimit cilësohen tekste sakrale.

Një dimension i këtij problemi letrar është edhe zhvillimi përmbajtësor dhe strukturor e formal i faktit dhe fiksionit në letërsinë sakrale dhe ndërlidhjen që e ka pasur për shkrimin dhe tematizimin e personazhimimin në letërsinë shqipe duke filluar me „Mesharin“ e Buzukut, poezinë e Budit, veprën e Bogdanit, Qiriazit, Fishtës, Teki Dërvishit, Ymer Shkrelit etj.

Një të bukur që e hasim në letërsinë e hershme shqipe është raporti që autorët kanë zgjedhur se si ta përçojnë faksionin e tyre personal ose nacional përbrenda faksionit bibliq që praktikisht këtu është derivuar një fiksion të llojit “dëshmia më e hershme” e këtij probleme letrar në historinë e letërsisë shqiptare duke patur këtu në mendje Buzukun, Budin, Bogdanin, kurse të kundërtën e kësaj e ka zhvilluar Shtjefën Gjeçovi tek “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Dije Demiri -Frangu

Emocioni si fakt

Muesine Kokalari, në nëntor të vitit 1944 arrestohet për herë të parë. Me 23 janar 1946 arrestohet për së dyti, gjyqi komunist e dënoi 20 vjet heqje lirie. Më 1961 e nxjerrin nga burgu dhe e internuan ne Rrëshen. Më 1981, sëmuret nga kanceri ku nuk u tregua aspak kujdes nga shteti komunist dhe ajo vdes, më 1983 (Ë ekipedia)- janë kë to fakte, në kuptimin juridik, të vërteta të një gruaje, që është marrë me fixionin. Faktet e jetë s së saj kanë shumcka të fixionit, sepse janë unikale, janë një fantazi destructive –komuniste, fakte të një projeksioni që ka një strukturë , një kronologji, si një vepër fixionale me plot dramacitet, që pë rfundon me një tragjedi. Ky fakt I përditshmerisë komuniste ne medie transmetohej me indiferencë , jepet edhe sot si një e dhënë e një kohe, derisa në letë rsi faktit I mvishet një motiv subjektiv, kë tu ë shtë një motiv ideologjik, por gjithsesi subjektiv. Instalimi I një heroi lirik apo epik, sjellë emocione si refleksione të raportit të krijuesit dhe idesë , të lindura nga një fakt, derisa vet karakteri I personazhit bëhet fakt në letërsi.

Në letërsinë tonë dominojnë veprat që Eko I quan definitive, në kuptimin e veprave ideologjike , me një diskurs nacional që reflektojnë ide –e idetë si fakte abstrakte –e subjektive ashtu si emocionet, shprehin gjendje dhe reflektime të eksperiencave subjektive-individuale, që natyrisht shfaqen si përceptime. Duke qenë se pë rceptimet jepen si konfrontime me realitetin, qoftë edhe me atë imagjinar, me alternime të

faktorit historik dhe reagimeve subjektive karshi këtyre fakteve, del të jetë se fakti real të paraqitet si një ide, që mund të përfundojë në ideologji si dhe emocion dhe fakti-qoftë edhe historik, të fixionalizohet.

Kujtim M. Shala **Fiksioni letrar**

Fiksioni letrar është një *kategori letrare, veti e shenjë letrare*, në atituda të caktuara e identifikueshme me letërsinë. Fiksioni hapet e lexohet përballë ndodhive e të vërtetave, kështu që shpjegimet e para për të duhet të jepen të lidhura me *imitimin* e me *përfaqësimin*. Ndërsa, këto raporte na çojnë te çështja e *njohjes letrare*, si kategori e si mundësi, si njohje përmjet letërsisë e si njohje letrare.

Dija letrare e provon se *fiksioni letrar* është një objekt universal i saj, i lakuar në diskurset e estetikës letrare e të teorive letrare, ndërsa çdo objekt universal, është një universalje e letërsisë, prandaj çështja *fiksion letrar* është çështje e ndërliqshme letrare sot si dikur.

Fiksioni skajohet përballë faktit, që ka trajtë reference të hapur apo aluzioni të largët, ndërsa problemi behët më i ndërliqshëm përballë *faktit letrar*, me lëndë e ontos lingvistik e semantik.

Një çështje letrare universale, si *fiksioni letrar*, duhet të hapet në rrafsh teorik, pra në dijen universale letrare, por, si çdo kategori e çdo fenomen letrar, duhet të provohet me vepra konkrete. Ndërsa, provat që jep letërsia shqipe, ndërliqësohen për shkak të natyrës së fortë ideologjike e mimetike të saj. Por, shtrirje të re merr në modernitet, kur *fiksioni* kryqëzohet me *subjektivitetin letrar* të autorit, bashkë me natyrën atributive e autobiografike të letërsisë.

Vërtet, kështu hapet në një vizurë të veçantë çështja se *çfarë e bën letërsinë* apo dhe *çfarë është letërsi*, përfundimisht e kthyer në pyetjen më te vjetër lidhur me letërsinë: *çfarë është letërsia*.

Po pra, çfarë është letërsia?

Gazmend Krasniqi **“Historia” e romanit dhe “romani” i historisë**

Me argumentime teorike dhe praktike, ky punim ngre diskutime rreth romanit që, në zanafillë, lidhet me pretendimin e “historisë” reale, si dhe vijës së hollë ndarëse të “leximit” të tyre në tekstin e mishëruar me këtë rast. Punimi synon të nxjerrë në pah lojën me perceptimet e lexuesit dhe rolin e tij, në konceptin bartian, si pjesëmarrës, duke u përcaktuar kështu

vetë jeta e veprës. Ajo lojë është pasuruese në mundësitë e shumëfishta të narrativës.

Fjalë kyçe: roman, histori, tekst, lexues, narrativë

Jolanda LILA

Gjurmë të realitetit social-kulturor e politik shqiptar në poezinë e Dritëro Agollit

Me vendosjen e sistemit komunist në Shqipëri, arti dhe letërsia u bënë pjesë e pandashme e çështjes së madhe të Partisë dhe u vunë në shërbim të ideologjisë politike. Kjo prirje e orientimit të krijimtarisë artistike u diktua dhe u imponua nga regjimi i egër totalitar, i cili synonte që artin, ashtu si çdo veprimtari tjetër, ta kthente në mjet propagandues për përhapjen e dogmës së vet. Mes kësaj klime mbizotëruese, gjalluan dy kahe zhvillimore paradoksale të poezisë: nga njëra anë, u lëvrua poezia dogmatike, që karakterizohet nga ligjërimi propagandues dhe nga ana tjetër, poezia me vlera estetike, me begati ligjërimesh e stilesh krijuese.

Rasti më tipik i pranisë së këtyre dy prirjeve, është poezia e Dritëro Agollit, e cila bart shumë gjurmë të realitetit social-kulturor e politik shqiptar. Poezia e tij njihet dy faza të rëndësishme, së pari, poezia e shkruar nën regjimin komunist, e cila, ndonëse e krijuar në rrethana tepër të vështira, solli elemente të shumëllojshme që e pasuruan poezinë shqipe dhe e ngritën në shkallarët më të larta. Në këtë fazë, si shumë autorë të tjerë të kohës, edhe ai krijoi poezi në përputhje me metodën e Realizimit Socialist, por ndryshe nga të tjerët, ai bart një peshë më të rëndësishme në këtë aspekt, sepse ishte modeli referencial. Këtë status ia atribuonte jo thjesht fama e talenti i tij krijues, por edhe pozicioni i tij shoqëror, duke qenë se ishte në krye të piramidës së autorëve shqiptarë zyrtarë, pasi ishte drejtues i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve deri në zhbërjen e sistemit monist. Së dyti, është faza e mendimit të lirë, ku mbetet i qëndrueshëm në konceptin poetik të ndjeshmërisë e pohimit të humanizmit dhe të së bukurës, por sjell edhe shumë elemente të reja.

Kjo kumtesë ka për qëllim të nxjerrë në pah specifikat ligjërimore të këtyre dy fazave krijuese të Dritëro Agollit, që pasqyrojnë edhe evoluimin e poetikës së autorit, nga ligjërimi propagandistik në atë artistik. Përmes përvijimit të këtyre specifikave, do të hidhet dritë edhe në tiparet karakterizuese të secilit ligjërim.

Fjalët kyçe: *ligjërim poetik, propagandë, metoda e Realizimit Socialist*

Murteza Osdautaj **Realitetet paralele në romanin e Dritëro Agollit**

Dritëro Agolli jo përherë ka krijuar prozë e cila mund të klasifikohet Brenda kornizave të realizmit socialist. Janë së paku tri romane të Agollit të cilat kanë formë të tillë kompozicionale dhe tematike të cilat shënojnë një lloj t[ë]tjetër stilistiko-tematik që nuk mund të hyjë në kuadër të këtij formacioni që në kohën e krijimit të tyre ishte shumë aktual . Kjo vërehet në krijimin e realiteteve fiktive karshi realiteteve historike në këto romane. ‘Dështaku’, ‘Kalorësi lakuriq’ dhe ‘Arka e djallit’ veçohen për binomin e realiteteve brenda veprës letrare dhe në kundërshtinë e realiteteve fiktive dhe atyre historike. Në këto romane mund të hasim në realitete të përputhshme (relaitet-fikcion), realitete kundërshtuese (realitet-fikcion) dhe realitete krahasuese.

Duke i parë këto vepra letrare që i përmenda por edhe një numër jo të vogël të tregimeve mund të konstatojmë se Agolli ka përdorur një numër realitetesh të cilat funksionojnë në atë mënyrë që lexuesi ta pëjetoj realitetin e veprës letrare në një kompozicion të paparë në letrat shqipe të asaj kohe. Mjetet e përdorura për t’i formësuar këto realitete fiktive janë të ndryshme. Groteska është një mjet i fuqishëm i autorit ndërsa që edhe mitemat i ndihmojnë shumë atij që realitetet të funksionojnë ‘realisht’ në botën e romaneve dhe tregimeve. Brenda këtyre kornizave autori krijon një varg motivesh dinamike minifabulare të cilat simbolizojnë formën e ekzistencave të realiteteve të romanit. Kronotopet e krijuara në këto romane janë të tilla që, së bashku me instrumente tjera kompozicionale dhe teknike, e ndihmojnë autorin që në komunikim me lexuesin të krijojë te ky i fundit, kodin e besimit dhe të përjetimit real te realitetit letrar gjithmonë në kontekst të krahasimit të tij me realitetin historik.

Mariglëna Meminaj **Raporti histori-fiksion në prozën e Vath Koreshit**

Proza e e Koreshit në përgjithësi, është e orientuar tematikisht në një univers kohor, historik, që i përket së kaluarës. Këtë preferencë për të kaluarën Koreshi e ka shfaqur në disa nga prozat e tij më të mira si: *Haxhiu i Frakullës*, *Dasma e Sakos*, *Konomea*, *Ulku dhe Uilli*. Përzgjedhja e së kaluarës si topik në romanet e Koreshit, i ka dhënë veprës së tij një lidhje të dyfishtë me elementin kohë, si dhe mundësinë që ta figurativizojë atë. Zgjedhja e Koreshit që ta shndërrojë atë edhe në topik, të marrë në fokus ngjarje që i përkasin rrjedhës së kaluar të saj, të luajë me të në mënyrë të

shumëfishtë, tregon se Koreshit i intereson jo vetëm bota që shihet me sy, që ka ekzistencë reale, por edhe ajo që, pasi ka njohur një ekzistencë materiale, i ka shpëtuar materies për t'u shndërruar në ligjërim.

Në prozat *Haxhiu i Frakullës*, *Konomea*, *Ulku dhe Uilli*, Koreshi duket se ka bërë objekt personazhe historikë, vende historike, epoka e gjendje që i njohim vetëm prej ligjërimit historik, të cilat janë të kryera e të përfunduara tashmë. Këto proza të Koreshit, nuk janë aspak një qasje e tij, me qëllim që të kthejë vëmendjen e lexuesit te njohuria historike, por një hapje, një zgjerim i kufijve të realitetit (sidomos në rrethanat e kontekstit socrealist), për të treguar se realiteti nuk është i kufizuar vetëm me të sotmen, se ajo që ne jemi, mund të njihet më mirë vetëm përmes asaj që ka qenë e që tashmë është transformuar në kujtim, në histori, në fiksion.

Por, ajo që na intereson më shumë në këtë kumesë është të dimë se si ky univers kohor që lidhet me të shkuarën e me shkrimin historik, materializohet në fiksionin e Vath Koreshit. Cilat janë specifikat e këtij narracioni fiksional, në raport me narracionin e kontekstin letrar kur ai shkroi e sidomos në raport me narracionin e mirëfilltë historik? Cilat janë shenjat e fiksionalitetit të Koreshit dhe cilët janë kufijtë tipologjike të kësaj proze?

Fjalët kyçe: fiksion, histori, fakt, metafiksion, narrator, personazh

Arben Hoxha

Fakti dhe fiksioni në këndvështrimin fenomenologjik

Pse është e rëndësishme të dallohet fakti nga fiksioni në letërsi? Cili është kriteri që e përcakton dallimin midis faktit dhe fiksionit? Çfarë është ajo që e bashkon faktin me fiksionin?

Këto janë disa nga problemet të cilat, përmes fenomenologjisë së filozofisë së artit, do t'i trajtojmë në punimin tonë.

Dallimet ndërmjet faktit dhe fiksionit, që diktohen nga sfera *e origjinës* dhe sfera *e efekteve* të tyre, përbëjnë pikat e dallimeve ontologjike që ekzistojnë ndërmjet letërsisë dokumentare dhe asaj fiksionale-artistike.

Për të kuptuar rëndësinë e dallimit midis faktit dhe fiksionit, paraprakisht është e nevojshme të përcaktohet e përbashkëta e tyre. E përbashkëta ndërmjet faktit dhe fiksionit është karakteri objektiv *i të dhënës*, si kategori perceptuale, e cila merr pjesë në ndërtimin e *faktit* dhe të *fiksionit*. Objekte të perceptimit që e formësojnë *të dhënë*n, mund të jenë objekte të prejardhura nga realiteti objektiv (i cili ekziston pavarësisht subjektit) dhe objekte të prejardhura nga realiteti subjektiv i subjektit krijues. Ambivalenca e statusit të *të dhënës* bën që, në procese të tjera përpunuese kognitive, ajo të ngrihet në statusin e *faktit* apo të *fiksionit*.

Faktor përcaktues që e mundëson kalimin statusit të *të dhënës* në statusin e *faktit* apo të *fiksionit*, nuk janë objektet perceptuale në vetvete, por drejtimi që këto objekte marrin në varësi të marrëdhënies që ato vendosin me fakultete të caktuara të ndërgjegjes dhe Unit krijues. *Fakti* i nënshtrohet përpunimit teorik që buron nga interesi i fakultetit të arsyes praktike dhe i drejtohet një arsyeje praktike. Ndërsa, për shkak se nuk krijohet nga një rend i përcaktuar hierarkik i fakulteteve të ndërgjegjes artistike dhe nuk diktohet nga interes apriori i arsyes, *fiksioni* informacioni e vet e merr nga *e dhëna*, duke e vendosur atë në zonë të lirë veprimi për të gjitha fakultetet e ndërgjegjes krijuese.

Fakti ka karakter praktik. Përkundër kësaj, *fiksioni* ka karakter transcendental, sepse është i liruar prej diktatit të internisti të arsyes praktike. Për ndryshim nga *fakti*, *fiksioni*, duke iu drejtuar ndërgjegjen artistike, marrësin e vendos në një horizont mundësish të reja reflektimi.

Arben Prendi

Bota shqiptare tek novelat e M. Camajt mes faktit dhe fiksonit

Në të gjithë veprën letrare të M. Camajt, poezi dhe prozë, bota shqiptare është temë thelbësore. E tillë shfaqet edhe tek tregimi e novela.

Duke përballur kujtimet dhe imazhet nga vendlindja e traditave të vjetra zakonore e morale, prej nga është larguar, me botën e qyteteve moderne evropiane, ku jeton, autori realizon rrëfime artistike të cilat komunikojnë në sajë të ndërthurjeve komplekse mes faktit dhe fiksonit.

Objekt i kësaj kumtese është shqyrtimi i këtyre ndërthurjeve në novelat: “Pishtarët e natës”, “Shkundullima”, “Rrunggaja në mars”, “Katundi me gjuhë të fshehtë”, “Gjon Gazulli”, “Jesminë” dhe “Bigami”.

Zamira Shkreli, Ermira Alija

Roli i përrallave si gjuhë simbolike mes reales dhe “fiction”-it, në edukimin e fëmijës parashkollor

Autoret nëpërmjet këtij artikulli prekin periudhën e fëmijëve parashkollorë, e cila konsiderohet si periudha e epshmërisë së trurit dhe e krijimit të sinapseve nervore. Institucionet shkollore dhe parashkollore janë institucione ku rriten fëmijët dhe si të tilla ata kanë nevojë të kuptojnë me një vetëdije sa më të madhe domethënien e rritjes dhe rëndësinë dhe që paraqet suporti shumëdimensional për këtë. Është e njohur ndihma pedagogjike që ofron përralla në periudhën e rritjes së parashkollorit (e jo vetëm). Duke iu referuar rritjes si process psikologjik e konjitiv, punimi e sheh raportin e përrallës me rritjen si një gjë të lidhur me gjuhën, sisistem

simbolik kompleks që I ndihmon fëmijët, qoftë të sjellin në realitet domethëniet e fshehta e të përpunojnë nënvetëdijen, ashtu edhe të konceptojnë domethëniet e niveleve të ndryshme. Kjo gjë argumentohet nëpërmjet leksikut të përrallave si simbolikë mes faktit dhe “fiction”-it, në funksion të nevojave konjitive dhe edukative, si inkurajim I tranzicionit midis të panjohurës dhe të njohurës, në mes të intuitës dhe të qartës, në mes egos dhe superegos, pa pretenduar se po shteron argumentin, por duke tërhequr vëmendjen mbi rëndësinë e fenomenit dhe të trajtimit të tij me vetëdije e elasticitet, mbështetur mbi fuqinë e letrarësisë dhe jo qëllimit. Materiali do të përmbajë disa tituj dhe material përrallash, të cilat e sjellin gjuhën si lidhëse mes reales, anës psikologjike dhe linguistike. p.sh *gjysëmkingullo* se *gjysmagjeli*, të cilët njëkohësisht janë elemente të “fiction”-it, por psikologjikisht shprehin elemente të rritjes reale të fëmijës.

Anton Berishaj

Letërsia dhe botët e mundshme

Mimesisi dhe metafiksioni – proza e Martin Camajt

Në semiotikën e përgjithshme, në linguistikë, në teorinë e diskursit dhe teorinë letrare çështja e referencialitetit, respektivisht e relacionit të shenjës dhe sistemeve të shenjave, e gjuhës dhe teksteve me botën/realitetin përfaqëson një nga çështjet fundamentale teorike. Edhe relacioni i fiksionit dhe faktit në letërsi është një nga çështjet themelore teorike që ka zënë vend në studimet letrare pothuaj që në zanafillë të tyre. Paradigmat teorike në këtë kontekst zënë fill që me *mimesisin* platonian dhe aristotelian. Ato janë transformuar në shqyrtimet semiotike të letërsisë në trajtën e paradigmes bashkëkohore të *botërave të mundshme /possible worlds* (Ronen 2004), apo *botërave alternative* (Waugh 2001).

Në këtë studim do t'i qasemi kësaj problematike duke patur parasysh perspektivën teorike bashkëkohore lidhur me *mimesisin* (Halliwell 2002, Potolsky 2006) dhe *metafiksionin*, po gjithnjë duke i mbajtur në horizont edhe fundamentet teorike të relacionit letërsia/bota, teksti/realiteti, fiksioni/fakti që nga paradigma aristoteliane e mimesis gjer te paradigma bashkëkohore e botërave të mundshme/fiksionale/alternative/virtuale, të cilat përcaktojnë jo vetëm idenë filozofike të ontosit letrar, por edhe implikimet në afilicionin poetik e zhanror të teksteve letrare. Në këtë kontekst posaçërisht do të shqyrtohet dimensionin i metafiksionit te proza e Martin Camajt (*Djella* 1958, *Karpa* 1987), si një nga modelet më interesante të prozës shqipe të shekullit XX.

Fjalë çelës: mimesisi, fiksioni, fakti, botërat e mundshme, metafiksioni

Isak Shema

Njëqind e njëzet vjetori i lindjes së Shime Deshpalit (1987-2017)

Jetëshkrimi i Shime Deshpalit, i shkrimtari të shquar të Arbëneshit të Zarës është shumë interesant. Ashtu siç ka rrëfyer ai gjatë takimit tonë në vitin 1973 tani paraqitet në këtë punim. Biografinë e këtij shkrimtari të dashur dhe të respektuar e kam përfshirë në fletoren time të shënimeve si dorëshkrim.

Teksti kushtuar poetit, prozatorit, kompozitorit, dirigjentit, mësuesit dhe artistit shqiptar, i cili dha kontribut të madh në kulturën arbëneshë të shekullit XX, nuk është botuar deri më sot, prandaj si version më i plotë para lexuesve paraqitet për të parën herë.

Lindi në Arbënesh më 16 shkurt të vitit 1897 . Emri i tij është Shime. Emri i shënuar në kishë është Simon. Ai ishte i vetmi djalë. Kishte katër motra: Marea, Micoa, Luçia dhe Ana. Gjyshi ishte Toma, i përkiste një familjeje të pasur , ndërsa gjyshja e tij quhej Mara. Babai quhej Pali (Pavle) dhe ishte bujk, ndërsa e ama ishte Matija Petani, e bija e një fshatari të pasur. Familja Deshpali ishte patriarkale. Gjyshi e largoi babain e Shimes nga shtëpia pa pasuri.

Fëmijërinë e kaloi në Arbënesh. Në moshën shtatë vjeçare ka shkuar në shkollën fillore. Shkolla ka zgjatur gjashtë vjet. Kreu tri klasat e gjimnazit në Hrvatska Gimnazija. Pastaj vazhdoi mësimet në Shkollën Normale, në Preparandija. Në shkollë ka qenë bashkë me disa arbënesh, siç janë: Lubo Deshpali, Pjetër Duka, , Berisllav Gjergja (i biri i mësuesit, Pal Gjergja), Toni Bushkoliq, Josip Rela, Pal Deshpali, Budimir Peroviq, Stjepan Peroviq, Krsto Petani). Gjyhen shqipe e ka mësuar dy herë në javë në shkollë. Mësuesit e shqipes :Pashk Bardhi,, Gjeçovi, Gjergj Koleci, Anton Paluca, Kolë Rrota nga Shkodra, Pal Gjergja (arbënesh), Nuk e kreu sepse largohet si ateist. Kishte reaguar drejtori i shkollës. E la Normalen sepse nuk pat perspektivë për inkuadrim. U dallua talenti i tij për muzikë. Mësuesit e mësuan pa pagesë. Edhe veglat ia dhanë pa pagesë.

Në fillim të vitit 1915 , në janar, mobilizohet në ushtrinë austro hungareze bashkë me Andrija Mazija, ... Mateshiq, Bailo Toni, Josip Jelenkoviq, dhe arbënesh të tjerë. Disa prej tyre Qeveria austro hungareze i caktoi mësues në Mal të Zi: Rela, Josip., Stevan Peroviq, (Pipe),Lubo Deshpal, Krsto Peroviq, Maroviq Toni e të tjerë. Prej Zarës janë dërguar në Mostar, pastaj në marsh batalon. Që nga moshja 18 vjeçare shquhet si dirigjen për orkestër dha ato frymore. Interesohet për kompozim.

Nga lufta është kthyer më 1918 në Erdel të Austro Hungarisë. Ai është kthyer në Zarë i sëmurë. Ka punuar si dirigjent në “Sokol” dhe në Kishën e Arbëneshit. Deri në kohën e pushtimit italian të Zarës në Hrvatska çitaonica

(në ballë të Leximores Kroate të Arbëneshit ishte portereti i Skënderbeut. Më 1920 pas migrimit Shime ndahet nga prindërit i vetmuar. Prindërit i vdesin në Arbënesh. I ati vdes nga torturat që i bëjnë italianët në Itali. E ama e varfër i vdes në Arbënesh. Po ashtu i vdesin edhe tri motra. Pas ardhjes së italianëve në Zarë, më 1920 emigroi në Jugosllavi, në Split. Arbëneshët ishin kundër pushtimit italian, prandaj shumë prej tyre kalojnë në territorin e Jugosllavisë. Disa arbënesh ishin të partitit kroat, ndërsa disa të tjerë proitalian..Shime migroi në Hvar. Ka punuar si dirigjent i orkestrës dhe si instruktor i muzikës. Aty ka qëndruar afër pesë vjet. Me që nuk kishte rrogë, detyrohet të punojë si nëpunës në kadastër Pastaj është transferuar në Pag, në Rab, në Bllato të Korçullës. Aty në vitin 1934 i lind fëmija i parë, Pavli. ndërsa më 1942 vajza, Maja. Në Dubrovnik drejton orkestrën. Lufta e Dytë Botërore e gjen në Korçulla. Në fillim të vitit 1943 ka qenë i angazhuar me punë në terren për të organizuar mobilizimin e tij, ka qenë i ftuar në ushtrinë partizane. Në qarkun e Dubrovnikut ka qenë dirigjent i orkestrës, përgjegjës për shkollë të muzikës. Ka qenë përgjegjës për arsim dhe kulturë, ka organizuar korin, teatrin etj.

Pas kthimit në Zarë është angazhuar si intendant për themelimin e Teatrit të Zarës. Ka qenë dirigjent i orkestrës. Në Zarë ka qenë mësues i muzikës, drejtor i Shkollës së Muzikës.

Ka krijuar poezi dhe tregime. Poezitë e para i ka botuar në *Jetën e re* që nga viti 1953 dhe sidomos gjatë viteve 60 të shekullit XX. Ka botuar veprat: "*Tregime arbnore*", 1966; "*Agimet dhe parambramjet e Arbëneshit*", 1969; "*E vërteta*", 1972; *Vepra letrare, Poezi dhe prozë*, Prishtinë, 2015

Haqif Mulliqi

Ndërtimi i identitetit kombëtar nëpërmjet etno-simboleve dhe roli i medieve të reja në shpërndarjen e tyre

Në Kosovë mediet gjithnjë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin respektivisht ruajtjen e identitetit kombëtar si dhe në ruajtjen e vlerave shumë të përfolura identitare. Ndërsa periudhën e pas vitit 1999 në Kosovë e shënon kthesa e madhe në llojlojshmërinë e medieve përmes të cilave komunikohet me publikun, rolin që kanë luajtur në krijimin e vendit si dhe në konstruksionin e identitetit të ri “kosovar” dhe kombëtar përmes simboleve, respektivisht semiologjisë së shenjave të shpërfaqura anë e kënd botës nëpërmjet medieve të reja, rrjeteve sociale, portaleve dhe internetit.

Nëpërmjet këtij punimi ne ia kemi dalë që përmes një hulumtimi të ilustrimeve se si simbole të ndryshme të cilësuar si simbole të identitetit

kombëtar janë ndërtuar në kontekst të historisë së re kombëtare të avancuara nga mediet, portalet dhe rrjetet shoqërore.

Është përzgjedhur për t'u analizuar ndikimi I medieve në identitetin nacional nëpërmjet medieve të reja ngase në to më së shpeshti është komunikuar përmes simboleve “vings”, fotografive, dhe “kornizave” (frames) duke u përfaquar si të tilla si nga rinia ashtu edhe nga gjeneratat të cilat deri vonë kanë qenë konsumator të medieve të vjetra. Nga ana tjetër, qytetarët e zakonshëm kanë sfiduar në mënyrë diskurive këto ndërtime të kombit 'nga poshtë' dhe formulimet e tyre të kombit janë kryesisht nacionaliste, duke demonstruar brishtësinë e identiteteve kombëtare. Përveçse është një terren i kontestuar, duket se etnia ka luajtur një rol të rëndësishëm në prishjen dhe thyerjen e nocionit të perceptuar të nacionalistëve për një identitet kombëtar koheziv të Kosovës.

Kontributi shkencor i hulumtimit tonë qëndron në faktin se deri te të dhënat e prezantuara është arritur nëpërmjet një qasje ndërdisiplinore të mbështetur në shumë teori mbi ndërtimin e identitetit kombëtar nëpërmjet qasjes etno-simbolike dhe rolin e medieve në këtë kontekst. Ky hulumtim gjithashtu sugjeron se zërat e njerëzve të zakonshëm kanë rëndësi në ndërtimin e elitës së identitetit kombëtar, dhe kur nuk kanë mundësi që komunikimin ta bëjnë drejtpërdrejtë, ata në mënyrë kreative përdorin hapësira të tjera, siç janë mediet e reja dhe mediet on-line, rrjetet sociale dhe portalet. Gjetjet zbulojnë rolin e mundshëm dhe qendror të medieve të reja si sfera publike digjitale alternative të përdorura nga qytetarët e thjeshtë për të lehtësuar ndërtimin diskursor të identitetit kombëtar.

Fjalët kyçe: Identiteti, simbolet, etnosimbolika, antropologjia e medies, mediet e reja

Florent Rrahmani

Kosova dhe fjala publike: përballë pa/përgjegjësisë

Zhvillimi i hovshëm teknologjik dhe globalizmi janë dy rrugë të gjata dhe të shpejta që krijuan hapësirë dhe mundësi zhvillimi të hovshëm të shkencave të komunikimit. Këto ushtruan ndikim të veçantë në shoqëritë me pafuqi vetanake të zhvillimit.

Në gjithë rrugëtimin e gjatë të inter dhe intra komunikimit, pa/përgjegjësia e fjalës publike te shoqëritë në tranzicion si ajo e Kosovës, shpeshherë duket si një keqkuptim, keqinterpretim apo edhe keqmenaxhim. Natyrisht, pa/përgjegjësia e fjalës publike, ka ndërlidhje të veçantë edhe me vetë zhvillimin e demokracisë, kulturës sociale, kulturës së fjalës, lirisë së munguar apo edhe lirisë së tepruar.

Nëse interneti dhe zhvillimi teknologjik janë dy mundësi të mëdha që kanë prodhuar rrugë të shpejta në marrjen dhe përcjelljen e informacioneve, ato

kanë prodhuar edhe mundësi të reja për keqpërdorimesh, keqmenaxhimesh, keqkuptimesh e keqinterpretimesh të shprehjes së lirë publik, gjithnjë në emër të diversitetit kulturor dhe lirisë së mendimit. Kjo manifestohet gjithandej në jetën mediatike, në shfaqjet artistike dhe në të folurit publik me karakter të ndryshëm brenda kulturës demokratike.

Çelësi i fjalëve:Pa/përgjegjësia, zhvillimi teknologjik, interneti, media, demokracia, kultura, diversiteti

Rovena Vata

Ndihmesa e revistës “Shêjzat” në ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar

Në gushtin e vitit 1957, në kryeqytet Italian, Romë, doli numri i parë i revistës periodike “Shêjzat”, me një emër kuptimplotë, siç vihet në dukje nga hartuesit “Hyllësi vërtytesh arbnoe”, për plot 18 vite me radhë. Në vitin 1978, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të krahut të djathtë të Koliqit, Martin Camaj, u botua një numër përkujtimor në nderim të botuesit të saj, profesor Ernest Koliqit.

Revista nën drejtimin e Ernest Koliqit, u paraqit si një enciklopedi e vërtetë e botës së lashtë dhe asaj bashkëkohore shqiptare. Revista dha ndihmesën e saj në ruajtjen e identitetin tonë kombëtar si: në krijimtarinë letrare, folklor, studime dhe artikuj, rubrika dhe kronika kulturore në gjuhën shqipe, si dhe në atë italiane, gjermane, angleze dhe franceze. Kjo reviste ndihmoi për shumë vite në ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, ku dallohet në veçanti vepra e Ernest Koliqit. Vepra e tij e botuar në “Shêjzat” si dhe vetë kjo revistë e themeluar dhe e programuar nga vete ai, dha një ndihmëse të çmuar në ruajtjen e temave të rëndësishme të gjuhës, letërsisë dhe të kulturës shqiptare, ku edhe përcolli mesazhin e ruajtjes së identitetit kulturor edhe jashtë atdheut. Aty gjejmë të botuar artikuj si: Për historinë e arsimit shqiptar apo Hulumtime gjuhësore nga Karl Gurakuqi, Vendi që i përngjante një zgjoni bletësh nga Martin Camaj, Rrënjët lëvizin nga Ernest Koliqi, Kronika kulturore, Lajme nga Kosova etj.

Eugent Killapi

Karakteristika të përmbajtjes së tematikës kulturore të mediave të përditshme në Shqipëri në vitet 2013-2015

Kultura është një zë i rëndësishëm i funksionit të gazetave të përditshme. Aty kanalizohen dhe trajtohen tema të rëndësishme ndërkombëtare, kombëtare. Krahas këtij trajtimi koha sot detyron zhvillimi të reja të shfaqjes së formave të ndryshme identitare, nga identiteti ndërkulturor, kulturor në atë

personal, profesional, fetar, a të çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me përfaqësimin e shoqërisë, individit në zhvillime grupe, individuale. Në gamën e madhe të interesave të shoqërisë përkundrejt kulturimit dhe informacionit që duam, media pozicionon informacion me karakter të ndryshëm po aq sa edhe të njëjtë. Në pozicionimin e konkurrencës së ndryshme të mediave masive merr një rëndësi kultura klasike dhe kultura moderne, sipërfaqësore dhe esenciale. Cilat janë karakteristikat e trajtimit të tematikës kulturore në gazetat e përditshme Shqiptare?

Kjo trajtesë, me anë të një monitorimi 528 ditore të 6 gazetave të përditshme në Shqipëri në vitet 2013-2015 ka për qëllim sadopak të nxjerrë përfundime të problematikave së tematikës kulturore. Priret të jetë sadopak një trajtesë cilësore dhe sasiore të mediave të shkruara me qëllim identifikimin e trajtimit të tyre.

Ismet Osmani

Gjuha shqipe në komunikimin publik - roli i mediave në gjuhën dhe kulturën shqiptare

Media apo diskursi publicistik është pjesë thelbësore e komunikimit publik dhe si e tillë duhet të jetë në përputhje me rregullat e caktuara të komunikimit dhe rregullat gjuhësore. Mediat, qofshin ato të shkruara apo elektronike mund të ndikojnë në pasurimin e gjuhës, në pasurimin e saj me fjalë të reja, me kultivimin e normës së gjuhës letrare etj. Diskursi i komunikimit publik (qoftë në mediat elektronike apo të shkruara) është faktori më me ndikim në zhvillimin e ndërgjegjësimit gjuhësor dhe kulturës gjuhësore. Megjithatë, ato mund të ndikojnë edhe negativisht sa i përket përdorimit të drejtë të rregullave të gjuhës standarde shqipe. Në këtë kumtesë do të trajtojmë disa raste të përdorimit jo të drejtë të ndërtimeve gjuhësore nga mjetet e informimit publik.

Fjalët kyçe: komunikim, komunikim publik, medium, diskurs gjuhësor, kulturë gjuhe

Mimoza Shqefni, Emiliano Shqefni

Ndikimi i teknologjisë në përçimin e vlerave kulturore identitare

(rasti i digjitalizimit të fondeve të trashëgimisë kulturore në IAKSA)

Jetojmë në një botë komplekse me shumë sfida. Ndër këto sfida, patjetër që komunikimi ndërkulturor është shumë i rëndësishëm. Teknologjia bën shumë në drejtim të këtij komunikimi, për faktin e globalizimit dhe gjithëpërfshirjes së saj. Globalizmi si fenomen, ka përfshirë

në vorbullën e tij edhe median dhe kulturën. Patjetër këtu lind pyetja: sa i filtruar është informacioni që përçohet dhe sa bazë shkencore ka?

Ky punim nuk ka për qëllim parësor të bëjë analizë teorike të këtyre raporteve, por më së shumti të nxjerrë në pah rëndësinë që ka mundësia e njohjes dhe studimit të objekteve të kulturës materiale, ku nëpërmjet teknologjisë shtohet mundësia e shfrytëzimit për studim dhe njohje. Këto objekte krijojnë mundësinë e identifikimit të identitetit tonë kulturor mbi bazën e karakteristikave dhe dallimeve të tyre nga njëra zonë në tjetrën. Në këtë kontekst, mund të ndërhyjë teknologjia, që mund të mundësojë shkëmbim informacioni ndërmjet individëve, çka do të thotë njohje më e madhe e trashëgimisë sonë kulturore. Kësisoj, forcimi i identitetit tonë kulturor do të jetë më i madh dhe më i pranueshëm.

Trashëgimia materiale, e cila ruhet në arkivat e Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, është një rast konkret i hapjes për lexuesin, studiuesin apo dhe më gjerë, për faktin se mund të kenë akses tek këto objekte nëpërmjet “pasaportës” që i shoqëron. Janë këto objekte që sjellin informacion të detajuar të mënyrës së jetesës së popullit tonë ndër shekuj, evolucionin e tyre ndër kohëra.

Fjalë kyçe: trashëgimi materiale, teknologji, identitet kombëtar, vlera kulturore, digjitalizim

Donik Sallova

Roli i medias në krijimin e identitetit kulturor kombëtar shqiptar

Formimi i kombeve dhe krijimi i identiteteve dhe kulturave kombëtare nuk janë vetëm momentume që identifikohen me rrethana historike të çlirimit, rizgjimit apo themelimit të shteteve kombëtare. Këto janë procese të vazhdueshme të cilat nisin që me themelimin e shteteve moderne kombëtare dhe vazhdojnë në formë të politikave shtetërore që synojnë konsolidimin, kultivimin dhe promovimin e kulturës e cila konsiderohet si “kulturë kombëtare”. Synimi i këtij punimi është të paraqesë rolin dhe rëndësinë e medias masive në formimin e kulturave kombëtare moderne në kuadër të proceseve të vazhdueshme të formimit/formësimit dhe konsolidimit të kombeve. Do të argumentohet rëndësia që ka pasur mas-media, bashkë me politikat e arsimit publik dhe politikat social-kulturore në krijimin e kulturave kombëtare në shumicën e shteteve kombëtare të Europës, përkatësisht në depërtimin e shtetit kombëtar në identitetin social, politik e kulturor të njerëzve. Në kontekstin historik, theks të veçantë do t'i kushtohet interpretimit të rëndësisë së medias së shtypur, gazetave, librit si medium, në përhapjen e gjuhës së njësuar kombëtare tek masa e kombit. Përveç shqyrtimeve teorike mbi raportin “media – kombformim- identitet”, punimi do të synojë veçanërisht të paraqesë rolin e medias masive në

formimin e identitetit kulturor kombëtar shqiptare. Në këtë vërim të këtij raporti “masmedia-kombformim-identitet” në botën shqiptare, do të konkludohet roli i munguar i medias në promovimin dhe forcimin e kulturës kombëtare shqiptare, pasojë e së cilës ndër të tjera është edhe ideja mbi të ashtuquajturin “identitet kombëtar kosovar”. Përfundimisht roli i masmedias në konsolidimin e kombit dhe formësimin e kulturës kombëtare është esencial.

Fjalë kyçe: media, identitet, kulturë, komb, shtet.

Alfred Halilaj

Lëvizja e popullsisë, media dhe kultura

Në këtë kumtesë hulumtohet raporti i medias me kulturën që sendërtohet në dy plane:

a. Media si pasqyruese e kulturës, që jep lajmin dhe informon publikun. Në këtë rast pasqyrimi mediatik bën të mundur edhe qëndrimin redaksional të gazetarit apo medias përkatëse. Këto qëndrime dhe debate formulojnë dhe ndikojnë në opinionin publik duke krijuar ndoshta edhe opinione që nuk qëndrojnë. b. Media që duke mbetur në nivelin e informimit dhe kronikës unifikon, barazon apo rrafshon qëndrimet dhe mendimet për fenomene të caktuara kulturore. Ky lloj komunikimi krijon steriotipe kulturore. Në këtë linjë do të fokusohemi konkretisht në mënyrën se si media në Shqipëri ka trajtuar dhe trajton zonat paraurbane. Në ligjërimin public lëvizja e popullsisë pas viteve 990 ka marrë vëmendje të vecantë. Duhet thënë se kjo lëvizje ka qenë më e madhja e realizuar ndonjëherë ndaj është shoqëruar edhe me kaos urban, problem të pronësisë, mungesës së kushteve etj. Media shpesh nuk ka qëndruar vetëm në pozicionin klasik të pasqyrimin të lajmit, por është thelluar në analiza dhe qëndrime të ndryshme.

b. Modestisht në këtë kumtesë trajtojmë mënyrën se si media e ka pasqyruar këtë fenomen, duke marrë si rast studimi zonën më tipike informale në Shqipëri, zonën e Kamzës. Gjatë kësaj kohe media këtë zonë e ka pasur reference për analiza jovetëm të rrafshit urban, arkitekturor, bujqësor etj, por e ka trajtuar edhe kulturalisht. Qëndrimet, editorialet, lajmet, debatet publike në emisione të ndryshme, e kanë trajtuar Kamzën me termat e inferioritetit kulturor duke e marrë shpesh si etalon të prapambetjes.

Etiketimet e ndryshme për banorët në studio televizive, deri tek formulimi ligjor me të cilin shteti hyn në raport me këta banorë, do të verifikohen në mediat e shkruara dhe vizive. Gjithashtu duke kryer intervista të drejtpërdrejta me banorët duke marrë pjesë dhe vëzhguar drejtpërsëdrejti mënyrën se si e përballojnë ata këtë ballafaqim mediatiko-kulturor.

Shpresë Mulliqi

Roli i teknologjisë informative në ndërtimin e identitetit të diasporës

Zhvillimi i teknologjisë informative, digjitalizimi dhe konvergenca e medieve si dhe komunikimi nëpërmjet tyre nga përfaqësues të shtresave të ndryshme dhe vendeve të ndryshme po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në formimin e identitetit të përbashkët të atyre që sot jetojnë të shpërndarë anekënd botës. Nëpërmjet eksplorimit të zhvillimeve në të kaluarën dhe tendencave aktuale, ky punim ofron një analizë gjithëpërfshirëse dhe shumështrësore të jetës së shqiptarëve nëpër botë dhe ndikimit të teknologjisë dhe medieve në ruajtjen e identitetit kombëtar të tyre.

Ky studim gjithashtu paraqet rolin e medias në ndërtimin e identitetit të diasporës dhe të atyre që kalojnë kufijtë ose që përkohësisht jetojnë jashtë sistemeve të komunikimit kombëtar, duke zbuluar gjithashtu në mënyra empirike se si ky raport është iniciuar dhe mbajtur në të vërtetë në jetën e përditshme, përkundër kompleksitetit të distancës hapësinore, duke krijuar mënyra të reja për të 'jetuar së bashku' dhe duke vepruar transnacionalisht në epokën digjitale. Përdorimi i të dhënave të pasura të mbledhura në hulumtimin tonë shpalos marrëdhënien komplekse ndërmjet identitetit dhe medieve dhe tregon se si mediet bëhen agentë të rëndësishëm për diasporën, identitetin dhe komunitetin në kohën e globalizmit.

Në konkluzion të këtij studimi del se teknologjitë e informimit dhe qasja në mediet e ndryshme ua ka mundësuar shqiptarëve në diasporë (dhe jo vetëm atyre) që ta kontrollojnë se me kë duan të 'lidhen' ose 'shkëputen', qofshin këta individë apo dhe komunitete të tëra në lagjen e tyre ose në vende të largëta, apo ta ruajnë identitetin e tyre kombëtar përkundër faktit se jetojnë në një hapësirë multikulturore dhe multietnike.

Fjalët kyçe: Diaspora, identiteti, teknologjia e informimit, komunikimi, globalizmi

Merita Selimi Spahija

Qeramika udhëtim në kohë, nga produkti tradicional në atë Industrial

Trashëgimia jonë kulturore përsa i përket gjetjeve dhe zhvillimit të qeramikës është e hershme. Në një këndvështrim historik, kjo kumtesë ka të bëjë më zhvillimet e qeramikës nga vitet 1930 deri në vitet 1990, duke u bërë objekt studimi për teknikat dhe funksionin e saj utilitar, si dhe historikun dhe evolucionin e kësaj teknike në formën industriale.

Qeramika artistike dhe objektet funksionale që ka arritur deri në periudhën e sotme moderne e kanë ruajtur identitetin kombëtar dhe traditën popullore, qeramika është një zeje që po mbetet në hije përvoja

shumëshekullore e kësaj zejtarie sot po humb dhe atë përfaqësim dhe trashëgimni kulturorë.

Gjithë këtë pasuri të lënë nga brezat e quajmë me konsideratë **traditë popullore** për të cilën ka shumë material. Ky punim është pjesë e punës kërkimore të kryer për punimin artizanal dhe industrial në Shqipëri dhe material studimi janë objektet popullore të përdorimit me karakter artistik dhe funksional në të gjithë Shqipëri, si trashëgimni kulturorë .

Fjalët kyçe:Trashëgimnia dhe historiku i qeramikës, funksioni i saj artistik dhe dekorativ, motivet tradicionale në prodhimin industrial.

Sponsorë

Rektorati i Universitetit të Prishtinës

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës